

VENDIM
Nr.538, datë 2.8.2006

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË KONTRATËS, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KORPORATËS AMERIKANE
“LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC”, PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR
TË VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS DETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9384, datë 4.5.2005 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe korporatës amerikane “Lockheed Martin Global Inc (LMGI), për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, nënshkruar në Tiranë më 15 mars 2005”, të nenit 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të vendimit nr.113, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurë të veçantë prokurimi me korporatën amerikane “Lockheed Martin Global Inc”, për ndërtimin e sistemit të vëzhgimit të hapësirës detare”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, në parim, të kontratës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe korporatës amerikane Lockheed Martin Global Inc”, për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare (SIVHD), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Mbrojtjes autorizohet të bëjë ndryshime në kontratë, të cilat mund të ndryshojnë çmimin, për një vlerë totale jo më shumë se 30 për qind të çmimit të përcaktuar në kontratë, si dhe ndryshime, pa kufizim, të karakterit teknik, që nuk prekin çmimin e kontratës dhe/ose qëllimin kryesor, të përcaktuar në ligjin nr.9384, datë 4.5.2005 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe korporatës amerikane “Lockheed Martin Global Inc” (LMGI), për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, nënshkruar në Tiranë më 15 mars 2005”.

3.Ministria e Mbrojtjes të përzgjedhë dhe të negociojë me bankën e pranuar edhe nga korporata amerikane “Lockheed Martin Global Inc” (LMGI) për mënyrat e kryerjes së pagesave, me anë të letër kreditit.

4. Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi, brenda 10 ditësh pas miratimit të këtij vendimi, të paraqesë te Kryeministri, për miratim, projekturdrin për ngritjen e njësisë së zbatimit të kontratës, që do të funksionojë pranë kësaj ministrie.

5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nënshkruajë kontratën në emër të Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga ky vendim dhe nga kontrata.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AFATET DHE KUSHTET
E KONTRATËS ME SHTOJCA
NGA DHE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES
DHE
LOCKHEED MARTIN GLOBAL INCORPORATED

1. PALËT KONTRAKTUESE

Këto Afate e Kushte dhe të gjitha Shtojcat e bashkëlidhura dhe të referuara në këtë dokument përbëjnë kontratën ("Kontrata") e lidhur nga dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes ("Blerësi") me zyrë në Bulv. "Dëshmorët e Kombit", Tirana (Tiranë), Albania (Shqipëri); dhe LOCKHEED MARTIN GLOBAL Inc. ("Furnizuesi") me zyrë në Electronics Park, Syracuse, New York, USA. Blerësit dhe Furnizuesit mund t'iu referohemi në njëjës si "Palë" dhe në shumës si "Palët".

2. KONTRATA DHE RENDITJA SIPAS PËRPARËSISË

Kontrata do të përfshijë dokumentet e mëposhtëm, të cilët, në rast të çfarëdo konflikti midis dokumenteve, përfshirë edhe ato në të cilat përmbahen Shtojcat, janë në renditje sipas përparësisë nga lart poshtë:

(a) Këto Afate dhe Kushte me Shtojcat

(b) Dokumenti i Furnizuesit mbi Qëllimin e Furnizimit, i datës 15 maj 2006, që ndodhet në Shtojcën 1 të Afateve dhe Kushteve.

(c) Dokumenti i Furnizuesit mbi Propozimin Teknik, i datës 7 nëntor 2005, gjendet në Shtojcën 2, të Afateve dhe Kushteve.

Të gjitha konfliktet që rrjedhin nga kjo Kontratë duhet të zgjidhen duke iu referuar Afateve dhe Kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në dokumentet e Kontratës më sipër.

Dokumentet e Kontratës të rreshtuara më lart përbëjnë të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me përmbushjen e asaj që është vendosur si çështje lëndore e Kontratës. Të gjitha komunikimet, negociatat dhe marrëveshjet e mëparshme (qoftë të shkruara apo me gojë) midis Palëve, në lidhje me çështjet lëndore, nuk janë pjesë e kësaj Kontrate.

3. OBJEKTI I KONTRATËS

Blerësi është dakord që të blejë nga Furnizuesi dhe Furnizuesi është dakord që t'i shesë Blerësit, Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare shqiptare ("SIVHD") të përshkruar në Qëllimin e Furnizimit, sipas këtyre Afateve dhe Kushteve. Palët lidhin këtë kontratë sipas Memorandumit të Marrëveshjes (MOA) të datës 3 mars 2005, dhe duke vepruar kështu, përmbushin qëllimin e MOA duke rënë dakord për rolet që ata kanë për qëllim të ndërmarrin në vendosjen e SIVHD dhe përpilimin e kësaj kontrate.

4. DATA E HYRJES NË FUQI TË KONTRATËS

Kontrata do të hyjë në fuqi që nga dita ("Data e Hyrjes në fuqi") kur nënshkruhen Afatet dhe Kushtet e Kontratës dhe i shpërndahet të dy Palëve dhe Letër Krediti i parë të jetë çelur në përputhje me Nenin 10 dhe Furnizuesi të ketë marrë Pagesën Një sipas Kontratës siç është parashtruar në Nenin 11.

5. DETYRIMI I BLERËSVE

(a) Të gjitha detyrimet e Furnizuesit sipas kësaj kontrate, kushtëzohen nga përmbushja e plotë dhe në kohë e të gjithë detyrimeve që i caktohen Blerësit, ("Detyrimet e Blerësit") përfshi por jo kufizuar në (1) çeljen dhe mirëmbajtjen e një sërë letrash krediti të pakthyeshme, të financuara tërësisht, të dokumentuara ("Pagesë Letër Krediti") në përputhje me Nenin 10, (2) pagesën e të gjitha shumave të pagueshme nga Blerësi sipas kësaj Kontrate, (3) aksesin për në pikat e instalimit dhe (4) furnizimin e të gjitha Pajisjeve të Furnizimit për Blerësin, Mjediseve, Shërbimeve dhe Informacionit sipas Nenit 30 dhe Shtojcës 4 dhe (5) lejen për kalimin në doganat shqiptare të të gjitha pajisjeve të transportuara te Blerësi.

(b) Në qoftë se ndonjë Detyrim i Blerësit nuk përmbushet sipas afateve të Kontratës dhe brenda periudhës kohore të përcaktuar në Kontratë (veçanërisht nëse ndonjë shumë e pagueshme sipas kësaj Kontrate nuk është paguar në datën e kërkuar të pagesës apo Paga e përshtatshme e Letër

Kreditit nuk është çelur), Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të fillojë punë sipas kësaj Kontrate, ose mund të ndërpresë punën, për aq kohë sa të përmbushen detyrimet dhe në vlerësimin e Furnizuesit, Furnizuesi do të ketë të drejtë për rregullime të tjera në çmim, program dhe kushte të tjera të kësaj Kontrate përfshirë:

(i) Rregullimet e duhura për Programin e Veprimtarive (Zërave) kryesorë të Kontratës;

(ii) Rregullimin e paanshëm për Çmimin e Kontratës për të pasqyruar çfarëdo kosto shtesë që shkaktohet nga Furnizuesi, përfshirë, por jo kufizuar në, rritjen e kostove nga furnizuesit apo nënkontraktorët dhe kostot e rritura materiale apo shpenzimet e punës mbështetur me dokumentacion. Procesi për ngritjen apo zgjidhjen e ndonjë pretendimi rezultues gjendet në Nenin 7. Ankesat e bëra sipas kësaj dispozite do t'i nënshtrohen dhe do të jenë pjesë e Kufizimit të Përgjegjësisë që gjendet në Nenin 18. Furnizuesi bie dakord që të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të minimizuar çfarëdo kostosh që Blerësi do të duhet t'i rimbursojë Furnizuesit sipas këtij Neni.

(iii) Ndërprerjen e Kontratës për mospërmbushje të detyrimeve në përputhje me Nenin 24 (a).

6. DETYRIMI I FURNIZUESIT.

(a) Furnizuesi është dakord që Blerësi të ketë të drejtën të mos pranojë apo të largojë cilindo punonjës apo nënkontraktor të Furnizuesit që nuk vepron në përputhje me ligjet shqiptare.

(b) Detyrime të caktuara të Blerësit sipas kësaj Kontrate kushtëzohen nga përmbushja e plotë dhe në kohë e Detyrimeve të caktuara të Furnizuesit. Nëse Blerësi kontraktin me palë të tretë për shërbime apo pajisje, në lidhje me Pajisjet e Furnizimit për Blerësin, Mjediset dhe Shërbimet siç parashtrohet në Shtojcën 4 dhe për shkak se Furnizuesi nuk arrin të përmbushë një veprimtari të programuar, kjo bën të nevojshme për Blerësin të risigurojë shërbime dhe pajisje të tilla, atëherë Blerësi do të ketë të drejtën të rimbursohet nga Furnizuesi për kostot shtesë të drejtpërdrejta dhe të verifikueshme që rezultojnë dhe që mbështeten në dokumentacion. Procesi për ngritjen dhe zgjidhjen e çfarëdo ankesave që rezultojnë gjendet në Nenin 7. Rimbursimi i bërë sipas kësaj dispozite do t'i nënshtrohet dhe do të jetë pjesë e Kufizimit të Përgjegjësisë që ndodhet në Nenin 18. Blerësi është dakord që të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për të minimizuar çfarëdo kosto që Furnizuesit do t'i duhet të rimbursojë Blerësin sipas këtij Neni.

(c) Në rast se Furnizuesi nuk arrin të realizojë Veprimtarinë e Dymbëdhjetë sipas Programit të Veprimtarive kryesore të përcaktuar në Shtojcën 2, përjashtojë çfarëdo vonese të shkaktuar nga Blerësi, dhe Blerësi ka konsumuar Dëmet e Likuiduara të përcaktuara në Nenin 19, Blerësi ka të drejtë të përfundojë Kontratën për mosplotësim sipas Nenit 24 (a).

7. RREGULLIMI I PAANSHËM

Në rastin kur njëra nga Palët beson që ka të drejtën e Rregullimit të Paanshëm sipas Nenit 5 ose Nenit 6 të kësaj Kontrate, pala që kërkon lehtësim do t'i paraqesë palës tjetër një lajmërim me shkrim. Lajmërimi do të citojë detyrimin që nuk është përmbushur plotësisht dhe në kohë, veprimet që duhen të ndërmerren nga pala tjetër për të përmbushur detyrimet e saj si dhe përshkrimin e kostove shtesë që janë shkaktuar dhe/ose do të shkaktohen si rrjedhojë e mospërmbushjes. Pas kësaj, pala që kërkon lehtësimin do të paraqesë një kërkesë që përfshin dokumentacionin mbështetës. Kërkesa e paraqitur do të ketë miratim të ndërsjelltë dhe do të zgjidhet dhe paguhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga paraqitja. Në rastin kur palët s'mund të bien dakord për zgjidhjen e kërkesave, secila palë ka të drejtë t'i referohet Nenit 25 për të arritur zgjidhjen e kërkesave të tilla. Shuma për çdo kërkesë të Furnizuesit do të jetë kostoja shtesë e shkaktuar dhe pesëmbëdhjetë (15) përqind përfitim. Në rast se ankesat e furnizuesit nuk mund të zgjidhen brenda 60 ditëve, Furnizuesi do të ruajë të drejtën të ndërpresë punën e përcaktuar në Nenin 5 derisa të zgjidhen kërkesat.

8. ÇMIMI I KONTRATËS

(a) Çmimi i SIVHD do të jetë çmimi në Dollarë të Shteteve të Bashkuara, i dhënë në Shtojcën 5 – ÇMIMI I KONTRATËS (“Çmimi i Kontratës”) dhe nuk përfshin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), detyrimet doganore apo çfarëdo taksash të tjera shqiptare. Vlera e Kontratës mbetet fikse për gjithë periudhën kohore të kësaj Kontrate. Kjo nuk mund të rritet ose të zvogëlohet përveçse për ndryshimet e rëna dakord nga palët sipas Nenit 29, për Ndryshime të Kontratës ose nëse aktet, vonesat apo mospërfshirjet nga secila palë i shkaktajnë shpenzime shtesë përmbushjes së Kontratës dhe i nënshtrohen Nenit 7, Rregullimi i Paanshëm.

(b) Furnizuesi do të përgjigjet për të gjitha taksat e vëna nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe Blerësi do të jetë përgjegjës për pagesën ose rimbursimin drejtpërdrejt te Furnizuesi për të gjitha taksat, tatimet, pagesat doganore, apo pagesa dhe detyrime të tjera të ngjashme, të ngarkuara nga

Qeveria e Shqipërisë, përfshirë por jo kufizuar në Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) ose çfarëdo taksa të tjera shqiptare. Në qoftë se Furnizuesit i kërkohet të paguajë ndonjë TVSH, detyrime doganore apo taksa të tjera të vëna nga Qeveria shqiptare, Blerësi do të rimbursojë Furnizuesin për këto shpenzime sipas Nenit 9(c).

(c) Kontrata bazohet në ligjet shqiptare që rregullojnë taksat, tatimet, pagesat doganore apo çfarëdo pagese apo detyrim të vënë nga Qeveria e Shqipërisë (në shkallë vendore dhe/ose kombëtare) në kohën e paraqitjes të propozimit. Çdo kosto shtesë për Furnizuesin që rezulton nga ndryshimet në çfarëdo ligj, rregullore, kod apo ndryshimi material pas nënshkrimit të kontratës do të jetë përgjegjësi e Blerësit, i cili do të rimbursojë Furnizuesin për kostot shtesë të shkaktuara sipas Nenit 9 (c). Blerësi do të jetë përgjegjës për kosto të veçanta testimi të kërkuara nga Shqipëria.

Një kërkesë për rimbursim e bërë sipas kësaj dispozite nuk do t'i nënshtrohet Kufizimit të Përgjegjësisë në Nenin 18.

(d) Çmimi i Kontratës bazohet në Supozimet dhe Kushtet e Vlerësimit të listuara në Shtojcën 1 bashkëlidhur. Në qoftë se për çfarëdo arsye, ndonjë nga këto Supozime dhe Kushte Vlerësimi nuk rezultojnë të vlefshme gjatë përmbushjes së kësaj Kontrate, Furnizuesit do t'i jepet e drejta për Rregullimin e Paanshëm të Çmimit të Kontratës, Programit të Punimeve, Afateve e Kushteve dhe/ose çfarëdo rregullim tjetër i përshtatshëm, për të kompensuar Furnizuesin për ndonjë kosto shtesë ose vonesë që mund të shkaktohet si rrjedhojë e mosarritjes të Supozimeve dhe Kushteve të Vlerësimit.

(e) Në qoftë se Furnizuesit i kërkohet të ndërpresë punimet si rrjedhojë e mosarritjes të Blerësit të çelë Pagesën e Letër Kreditit të kërkuar sipas Nenit 10, Kontraktori do të ketë të drejtë të kompensohet me shumën Njëqindmijë Dollarë (US\$100,000) për çdo muaj derisa të çelet Pagesa e Letër Kreditit. Nëse vonesa çon në ndërprerjen e Kontratës, do të ketë përparësi veprimi i Nenit 24 dhe kompensimi fiks sipas kësaj pike do të hiqet.

(f) Në rast se Pagesa Një nuk merret brenda kohës së përcaktuar në Nenin 11, Çmimi i Kontratës do t'i nënshtrohet rinegocimit sipas vlerësimit të Furnizuesit.

9. PAGESAT E KONTRATËS

Të gjitha pagesat sa më poshtë do të bëhen në Dollar të Shteteve të Bashkuara,

Të gjitha pagesat do t'i bëhen drejtpërdrejt Furnizuesit me transfertë elektronike fondesh përmes një sërë Pagesash Letër Krediti të çelura sipas Nenit 10.

Çdo taksë ose tarifë që i kërkohet Furnizuesit të paguajë në Shqipëri, do të faturohet veçmas nga Furnizuesi drejtpërdrejt për Blerësin dhe nuk do të paguhet përkundrejt Pagesës së Letrës Kreditit, dhe do të paguhet drejtpërdrejt nga Blerësi për Furnizuesin brenda tridhjetë (30) ditëve nga paraqitja e faturës. Këto taksa nuk do t'i nënshtrohen Nenit 18. Furnizuesi do të sigurojë dokumentacionin në mbështetje të faturës së taksave.

10. Pagesa e Letër Kreditit

Të gjitha pagesat e Kontratës sipas Planit të Pagesës që janë në Nenin 11 do t'i bëhen drejtpërdrejt Furnizuesit me anë të transfertës elektronike të fondeve me një sërë letrash krediti të pakthyeshme, plotësisht të financuara e të dokumentuara, ("Pagesa e Letër Kreditit"), nëpërmjet një banke të pranueshme për Furnizuesin, të çelura sipas planit të financimit ("Planit të Financimit") që pasqyrohet poshtë në Nenin 10 (g). Çdo Letër Kredit do të jetë thelbësisht e ngjashme me formularin e bashkangjitur këtu si Shtojca 9 e do të rishikohet e miratohet nga Furnizuesi para lëshimit. Të gjitha shpenzimet e shkaktuara në lidhje me çeljen dhe mirëmbajtjen e Letër Kreditit janë për llogari të Blerësit. Të gjitha kostot e transaksioneve të shkaktuara në SHBA, si dhe detyrimet e konfirmimit, janë për llogari të Furnizuesit.

Letra e parë e Kreditit do të çelet nga Blerësi në favor të Furnizuesit jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të Kontratës. Në rast se Blerësi nuk është në gjendje të çelë Letrën e parë të Kreditit brenda periudhës së përcaktuar, Furnizuesi do të ketë të drejtë të ndërpresë menjëherë kontratën pasi i ka bërë njoftim me shkrim Blerësit.

Çdo Pagesë Letër Krediti pas kësaj do të çelet nga Blerësi në favor të Furnizuesit në ose para 1 Marsit të çdo viti kalendarik gjatë afatit të programit, me një shumë të barabartë me Programin e Financimit për atë vit.

Në rastin kur Blerësi s'ka mundësi të çelë dy Letër Kreditet e fundit brenda periudhës të përcaktuar më lart në Nenin 10 (c) Furnizuesit do t'i jepet e drejta të ndërpresë menjëherë punën derisa të çelet Pagesa e Letër Kreditit sipas Nenit 5 dhe do të ketë një rritje në Çmimin e Kontratës në përputhje me Nenin 8. Në rast se Pagesa e Letër Kreditit nuk është çelur ende deri më 1 prill të çdo viti

kalendari, Furnizuesi do të ketë të drejtën të ndërpresë menjëherë Kontratën nëpërmjet një shkresë drejtuar Blerësit dhe të kompensohet sipas Nenit 24 (a) (iv).

Pagesa e Letër Kreditit do të sigurojë që dokumentacioni i kërkuar për t'u paraqitur për pagesën do të jetë fatura e Furnizuesit, një çek i pagueshëm për Furnizuesin me të parë ("Çek me të parë") si dhe Çertifikata e duhur për Përbushjen e Veprimtarive ("ÇPV"). ÇPV do të gjendet në Shtojcën 9 të këtyre Afateve dhe Kushteve.

Pagesa e Letër Kreditit do të lejojë që pagesa të bëhet vetëm me firmën e Furnizuesit mbi ÇPV në rast se Blerësi s'ka arritur të firmosë ÇPV që i është paraqitur për firmë sipas procedurës që gjendet në Nenin 13 (d).

Çdo Pagesë e Letër Kreditit do të vendoset sipas Planit të mëposhtëm të Financimit:

Letër Krediti	Data e Kërkuar	Vlera e Financimit në USD	Veprimtaritë e Financuara
1	30 ditë pas nënshkrimit të kontratës	\$5.701.000.	1,2,3
2	1 Mars 2007	\$7.267.000.	4,5,6,7,8,9
3	1 Mars 2008	\$4,132.000.	10,11,12

Detyrimi i Furnizuesit për të vazhduar punën dhe për të përbushur veprimtaritë kryesore kontraktuale varet nga çelja në kohë e Pagesës së Letër Kreditit për pagesën e atyre veprimtarive. Në qoftë se pagesa e Letër Kreditit bashkangjitur nuk çelët, Furnizuesi çlirohet nga të gjitha detyrimet kontraktuale që lidhen me ato veprimtari.

Ndërprerja e Kontratës sipas këtij Neni nuk do t'i nënshtrohet periudhës 45 ditore të përcaktuar në Nenin 24 a.

11. PLANI I PAGESAVE

Të gjitha pagesat do t'i bëhen Furnizuesit sipas mënyrës të përcaktuar në Nenin 9 (b) të mësipërm pasi paraqiten dokumentet e duhura të grumbulluara. Grumbullimi mund të bëhet sapo të jetë përbushur veprimtaria përkatëse. Pagesat mund të mblidhen pa ndonjë rregull. Shuma neto e pagesave në tabelat më poshtë pasqyron vlerën e veprimtarisë minus çdo kredit të zbatueshëm për Paradhënie.

(a) Pagesat e mëposhtme do të bëhen në 2006 pas nënshkrimit të kontratës, në afatet e identifikuar më poshtë. Shuma neto e pagesave në tabelat më poshtë pasqyron vlerën e veprimtarisë minus çdo kredit të aplikueshëm për Paradhënie. Shuma neto e pagesave është shuma që do t'i paguhet Furnizuesit për përbushjen e asaj veprimtarie.

Viti Kalendarik	Pagesa #	Përshkrimi i Veprimtarisë	Vlera e Veprimtarisë	Sasia neto e pagesës
2006	1	Paradhënie	\$ 0	\$2.500.000
	2	Rishikimi i Projektit të Sistemit	\$2.431.797	\$2.057.000
	3	Lëvrime i Pajisjeve të Kullës	\$1.524.147	\$1.144.000
		Shuma	\$9.955.944	\$5.701.000

i. Pagesa # 1 duhet të bëhet me Nënshkrimin e Kontratës dhe do të paguhet jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës me Pagesën e parë të Letër Kreditit. Provë për këtë pagesë do të jetë një kopje e Kontratës së nënshkruar.

ii. Pagesa # 2 është e pagueshme me përfundimin e Rishikimit të Projektit të Sistemit siç provohet nga Çertifikata e Përbushjes së Veprimtarive (ÇPV). ÇPV do të nënshkruhet pasi të kryhet Rishikimi i Projektit të Sistemit.

iii. Pagesa # 3 duhet të bëhet me lëvrime të realizuar sipas Nenit 15 kur Materialet e Kullës arrijnë në portin e caktuar në Shqipëri. Furnizuesi do të ofrojë një kopje të faturës së ngarkesës me listën e paketimit dhe në këtë kohë Blerësi do të nënshkruajë ÇPV duke lejuar pagesën ndaj Furnizuesit.

(b) Pagesat e mëposhtme do të bëhen jo më shpejt se data 1 Mars 2007.

Viti Kalendarik	Pagesa #	Përshkrimi i veprimtarisë	Vlera e Pagesës	Sasia neto e pagesës
2007	4	Lëvrimi i Gjeneratorit/Strehimit	\$2.279.162	\$2.029.000
	5	Lëvrimi i Radarit Faza 1	\$ 309.711	\$ 309.711
	6	Sistemi FAT	\$3.297.473	\$2.722.000
	7	Lëvrimi i pajisjeve Mikrovalë	\$1.788.672	\$1.589.000
	8	Lëvrimi i Radarit Faza 2	\$ 309.711	\$ 309.711
	9	Faza 1 SAT	\$934.347	\$306.591
		Shuma	\$8.919.076	\$7.266.013

Pagesa # 4 duhet të bëhet me lëvrimin e realizuar sipas Nenit 15, nëse është e zbatueshme, kur Gjeneratorët dhe Strehat lëvrohen për në ose brenda Shqipërisë. Furnizuesi do të ofrojë një inventar për lëvrimin dhe në këtë kohë Blerësi do të nënshkruajë ÇPV duke lejuar kështu pagesën për Furnizuesin.

Pagesa # 5 duhet të bëhet në përputhje me Nenin 15 kur radarët për Fazën 1 arrijnë në portin e destinuar në Shqipëri. Furnizuesi do të japë një kopje të llogarisë të ngarkesës dhe listës së paketimit në kohën kur Blerësi do të nënshkruajë ÇPV që lejon pagesën për Furnizuesin.

Pagesa # 6 duhet të bëhet me dërgimin e bërë, në përputhje me Nenin 15, të pajisjeve që i janë nënshtruar Testit të Pranimi të Sistemit (SAT) siç provohet nga ÇPV. ÇPV do të nënshkruhet për të mundësuar grumbullimin nga Furnizuesi pasi janë kryer të gjitha procedurat e kërkuara të testit sipas Nenit 14 dhe pajisjet lëvrohen sipas Nenit 15.

Pagesa # 7 duhet të bëhet në përputhje me Nenin 15 kur Pajisjet Mikrovalë arrijnë në portin e përcaktuar në Shqipëri. Furnizuesi do të japë kopjen e llogarisë së ngarkesës dhe listën e paketimit në kohën kur Blerësi do të nënshkruajë ÇPV duke lejuar grumbullimin nga Furnizuesi.

Pagesa # 8 duhet të bëhet në përputhje me Nenin 15 kur radarët e Fazës 2 arrijnë në portin e përcaktuar në Shqipëri. Furnizuesi do të japë një kopje të llogarisë së ngarkesës dhe listën e paketimit kur Blerësi do të nënshkruajë ÇPV që lejon pagesën për Furnizuesin.

Pagesa # 9 paguhet me përfundimin e Testit të Pranimi të Sistemit Faza 1 (SAT) siç provohet nga ÇPV. ÇPV do të nënshkruhet për të mundësuar grumbullimin nga Furnizuesi pasi të jenë kryer të gjitha procedurat e kërkuara të testit sipas Nenit 14.

(c) Pagesat e mëposhtme do të bëhen jo më shpejt se data 1 Mars 2008:

Viti Kalendarik	Pagesa #	Përshkrimi i Veprimtarisë	Vlera e Veprimtarisë	Sasia Neto e Pagesës
2008	10	Lëvrimi i radarit Faza 3	\$1.553.993	\$1.462.000
	11	Faza 2 SAT	\$1.124.493	\$1.124.493
	12	Faza 3 SAT	\$1.546.494	\$1.546.494
		Shuma	\$4.224.980	\$4.132.987

Pagesa # 10 duhet të bëhet me lëvrimin në përputhje me Nenin 15, kur Radarët për Fazën 3 të arrijnë në portin e përcaktuar në Shqipëri.. Furnizuesi do të japë një kopje të faturës së ngarkesës dhe listën e paketimit, kohë në të cilën Blerësi do të nënshkruajë ÇPV që lejon pagesën për Furnizuesin.

Pagesa # 11 bëhet e pagueshme me përfundimin e Testit të Pranimi të Sistemit Faza 2 (SAT) siç provohet nga ÇPV. ÇPV do të nënshkruhet për të mundësuar grumbullimin nga Furnizuesi, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat e kërkuara të testit në përputhje me Nenin 14.

Pagesa # 12 bëhet e pagueshme me përfundimin e Testit të Pranimi të Sistemit Faza 3 (SAT) siç provohet nga ÇPV. ÇPV do të nënshkruhet për të mundësuar grumbullimin nga Furnizuesi pasi janë kryer të gjitha procedurat e kërkuara sipas Nenit 14.

12. PAGESË LETËR KREDITI NË DISPOZICION PËR PARADHËNIE DHE GARANCIA E KORPORATËS

Furnizuesi do të çelë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës një Pagesë Letër

Kreditit Në Dispozicion për paradhënien (“Pagesa e Letrës së Kreditit për Paradhënie”), kryesisht në formatin e paraqitur në Shtojcën 6. Letra e Pagesës për Paradhënien do të jetë në shumën e barabartë me Pagesën për Paradhënien dhe do të hyjë në fuqi me dërgimin nga Blerësi të Pagesës së Paradhënies.

Përveçse kur vlera e Pagesës së Letër Kreditit Në Dispozicion për Paradhënien është reduktuar tashmë në zero, në përputhje me afatet dhe kushtet e Pagesës së Letër Kreditit për Paradhënien, Furnizuesi duhet ta mbajë Pagesën e Letër Kreditit të Paradhënies me bankën financuese deri në 30 ditë pas transferimit të titullit të pronësisë të lëvrimin të fundit të kërkuar për të likuiduar Pagesën e Letër Kreditit Në Dispozicion të Paradhënies. Në rast të shtyrjes apo vonesës në përmbushjen e Kontratës për shkak të vonesës së Furnizuesit, Furnizuesi do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shtyrë vlefshmërinë e Pagesës së Letër Kreditit për Paradhënie për një periudhë kohë të mjaftueshme për të mbuluar 30 ditë përtej datës së pritur të transferimit të titullit për veprimtarinë e fundit.

Vlera e Pagesës së Letër Kreditit Në Dispozicion për Paradhënien do të pakësohet në shumën e barabartë me kreditin e pagesës paradhënie që Blerësi do të marrë pasi bëhet çdo pagesë për veprimtaritë e Kontratës.

Pagesa #	Përshkrimi i Veprimtarisë	Vlera e pakësimit të Letër Kreditit
2	Rishikimi Projektit të Sistemit	\$374.797
3	Lëvrimi i Pajisjeve të Kullës	\$380.147
4	Lëvrimi i Gjeneratorit/Strehimit	\$250.162
5	Lëvrimi i Radarit Faza 1	\$0
6	Sistemi FAT	\$575.473
7	Lëvrimi i Pajisjeve Mikrovale	\$199.672
8	Lëvrimi Radarit Faza 2	\$0
9	SAT Faza 1	\$627.756
10	Lëvrimi Radarit Faza 3	\$ 91.993

Të gjitha shpenzimet e shkaktuara në SHBA në lidhje me çeljen dhe mbajtjen e Pagesës së Letër Kreditit Në Dispozicion për Paradhënien janë për llogari të Furnizuesit. Të gjitha shpenzimet e shkaktuara për këtë Letër Krediti në Shqipëri janë për llogari të Blerësit.

Garancia e Korporatës

i. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga të dy Palët, Furnizuesi do të marrë nga shoqëria e tij mëmë një Garanci të Korporatës, të zbatueshme dhe të pakthyeshme (“Garancia e Korporatës”), në thelb me formatin që jepet në Shtojcën 6 këtu. Garancia e Korporatës do të jetë në një shumë të barabartë me dhjetë përqind të çmimit të Kontratës dhe do të hyjë në fuqi me konfirmimin e faturës së dërgimit të Paradhënies nga Blerësi.

ii. Garancia e Korporatës mbetet në fuqi deri 30 ditë pas përmbushjes së periudhës së Garancisë. Në rast shtyrje ose vonese në përmbushjen e Kontratës, Furnizuesi do të ndërmarrë hapat e nevojshme për të siguruar që vlefshmëria e Garancisë së Korporatës të shtrihet për një periudhë kohe të mjaftueshme për të mbuluar 30 ditët pas përmbushjes së periudhës së Garancisë.

iii. Në rast se Furnizuesi përmbush realizimin e Kontratës më shpejt se sa pritët, ose Kontrata përfundon sipas Nenit 24, ose (ii) Kontrata ndërpritet ndryshe, Garancia e Korporatës do të zhbllokohet, me kusht që Furnizuesi të zgjidhë cilëndo dhe të gjitha kërkesat e pazgjidhura me Blerësin.

iv. Blerësi do të ketë të drejtë të paraqesë kërkesën për pagesë sipas Garancisë së Korporatës, në përputhje me afatet dhe procedurat e paraqitura aty, në rast se Kontrata ndërpritet nga Blerësi për mospërmbushje nga ana e Furnizuesit sipas Nenit 24 (a), në rastin kur Blerësi mund të pretendojë pagesën e një shume deri në sasinë për të cilën ka të drejtë sipas pikës së zbatueshme të nën-Nenit 24.

13. KOHA E PËRMBUSHJES

(a) Furnizuesi do të kryejë detyrimet sipas Kontratës në përputhje me (“Veprimtaritë e Kontratës”) në Shtojcën 2 – PROGRAMI I VEPRIMTARIVE. Çdo datë e parashikuar në Programin e Veprimtarive supozohet të jetë dita e fundit e muajt referues. Dërgimet e pjesshme do të lejohen nëse

nuk pohohet veçanërisht ndryshe në Programin e Veprimtarive.

(b) Me qëllim identifikimin e materialit që kalon në pronësi të Blerësit para plotësimit të SAT 3, “Pajisjet” do të përcaktohen si përbërës të paintegruar të SIVHD. Pajisjet do të quhen të lëvruara kur Furnizuesi ka përmbushur detyrimet e tij në përputhje me termat e lëvrimit të zbatueshme në Nenin 15 (“Lëvrimi”).

(c) Kontrata përmban procedurat e përcaktuara të pranimit, përfshi Testet e Pranimit në Fabrikë apo Testet e Pranimit në Pika siç parashikohet në Shtojcën 7, që lidhet me ngjarje të caktuara në Programin e Veprimtarive. Nëse procedurat e pranimit bashkëlidhur çdo ngjarje në Programin e Veprimtarive nuk përmbushen plotësisht nga Furnizuesi, Blerësi do të paguajë atë pjesë të çmimit të Kontratës në përpjesëtim me SIVHD që pranohet pa kundërshtim.

(d) Në kohën e përmbushjes së çdo veprimtarie, Furnizuesi dhe Blerësi do të ekzekutojnë një ÇPV për Veprimtarinë e specifikuar. Në qoftë se Blerësi beson që Veprimtaria nuk ka qenë përmbushur në kohën që Furnizuesi dëshiron të ketë ÇPV e ekzekutuar, Blerësi do të deklarojë kundërshtimet e tij me shkrim brenda 14 ditëve nga paraqitja fillestare e ÇPV. Me mbarimin e periudhës së mësipërme, nëse Blerësi nuk ia ka parashtruar kundërshtimet e tij me shkrim Furnizuesit, atëherë Furnizuesi ia paraqet përsëri ÇPV Blerësit për firmë dhe Blerësit do t’i jepet një afat prej 14 ditësh të tjera për të parashtruar kundërshtimet e tij me shkrim. Nëse Blerësi nuk arrin të paraqesë kundërshtimet brenda periudhës kohore prej 14 ditësh, Blerësit do t’i hiqet e drejta për të ngritur një kundërshtim dhe do t’i nënshtrohet miratimit të ÇPV. Në këtë rast, Furnizuesi do të ketë të drejtë të paraqesë ÇPV për pagesë pa firmën e Blerësit, me kusht që Furnizuesi të paraqesë gjithashtu një deklaram me shkrim, duke dëshmuar që Blerësi ka humbur çdo të drejtë të ngrejë kundërshtime sipas kësaj dispozite.

14. KONTROLLI DHE MARRJA NË DORËZIM/PRANIMI

(a) SIVHD që do t’i nënshtrohen Testimit të Pranimit në Fabrikë (“FAT”) dhe testimit të Pranimit në Pikë (“SAT”), sipas Shtojcës 7. Kryerja e atyre testeve do të përbëjë pranimin e pjesës së SIVHD të testuar (“Pranimi”). Dokumentet e testeve, përfshirë planet dhe procedurat FAT dhe SAT si dhe Matrica e Ndjekjes të Kërkesave (“RTM”), do t’i parashtrohen Blerësit, vetëm për informim të Blerësit. Furnizuesi do të njoftojë Blerësin, jo më pak se dyzet e pesë (45) ditë para ndonjë FAT-i të planifikuar, dhe do të lejojë Blerësin të dërgojë përfaqësuesin (me shpenzimet e Blerësit) në mjedisin e Furnizuesit apo Nënkontraktorit të Furnizuesit për të marrë pjesë dhe për të qenë dëshmitar i FAT. Mungesa e përfaqësuesit të Blerësit në FAT nuk do të ndikojë në rezultatet e pranimit FAT.

(b) Si pjesë e testit SAT, në vlerësimin e vet, Furnizuesi ose do të riparojë ose do të zëvendësojë çdo artikull që nuk përputhet me kriteret e testimit me kusht që një mospërputhje e tillë të mos jetë për neglizhencë apo keqpërdorim të Blerësit. Plotësimi me sukses nga SAT 1 deri SAT 3, sipas procedurës të dhënë në Shtojcën 7, do të përbëjë pranimin përfundimtar të SIVHD (“Pranimi SIVHD”).

(c) Në qoftë se gjatë Testimit të Pranimit në Fabrikë apo Testimit në Pikë identifikohen mangësi të cilat materialisht nuk prekin përmbushjen e SIVHD (mangësi estetike), mangësi të tilla estetike do të adresohen menjëherë nga Furnizuesi, por nuk do të vonojnë Pranimin, Pranimin e SIVHD apo Lëvrimin e SIVHD, apo ndonjë pagesë për Veprimtarinë përkatëse. Blerësi dhe Furnizuesi do të bien dakord në afatin e arsyeshëm për ndreqjen e ndonjë mangësie estetike.

(d) Shtojca 7 (Testimi i Pranimit) përcakton metodën e testit që ndiqet për testimin FAT dhe SAT. Blerësi ka të drejtë të refuzojë ndonjë artikull të SIVHD, që konstatohet me defekt si rrjedhojë e testimit FAT dhe sipas vlerësimit të vet Furnizuesi do ta riparojë apo zëvendësojë atë artikull. Nëse ndonjë mangësi apo defekt materiali identifikohet gjatë dhe mbetet të korrigjohet mbas FAT apo SAT, mangësia apo defekti i konstatuar do të dokumentohen dhe dokumenti do të nënshkruhet nga dy Palët. Furnizuesi bie dakord të ndreqë mangësinë apo defektin në 45 ditë ose të bëjë planin për të ndrequr mangësinë apo defektin konkret në një afat kohor kur mangësia apo defekti do të ndreqet.

(e) Gjatë ndërtimit të Kullave të Antenave, Blerësi do të ketë të drejtën të kontrollojë gjatë procesit të ndërtimit. Furnizuesi do të njoftojë Blerësin të paktën dy (2) ditë para fillimit të programuar të punës.

15. LËVRIMI, LEJA DOGANORE, RREZIKU I HUMBJES DHE TRANSFERIMI I Të DREJTËS Së PRONËSISË

Lëvrimi i Pajisjeve do të jetë DDU Durrës, ose port tjetër në Shqipëri me pëlqimin e dy

Palëve, sipas INCOTERMS 2000. Blerësi do të përgjigjet për të shërbyer si importues regjistri dhe është përgjegjës për të gjitha shpenzimet e bashkangjitura me këtë cilësi, duke përfshirë lejen doganore të importit, TVSH dhe detyrimet doganore.

Me Lëvrimin e Pajisjeve, Blerësi do të inspektojë Pajisjet dhe do të vërë në dijeni Furnizuesin brenda një kohë të arsyeshme, por jo më shumë se 30 ditë nga Lëvrimi, për ndonjë defekt të dukshëm, dëmtim, pajisje që mungojnë apo mospërputhje. Nëse Blerësi nuk vë në dijeni Furnizuesin brenda periudhës 30 ditore, Blerësi do të ketë humbur të drejtën të ngrejë ndonjë kundërshtim për këto Pajisje. N.q.s nuk paraqitet ndryshe në kontratë, Pranimi është përfundimtar, përveç se për sa i përket defekteve të padukshme në inspektimin pamor. Një inspektim i tillë vizual do të dëshmohej dhe verifikohet nga përfaqësues të të dy palëve.

(c) Rreziku i Humbjes lidhur me ndonjë Pajisje do t'i kalojë Blerësit sipas INCOTERMS 2000 të përcaktuar sa më sipër në Nenin 15 (a).

(d) E drejta e pronësisë për Pajisjen do t'i kalojë Blerësit kur Furnizuesi të ketë Lëvruar Pajisjet siç jepen në Programin e Veprimtarive në Shtojcën 2.

(e) Pasi pajisjet i Lëvrohen Blerësit, Blerësi do të përgjigjet për depozitimin, dhe ruajtjen e Pajisjeve deri me plotësimin e SAT 3. Nëse në kohën kur Pajisjet e kërkuara për instalim nuk janë me të njëjtat kushte dhe sasi që i Lëvrohen Blerësit, Furnizuesi do të bëjë kompensimet që janë të mundshme në Nenin 5. Gjatë kohës kur Pajisjet janë në ruajtje nga Furnizuesi pasi janë pranuar nga Blerësi, Furnizuesi do të jetë përgjegjës për Pajisjet sipas Nenit 30.

16. GARANCIA

(a) Furnizuesi garanton që SIVHD nuk do të ketë defekte në materiale dhe në punë për një periudhë që fillon me përfundimin e çdo SAT, ose me fillimin e përdorimit të leverdisshëm apo operimit të sistemit ose nga Blerësi ose klienti i Blerësit, cilido që ndodh më herët dhe përfundon 12 muaj nga përfundimi i programuar i SAT 3 siç jepet në Shtojcën 2 ("Periudhë Garancie"). Në rastin kur Blerësi shkakton vonesa në përfundimin e SAT 3 Periudha e Garancisë do të përfundojë prapë në fund të 12 muajve pas datës së programuar në kontratë për përfundimin e SAT3.

(b) Në qoftë se evidentohet ndonjë defekt i mbuluar nga garancia brenda kohës së Garancisë, Blerësi do të vërë në dijeni për këtë Furnizuesin për ekzistencën dhe natyrën e defektit brenda 72 orëve nga identifikimi i tij. Me udhëzimet e Furnizuesit, Blerësi do të heqë pjesën me defekt dhe ta kthejë në shpenzimet e Blerësit sipas udhëzimeve.

(c) Sipas procedurave standarde të tij për riparimin dhe zëvendësimin brenda kohës së garancisë, Furnizuesi do të bëjë përpjekjet e arsyeshme tregtare për të kthyer të gjithë artikujt që jepen për riparim ose zëvendësim Blerësit në mënyrën më të shpejtë dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për nisur të gjithë artikujt brenda 3 muajve nga data që mbërrijnë në mjedisin e Furnizuesit në Syracuse, NY. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për koston e riparimit ose të zëvendësimit të çdo artikulli të dëmtuar duke përfshirë dhe koston e transportit të kthimit nga Syracuse, NY në portin e hyrjes në Shqipëri. Të gjitha kostot e tjera të tilla si; transportimi në Shqipëri, shpërndarja dhe detyrimet doganore janë përgjegjësi të Blerësit. Nëse Furnizuesi nuk është në gjendje të riparojë ose zëvendësojë pjesën brenda afatit të më sipër atëherë Palët do të negociojnë për një kohë përkatësisht të pranueshme.

(d) Në rast se për një artikull të parregullt nuk është siguruar rezervë dhe problemi rezulton në humbje të ndonjë radari, AIS ose lidhjet VHF-FM me Bazën Detare, Furnizuesi do të ngarkojë një artikull zëvendësues për Blerësin ose do të rregullojë fillimin e shërbimit brenda 1 muaji nga njoftimi i Blerësit në përputhje me Nenin 16.b. Kushtet shtesë të mëposhtme zbatohen për përgjigje të këtij transportimi 1 mujor:

i. Çdo artikull i kërkuar nga shitësi(t) e Furnizuesit duhet të jetë në magazinë dhe i gatshëm për transportim tek Furnizuesi brenda 1 dite. Nëse kjo gjendje në magazinë nuk është e gatshme, përgjigjja do të gjendet në bazën më të mirë të mundshme të të dhënave.

ii. Blerësi do të ngarkojë artikullin e parregullt për në mjediset e Furnizuesit në Syracuse, NY, brenda 72 orëve të njoftimit.

iii. Nëse inspektimi i artikullit të parregullt tregon që problemi nuk është si rrjedhojë e defekteve të prodhimit, Blerësi do të jetë përgjegjës për koston e artikullit zëvendësues duke përfshirë dhe koston e ritransportimit nga Syracuse NY për në portin e hyrjes në Shqipëri. Në të kundërt, Furnizuesi do të jetë përgjegjës për këto kosto.

Të gjitha kostot e tjera, të tilla si transportimi në Shqipëri, dorëzimi dhe detyrimet doganore janë përgjegjësi e Blerësit. Nëse Furnizuesi nuk është në gjendje të ngarkojë brenda 1 muaji pjesën zëvendësuese, Palët do të negociojnë për një kohë të pranueshme nga të dyja palët.

(e) Koha e Garancisë për pjesët e zëvendësuara ose të riparuar do të jetë koha që mbetet nga Periudha e Garancisë.

(f) Furnizuesi brenda një hapësire të lejuar do t'i transferojë ose japë Blerësit çdo garanci të dhënë që vazhdon pas Periudhës së Garancisë nga furnizuesit ose nënkontraktorët e vetë Furnizuesit.

(g) KJO GARANCI JEPET DHE PRANOHET NE VEND TE GJITHË GARANCIVE TE TJERA TE PËRCAKTUARA OSE NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË ÇDO GARANCI TE SHITJES OSE RËNIES NE UJDI PËR NJË QËLLIM TE CAKTUAR. KOMPENSIMET E DHËNA NGA KJO MASE GARANCIE JANË KOMPENSIMET E VEÇANTA PËR GARANCI TE KËRKUARA NGA BLERËSI

(h) Mbështetja Pas Garancisë - Furnizuesi pranon të ofrojë Shërbime Ndihmëse për Pjesë Rezervë për një periudhë kohe deri në dhjetë (10) vjet pas përmbyshjes së kontratës së Periudhës së Garancisë. Këto shërbime do të kryen sipas një Kontrate të veçantë të Shërbimeve Ndihmëse për Pjesë Rezervë (ShNPR) ndërmjet Blerësit dhe Furnizuesit përmes së cilës bihet dakord përkatësisht për çmimin, shpërndarjen, afatet dhe kushtet e kontratës. Blerësi do të ketë të drejtën të fillojë negociatat për Kontratë ShNPR brenda një viti që nga përfundimi i Garancisë. Nëse palët nuk do të mund të bien dakord për afatet e Kontratës së ShNPR-se brenda dy viteve nga përfundimi i Garancisë, detyrimi i Furnizuesit për të hyrë në Kontratë ShNPR do të përfundojë.

Nëse gjatë periudhës 10 vjeçare Furnizuesi vendos, ka ndërmend ose detyrohet të ndërpresë prodhimin ose furnizimin e çdo pjese rezervë do t'i japë Blerësit me mundësinë e tij më të parë një njoftim një vjeçar me shkrim për ndërprerjen. Blerësi do të ketë mundësinë të blejë këto pjesë këmbimi ose të lejojë Shitësin të bëjë përpjekje për të rënë në ujdi me një palë të tretë për ngritjen e një burimi të vazhdueshëm për të njëjta pjesë rezervë pa ndikuar tek shkëmbimet e montimeve të mëdha ose nënmontimeve, përbërësve ose pjesëve. Veç kësaj Furnizuesi ndërmerr informimin e Blerësit kur është i vetëdijshëm për mosdisponibilitetin ose mosdisponibilitetin e pritshëm për çdo pjesë rezervë ose këmbimi që Furnizuesi siguron nga furnizuesit e tij.

17. INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Secila palë duhet të mbajë të fshehtë ose në të kundërt nuk duhet të përdorë ose të bëjë publike tek asnjë Palë e tretë, pa lejim paraprak me shkrim nga Pala tjetër, të dhëna ose informacion të Palës tjetër që përcaktohen si "Në Pronësi" ose "I fshehtë". Detyrimi në fjalinë paraardhës nuk do të zbatohet për të dhënat ose informacionin, i cili në kohën e zbulimit ishte ose më pas bëhet publik dhe që ishte në zotërim të Palës duke e marrë informacionin më përpara se ta marrë atë nga Pala tjetër, ose në të kundërt bëhet ligjërisht i përdorshëm nga Pala marrëse.

18. KUFIZIMI I PERGJEGJESISE

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e Kontratës asnjë nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëmtim të veçantë, rrjedhimor apo jo të drejtpërdrejtë. Secila Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër për dëmtime që në tërësi i tejkalojnë dhjetë përqind (10%) të Çmimit të Kontratës për dëmtime të shkaktuara ndaj Palës tjetër.

Pagesat për Veprimtaritë Kryesore nuk do të jenë çështje të këtij kufizimi të përgjegjësisë.

19. DËMET E LIKUIDUARA

(a) Furnizuesi do kryejë shpërndarjen përfundimtare të SIVHD pas përfundimit të SAT 3, e cila do të jetë edhe Veprimtaria përfundimtare në përputhje me Planin e Veprimtarive, i vendosur në Shtojcën 2. Palët bien dakord që dëmtimet ekzistuese të shkaktuara nga vonesa në shpërndarje e Furnizuesit do të jetë e vështirë të përcaktohen me saktësi. Prandaj Palët bien dakord që përveç sa përcaktohet në pikën 19 (d) më poshtë, nëse testimi i SAT 3 shtyhet për më tepër se një (1) muaj tej shpërndarjes së planifikuar ose kohës së vendosur për pagesën e Veprimtarisë Dymbëdhjetë përcaktuar në Nenin 11, cilito qoftë më vonë, dëmet e likuiduara në përkatësi të 19 (e) poshtë do të taksohen Blerësit në shkallën e TRE MIJE DOLLARËVE (US \$3,000.00) në ditë deri në përfundim të testimit SAT 3.

(b) Dëmet maksimale totale të likuiduara do të kufizohen për 5 (pesë) për qind të vlerës të Çmimit të Kontratës.

(c) Dëmet e likuiduara do të përfshihen në kufizimin e përgjegjësisë të përcaktuar në Nenin 16 të Kontratës.

(d) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara për shkak të dështimit të plotësimit të testimit SAT 3 që rezultojnë nga forca madhore, dështimi i Blerësit për mos plotësimin e detyrimeve kontraktore apo ndonjë arsye tjetër të rënë dakord nga Palët që ishte jashtë mundësive të kontrollit të Furnizuesit.

(e) Dëmet e Likuiduara, siç jepen këtu, do të jenë i vetmi shpërblim ekskluziv i Blerësit për vonesa si rrjedhojë e shkaqeve për të cilat është përgjegjës Furnizuesi.

20. LIGJI RREGULLUES

(a) Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit dhe Furnizuesit të përfshira në Kontratë do të drejtohen nga, zbatohen dhe interpretohen sipas ligjeve të Anglisë dhe të Uellsit, përveç konflikteve të saj mbi dispozitat ligjore.

(b) Palët bien dakord që Konventa mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave nuk do të aplikohet për zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate.

21. RIGORIZITETI DHE HEQJA DORË

(a) Nëse ndonjë dispozitë e Kontratës përcaktohet si e kundërligjshme, apo e papranueshme për zbatim, pjesa e mbetur e Kontratës do të vazhdojë të jetë plotësisht në fuqi.

(b) Mosarritja e zbatimit të ndonjë dispozite të Kontratës nga secila Palë nuk do ta zhvleftësojë këtë dispozitë ose ndonjë dispozitë tjetër të Kontratës dhe as Kontratën në tërësi. Dështimi në një apo më shumë raste i Palës për të vënë në zbatim ndonjë dispozitë të kësaj Kontrate nuk do të ndikojë në vënien në zbatim në vijimësi të kësaj dispozite.

(c) Nëse ndonjë dispozitë e Kontratës përcaktohet si e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme ose diskutohet si pasojë e një vendimi ose pretendimi bazuar në MOA apo ligjin e Parlamentit Shqiptar, Nr. 9384, datë 4.5.2005 që ratifikoi MOA, Furnizuesi do të ketë të drejtën të ndërpresë menjëherë punën. Si pjesë e çdo marrëveshje të diskutuar Furnizuesi do të ketë të drejtën e Rregullimeve të Paanshme - duke përfshirë por jo të kufizuara nga rregullimet e përshtatshme të Planit të Veprimtarive të Kontratës dhe/ose Çmimi i Kontratës që të pasqyrojë çdo kosto shtesë që rezulton të vihet në rrezik nga Furnizuesi, duke përfshirë por jo kufizuar në rritjet e kostove nga furnizuesit ose nënkontraktorët, dhe kosto të rritura të materialeve ose shpenzime pune mbështetur me dokumentacion. Nëse Palët nuk janë në gjendje të arrijnë në një marrëveshje për sa u përket ndryshimeve që rezultojnë nga përcaktimi ose pretendimi, Furnizuesi do të ketë të drejtën të përfundojë bisedimet me 60 ditë njoftim dhe të quajë Kontratën të përfunduar për Lehtësi të Blerësit në përputhje me Nenin 24(b) (iii).

22. E DREJTA E MIRATIMIT TE KONTRATËS

Kontrata do të jetë në të mirën e Palëve dhe do të jetë e detyrueshme për Palët dhe pasardhësit përkatës të caktuar e lejuar. Kontrata nuk mund të firmoset vullnetarisht në tërësi apo pjesërisht nga çdo Palë pa lejen me shkrim të Palës tjetër. Kjo leje nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

23. FORCA MADHORE

(a) Asnjë Palë nuk do të përgjigjet për ndonjë vonesë apo mosrealizim të detyrimeve të përcaktuara në Kontratë, shkaktuar nga ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme që është e paparashikueshme, e pashmangshme dhe përtej mundësive të kësaj Palë. Ndodhi të forcës madhore përfshijnë, por nuk janë të kufizuara ndaj veprimeve madhore të natyrës, mosmarrëveshjet e fuqisë punëtore, (duke përjashtuar mosmarrëveshjet me punonjësit e Furnizuesit) fatkeqësitë natyrore, zjarret, përmytjet, tërmetet, tufanet ose fenomene të tjerë meteorologjike, konfliktet ushtarake, embargot si dhe veprimet e qeverive të tjera që veprojnë brenda kapacitetit të sovranitetit të tyre. Dështimi apo refuzimi i Qeverisë së ShBA, Qeverisë shqiptare ose ndonjë qeverie tjetër ndikuese për të lëshuar licencën e eksportit, për një pjesë apo për të gjithë Pajisjet dhe Shërbimet ose kthimi mbrapsht, qoftë ky edhe i pjesshëm për licencën e transportit apo importit, për çdo arsye do të quhet si çështje e forcës madhore që i nënshtrohet dispozitave të këtij Neni. Vonesa në marrjen e Pagesës së Letër Kreditit për çfarëdo arsye nuk do të quhet çështje e forcës madhore.

(b) Pala e ndikuar nga çështjet e Fuqisë Madhore do të informojë me shkrim Palën tjetër për ndodhinë dhe natyrën e çështjes së forcës madhore, brenda 10 ditësh nga koha kur ata e vënë re ose e përcaktojnë dukurinë e fuqisë madhore.

(c) Pala e ndikuar do të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme, për të zbutur ndikimin e çdo dukurie të forcës madhore.

(d) Datat e caktuara në Programin e Veprimtarive Kryesore dhe ndonjë datë tjetër e përfshirë në Kontratë që ndikohen nga dukuria e forcës madhore do të shtyhen në një periudhë të barabartë me

vonesën e shkaktuar.

(e) Në rastin kur dukuria e forcës madhore mbetet për një periudhë kohore prej më shumë se 180 ditësh secila palë mund të ndërpresë kontratën dhe Blerësi do t'i paguaj Furnizuesit në përputhje me Shtojcën 2 vlerën për të gjitha Zërat Kryesorë që janë realizuar dhe nuk janë paguar ende. Blerësi do t'i paguajë gjithashtu Furnizuesit çdo kosto shtesë të shkaktuar ose kryer për Zërat Kryesore që nuk janë realizuar. Furnizuesi do t'i dorëzojë Blerësit të gjithë Pajisjet që ka siguruar.

24. NDËRPRERJA DHE PEZULLIMI.

(a) Ndërprerja për Mosrealizim

(i) Në qoftë se njëra Palë nuk arrin të përmbushë nga ana materiale cilindo nga detyrimet e saj kontraktuese, Pala tjetër mund të ndërpresë Kontratën për Mosrealizimin.

(ii) Për të ndërprerë Kontratën, Palës mospërmbushëse do t'i jepet lajmërim me shkrim (veç pagesës së parave për të cilën nuk kërkohet njoftim) nga Pala tjetër dhe do të ketë 45 ditë nga data e këtij lajmërimi për të korrigjuar mosrealizimin e menduar ose të paraqesë një plan veprim korrigjimi të pranueshëm. Nëse kjo Palë nuk arrin ta korrigjojë në kohë mosrealizimin, Pala tjetër mund ta ndërpresë Kontratën për Mosrealizim duke e njoftuar për ndërprerje palën mosrealizuese.

(iii) Në rastin e Ndërprerjes për Mosrealizim nga Furnizuesi, Furnizuesi do t'i dorëzojë Blerësit të gjithë punën e bërë dhe të shlyer deri në ditën e Ndërprerjes. Për më tej nëse si rrjedhojë e Ndërprerjes për Mosrealizim, SIVHD sigurohet nga Blerësi, Furnizuesi do të jetë përgjegjës sipas kufizimit të përshkruar në Nenin 18 të kësaj Kontrate, për kostot e tejkaluara të risigurimit, këto kosto të përcaktohen si diferencë ndërmjet vlerës së kësaj Kontrate dhe kostove shtesë përtej vlerës së kësaj Kontrate të nevojshme për përmbushjen e kryerjes së projektit nga një furnizues tjetër.

(iv) Në rastin e Ndërprerjes për Mosrealizim nga Blerësi, Blerësi do të paguaj Furnizuesin së paku derisa Furnizuesi nuk është paguar ose rimbursuar tashmë nga Blerësi

(1) në bazë të Çmimit të Kontratës, për të gjithë veprimet e përfunduara dhe

(2) shumën e barabartë me çmimin e vlerësuar të Veprimtarisë së radhës, sipas Planit të Veprimtarisë përshkruar në Shtojcën 2, bazuar në periudhën kohore ndërmjet Veprimtarisë së fundit të përfunduar dhe Veprimtarisë së radhës për tu bërë. Letër Kredia do të jepet për pagesën e pjesshme të kësaj Veprimtarie në rast ndërprerje.

(b) Ndërprerja për Lehtësi.

(i) Secila Palë mund të ndërpresë Kontratën për Lehtësi, duke i paraqitur njoftimin me shkrim Palës tjetër.

(ii) Në qoftë se Furnizuesi ndërpret për Lehtësi, në alternativat e Blerësit:

(A) Furnizuesi do t'i kompensojë Blerësit brenda nëntëdhjetë ditëve çdo pjesë të Çmimit të Kontratës paguar deri në datën e përfundimit, dhe Blerësi do t'i kthejë pronën dhe të drejtën Furnizuesit për çdo pjesë të SIVHD të dorëzuar Blerësit; ose

(B) Furnizuesi do t'ia kalojë pronën dhe të drejtën Blerësit për çdo pjesë të SIVHD të përfunduar ose pjesërisht të përfunduar dhe cilëndo lëndë të parë ose furnizime të blera nga Furnizuesi brenda Kontratës, për një shumë të barabartë me vlerën e arsyeshme dhe të favorshme për këto Pajisje, materiale dhe furnizime të tilla të kaluara në këtë mënyrë, shkarkon Blerësin nga çdo Pagesë tjetër për Zërat Kryesore.

(iii) Në qoftë se Blerësi përfundon për Lehtësi, Blerësi do t'i paguajë Furnizuesit së paku derisa Furnizuesi nuk është paguar ose rimbursuar nga Blerësi

(A) në bazë të Çmimit të Kontratës, për të gjithë veprimet e përfunduara dhe;

(B) shumën e barabartë me çmimin e vlerësuar të Veprimtarisë së radhës, sipas Planit të Veprimtarisë përshkruar në Shtojcën 2, bazuar në periudhën kohore ndërmjet Veprimtarisë së fundit të përfunduar dhe Veprimtarisë së radhës për t'u bërë. Letër Krediti do të jepet për pagesën e pjesshme të kësaj Veprimtarie në rast ndërprerje.

(c) Pezullimi

(i) Çdo Palë mund të pezullojë përmbushjen brenda Kontratës në çdo kohë para përfundimit të Kontratës, për një periudhë jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë. Po të mos bien palët dakord, pezullimi përtej një periudhë të tillë gjashtëdhjetë (60) ditore do të përbëjë ndërprerjen për lehtësi nga Pala përkatëse në vijim të Paragrafit 24 (b) të mësipërm. Nëse secila Palë pezullon Kontratën, Pala që deklaron Pezullimin do të njoftojë menjëherë Palën tjetër që të jetë në dijeni për nevojën për të Pezullim. Njoftimi do të përmbajë informacionin e mjaftueshëm për të justifikuar kërkesën për

Pezullim. Blerësi nuk do ta ketë këtë të drejtë lidhur me detyrimin e tij për vendosjen e Pagesës së Letër Kreditit.

(ii) Në kohën ose para përfundimit të 60 ditëve nga fillimi i Pezullimit, Pala pezulluese duhet ose ta njoftojë palën tjetër të vazhdojë ose të ndërpresë Kontratë për Lehtësim.

(iii) Nëse Pala që nuk kërkon Pezullimin i shkaktohen kosto shtesë si rrjedhojë e Pezullimit, atëherë Pala që kërkon shtyrjen do të përgjigjet për këto kostot.

(iv) Pala që nuk kërkon Pezullimin do të ketë të drejtë të bëjë rregullime në Programin e Zërave Kryesore nëse është e nevojshme.

25. ZGJIDHJA E KONFLIKTIT

Palët do të orvaten që me anë të bisedimeve të zgjidhin me dashamirësi dhe mirëbesim çdo konflikt që lind gjatë ose lidhur me Kontratën ose që ka të bëjë me mosmarrëveshje të pretenduar të kësaj Kontrate brenda tridhjetë (30) ditëve të njoftimit nga njëra Palë për tjetrën për ekzistencën e një konflikti apo në ndonjë tjetër periudhë kohore për të cilën mund të bien dakord përkatësisht.

Në rastin kur konflikti nuk zgjidhet siç jepet në paragrafin (a), të gjitha mosmarrëveshjet do t'i nënshtrohen më në fund Rregullave të Arbitrazhit të Rregullave të Këshillimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë me tre gjyqtarë të emëruar sipas Rregullave të lartpërmendura. Vendi i Arbitrazhit do të jetë në Vjenë, Austri. Arbitrazhi do të bëhet në gjuhën angleze dhe çdo vendim që do të merret nga grupi i arbitrazhit do të jetë gjithashtu në gjuhën angleze. Vendimi i shumicës të gjyqtarëve do të jetë përfundimtar dhe detyrues dhe do të jetë i zbatueshëm për çdo gjykatë me kompetencë juridike.

Në asnjë rast vendimi i Arbitrazhit nuk do të kalojë Kufizimin e Detyrimit të Palëve përcaktuar këtu në Nenin 18.

26. LIGJET DHE RREGULLAT E EKSPORTIT

(a) Kontrata dhe të gjitha detyrimet e Palëve u nënshtrohen të gjithë ligjeve dhe rregullave të eksportit e importit të Shteteve të Bashkuara, Shqipërisë apo të ndonjë vendi tjetër të zbatueshëm dhe çdo pale do të pajtohet plotësisht me të gjitha ligjet dhe rregullat në fjalë ndërsa ato mund të zbatohen për Pajisjet/Shërbimet.

(b) Për çka ndalojnë ligjet e eksportit në ShBA apo vende të tjera sipas rastit, çdo e dhënë teknike që lidhet me SIVHD e dhënë sipas kësaj kontrate dhe/ose çdo marrëveshje për ndihmë teknike midis Palëve dhe/ose dispozitave të përgatitjes të vendosura në ose nëpërmjet Kontratës, përfshi shtesat përkatëse, që lidhen me SIVHD nuk janë të autorizuar të shiten, jepen me qera ose rijepen me qera, jepen, transferohen, transportohen ose në ndonjë mënyrë tjetër të zhduken në ose drejt çdo vendi të huaj ose shteti jashtë destinacionit që është për qëllim sipas kësaj Kontrate pa marrëveshjen paraprake të Furnizuesit.

(c) Furnizuesi do të bëjë të gjitha përpjekjet e pranueshme për marrjen e çdo autorizimi të nevojshëm për eksportin e Pajisjeve, përfshi edhe cilëndo licencë eksporti ose autorizim tjetër të Qeverisë së ShBA ose vendit tjetër zbatues. Blerësi dhe Furnizuesi do të ndihmojnë njëri tjetrin në sigurimin dhe pajtimin me autorizime të tilla. Në rast kur autorizimi i eksportit nuk mund të merret, ato Pajisje që nuk mund të eksportohen, nuk do të shpërndahen dhe do të bëhet Rregullimi i Paanshëm i çmimit.

27. GJUHA E KONTRATËS

Afatet dhe Kushtet me Shtojcat dhe Qëllimi i Furnizimit të Kontratës do të shkruhen dhe zbatohen në të dyja gjuhët angleze dhe shqipe. Versionit në gjuhën angleze do t'i jepet përparësi në rast të çdo mosmarrëveshje në interpretimin e kësaj kontrate. Të gjithë dokumentet e Kontratës dhe të dhënat teknike (përfshi por jo e kufizuar në Propozimet Teknike, specifikimet, etj.) do të shkruhen dhe interpretohen vetëm në gjuhën angleze.

Të gjitha raportet, njoftimet, ankesat, kërkesë pagesat ose informacione e të dhëna të tjera, të kërkuara gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të shkruhen në gjuhën angleze.

28. NJOFTIMET

(a) Të gjitha njoftimet dhe komunikime të tjera midis Furnizuesit dhe Blerësit do të jepen në adresat përkatëse të të dy Palëve të dhëna në Shtojcën 8- ADRESAT PËR NJOFTIM. Palët janë të lira të ndryshojnë kontaktin për njoftim, pa u dashur të ndryshojnë Kontratën.

(b) Çdo njoftim i transmetuar në lidhje me Kontratën do të jetë i vlefshëm kur të merret me shkrim në adresën e dhënë në SHTOJCËN 8. Njoftimet do të dërgohen apo transmetohen nëpërmjet çdo mënyre të arsyeshme për t'u marrë në kohë nga Pala tjetër, përfshi, pa kufizim, me FAKS apo me

shërbimin e dërgimit tregtar.

Posta elektronike mund të përdoret si mjet shtesë për të dhënë njoftimin por nuk do të quhet zyrtare deri në dhënien e njoftimit me mjetet e mesipërme.

29. NDRYSHIMET NË KONTRATË

Secila Palë mund të kërkojë ndryshime në Kontratë. Pala që kërkon ndryshim do të dërgojë paraprakisht kërkesë për ndryshim të Kontratës Palës tjetër. Pala tjetër do t'i përgjigjet kërkesës në fjalë brenda caktuar kohor të 45 ditëve, duke përcaktuar çdo ndikim në Çmimin e Kontratës, Planin e Pagesës, Planin e Zërave Kryesore ose kushte të tjera të Kontratës. Asnjë kërkesë për ndryshim nuk do të jetë e vlefshme veç asaj të dërguar me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i të dy Palëve. Asnjë Palë nuk është e detyruar të zbatojë ndryshimin e propozuar nëse nuk ka një marrëveshje të ndërsjellë për ndryshimin e propozuar.

30. PAJISJET (BFE) / MJEDISËT (BFF) / SHËRBIMET (BFS) DHE INFORMACIONI (BFI) QË FURNIZOHET BLERËSI

Të gjitha pajisjet, mjediset, shërbimet apo informacioni për furnizim nga Blerësi do të jenë siç janë listuar në Shtojcën 4. Blerësi përgjigjet për gjendjen e të gjitha pajisjeve dhe mjedisëve përfshi çdo pikë ku vendosen SIVHD. Blerësi do të përgjigjet gjithashtu për saktësinë e informacionit ose të dhënave që jepen nga Blerësi.

Në rast humbjeje apo dëmtimi të Pasurisë së Furnizuar ndaj Blerësit si rezultat vetëm i neglizhencës të Furnizuesit, Furnizuesi do të riparojë ose zëvendësojë këtë pasuri me shpenzimet e Furnizuesit ose, sipas vlerësimit të Furnizuesit, do t'i paguajë Blerësit vlerën e pasurisë.

3.1. E DREJTA E NJOHURISË

(a) Furnizuesi do të mbajë të drejtën ndaj të gjitha të dhënave, informacionit, skicat, përcaktimet e veçanta, projektet dhe materiale të ngjashme që jepen nga Furnizuesi për përmbushjen e Kontratës. Furnizuesi gjatë gjithë kohës do të ketë dhe ruajë të drejtën për pronësi të plotë për të gjithë të drejtën e njohurisë, përfshi shenjat dalluese, të drejtën e autorit (përfshi softuere), të drejtat e patentës, e sekretit të mjeshtërisë, përfshirë çdo të drejtë njohurie që ekziston gjatë kohës së kësaj Kontrate si dhe çdo e drejtë njohurie që zhvillohet gjatë përmbushjes së kësaj Kontrate. Furnizuesi do t'i garantojë Blerësit licencën e kufizuar jo ekskluzive, për të përdorur të drejtën e njohurisë, siç do të kërkohej për punën me SIVHD që lëvrohen sipas kësaj Kontrate. Kjo licencë është e patransferueshme dhe Blerësi nuk do t'i japë ndonjë të drejtë të tillë njohurie ndonjë pale të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Furnizuesit. Furnizuesi gjithashtu do t'i japë Blerësit licencën e MTM 200 të Furnizuesit dhe softuere të tjerë tregtarë.

(b) Në asnjë rast në detyrimet e Furnizuesit sipas kësaj Kontrate nuk do të mendohet të përfshihet dhënia e ndonjë kodi burim të softuerit.

(c) Blerësi nuk do të heqë ndonjë shenjë të së drejtës, ekspozim të së drejtës së pronësisë intelektuale apo shënime të ngjashme, legjendë ose shenjë për ndonjë Pajisje apo dokument që lidhen me përmbushjen e kësaj Kontrate.

32. ZËVENDËSIMI I PJESËVE

(a) Furnizuesi mban të drejtën për të zëvendësuar pjesët e zgjedhura me përjashtim të pajisjeve të përcaktuara në nënparagrafin (b) poshtë dhe/ose Pajisjet me pjesë të tjera dhe/ose Pajisjet me mundësi funksionimi të njëjtë ose më të lartë që nuk bien ndesh me formën, përshtatjen apo funksionimin e Pajisjeve. Për të gjithë kompjuterët desktop dhe shërbimet Furnizuesi do të jetë i lirë për të siguruar pajisje nga çdo kategori Tier 1 prodhimi (Dell, Hewlett Packard, IBM). Zëvendësime të tilla do të dokumentohen nga Furnizuesi dhe do t'i paraqiten Blerësit.

(b) Për nënsistemet kryesore; radarët, mikrovalët, AIS dhe "rrotulluesve" të rrjetit, në qoftë se Furnizuesi dëshiron të ndryshojë shitësin e pajisjeve, Furnizuesi do t'ia paraqesë ndryshimin e propozuar Blerësit për miratim. Kjo është e vlefshme edhe për zëvendësimet që mund të ndikojnë në formë, përshtatje apo funksionim. Blerësi do të përgjigjet brenda 30 ditëve për kërkesat e paraqitura sipas këtij Paragrafi. Nëse nuk jepet një përgjigje brenda kësaj kohe zëvendësimi do të mendohet i pranuar nga Blerësi.

(c) Me përcaktimin nga Furnizuesi që një proces dhe /ose një përbërës i nevojshëm në prodhim, testim apo lëvrim të ndonjë artikulli të Pajisjeve të dhënë në qëllimin e FURNIZIMIT është i papërshtatshëm falë vjetërimit apo zvogëlimit të burimeve prodhuese Furnizuesi do të ketë të drejtën të sigurojë zëvendësimin e përshtatshëm dhe çdo rritje në kosto për këtë zëvendësim do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Zëvendësimi i përshtatshëm përfshin çdo artikull që kryen të njëjtin funksion

si artikulli origjinal i destinuar dhe përcaktohet të jetë i ngjashëm apo me cilësi më të mirë. Furnizuesi do të njoftojë Blerësin për këtë ndryshim kur Lista Përfundimtare e Pajisjeve, që do të jetë dokument që jepet në Qëllimin e Furnizimit, t'i jepet Blerësit. Ndonjë ndryshim për shkak të zvogëlimit të burimeve të prodhimit do të shoqërohet me informacion të bollshëm për të justifikuar ndryshimin.

33. TRAJNIMI

(a) Për çdo trajnim të bërë nga Furnizuesi për Blerësin në mjediset e Furnizuesit, Blerësi do t'i paraqesë Furnizuesit listën e emrave të pjesëmarrësve të caktuar së paku 30 ditë para mbërritjes së tyre në mjedisin e Furnizuesit në Syracuse, N.Y.

(b) Blerësi do të përgjigjet për marrjen e Vizës së duhur të hyrjes nga Ambasada ose Konsullata përkatëse e SHBA, nga imigrimi dhe autorizime të tjera për secilin pjesëmarrës para mbërritjes në SHBA. Furnizuesi do t'i paraqesë ftesë zyrtare Ambasadës së SHBA në vend dhe Blerësit për lëshimin e vizës.

(c) Furnizuesi mban të drejtën të mos pranojë apo të heqë pjesëmarrësin nga pjesëmarrja në çdo kurs trajnimi, në rast se pjesëmarrësi në fjalë nuk arrin të veprojë sipas ligjeve të SHBA-së (Federal, Shtetëror apo vendor) apo sipas politikave të Lockheed Martin. Politikat e Lockheed Martin gjenden të bashkangjitura si në Shtojcën 10.

34. STANDARDET

Furnizuesi do të prodhojë SIVHD sipas standarteve dhe praktikave të tanishme të Furnizuesit dhe nënkontraktorëve të Furnizuesit.

Furnizuesi është regjistruar në:

Standarde të Cilësisë AS9100B:2004-01

ISO 9001

ISO 1400 për Administrim Mjedisi

35. SIGURIA

Furnizuesi ruan të drejtën që të tërhiqet nga plotësimi i kërkesave për mbështetjen në vend, në qoftë se siguria e nëpunësve të Furnizuesit ose nënkontraktorëve mund të vihet në rrezik. Në rast se Furnizuesi ndërpret ndonjë pjesë të kontratës për shkak të problemeve të sigurisë, Palët do të bisedojnë për Rregullim të Paanshëm të Kontratës ose diskutojnë trajnimin e personelit të Blerësit për të përmbushur këto detyra. Nëse trajnimi jashtë Shqipërisë është pranuar nga Furnizuesi, ky do të paguajë kostot e Udhëtimit dhe Strehimit për personelin e Blerësit.

36. HEDHJA E MATERIALIT TË TEPËRT

Hedhja e çdo materiali të tepërt dhe mbetjeve të prodhuara në Shqipëri si rrjedhojë e veprimtarisë së Furnizuesit sipas kësaj Kontrate, do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Blerësi do t'i japë Furnizuesit kopjen e çdo ligji vendor në fuqi për hedhjen e materialeve në fjalë brenda 30 ditëve pas kërkesës. Blerësi bie dakord për të zhdëmtuar Furnizuesin dhe Lockheed Martin Corporation dhe ndihmës të tjerë të tij për çdo dëm si pasojë e manovrimit të Furnizuesit ose zhdukjes të materialit të tepërt apo mbetjeve.

37. DËMSHPËRBLIMI

Blerësi do të dëmshpërblejë dhe ruajë të padëmtuar Furnizuesin nga cilado dhe nga të gjitha ankesat apo kërkesat e bëra nga cilido person apo organ ligjor i çfarëdo natyre qoftë ndaj Furnizuesit, shoqërisë mëmë apo degëve të saj, ose cilido zyrtar, drejtor ose nëpunës i mësipërm, lidhur me ndonjë vdekje, dëmtim, dëm apo humbje përfshirë interesat, pagesën dhe shpenzimet që lindin, ose mendohet se lindin, qoftë drejtpërdrejt apo jo, nga përdorimi apo vënia në punë e pajisjeve, SIVHD ose çfarëdo materiali tjetër që lëvrohet sipas ose lidhur me artikujt e lëvrueshëm të kësaj kontrate. Kërkesat e këtij Paragrafi do të kenë fuqi tej afatit të Kontratës. Kjo kërkesë nuk do të zbatohet për ankesa dhe kërkesa që ndodhin gjatë ndërtimit dhe instalimit të SIVHD ose nga kontakti i drejtpërdrejtë me Pajisjen për tridhjetë e gjashtë muaj nga Pranimi i SIVHD nëse dëmi i menduar është si pasojë e neglizhencës së tepruar ose shkeljes me qëllim nga Furnizuesi.

Këto Afate dhe Kushte nënshkruhen nga përfaqësuesi i autorizuar i çdo Pale sipas datës të dhënë më poshtë.

LOCKHEED MARTIN GLOBAL INCORPORATED

Nga: _____

Firma: _____

Funksioni: _____

Data: _____

KëSHILLI i MINISTRAVE i REPUBLIKËS Së SHQIPËRISë

Përfaqësuar nga:

Ministria e Mbrojtjes

Nga: _____

Firma: _____

Funksioni: _____

Data: _____

SHTOJCË 1, SUPOZIMET DHE KUSHTET E VLERËSIMIT
(Shih Supozimet dhe Kushtet bashkëlidhur)

SHTOJCË 2, PROGRAMI I VEPRIMTARIVE

Nr.	Veprimtaria	Produkti	Programi (Muajt pas datës efektive të Kontratës)	Vlera e Veprimtarisë*
1	Kontrata		0	0
2	Rishqyrtimi i projektit të Sistemit	Dokumentacioni SDR	4	\$2.431.797
3.	Lëvrimi i pajisjeve të Kullës	Materialet e montimit të Kullës	6	\$1.524.147
4.	Lëvrimi i Gjeneratorit/Strehimit	Kompletet e gjeneratorit dhe strehimet e pajisjeve	8	\$2.279.172
5.	Lëvrimi i radarit Faza 1	Sensorët radar dhe procesorët e të dhënave radar	14	\$ 309.711
6.	Sistemi FAT	Pajisjet dhe sensorët VTMS (veç radarëve)	15	\$3.297.473
7.	Lëvrimi i pajisjeve Mikrovale	Rrjeti i Gjerë i Zonës Mikrovalë (WAN)	16	\$1.788.672
8.	Lëvrimi i radarit faza 2	Sensorët radar dhe procesorët e të dhënave radar	17	\$309.711
9	Faza e 1 SAT	Faza 1 SIVHD dhe dokumentacioni i trajnimit	20	\$934.347
10	Lëvrimi i radarit Faza 3	Sensorët radar dhe procesorët e të dhënave radar	22	\$1.553.993
11	Faza e 2 SAT	Faza 2 SIVHD dhe dokumentet e trajnimit	22	\$1.124.493
12	Faza e 3 SAT	Faza 3 SIVHD (përfundimtare) dhe pajisjet ATC Display	25	\$1.546.494

* Përqindja e realizimit të Kontratës dhe për rrjedhojë përqindja e vlerës së kontratës së marrë shoqëruar me SIVHD – pas përfundimit të Veprimtarisë.

SHTOJCË 3, PROGRAMI I PAGESËS

Shih Nenin 11.

SHTOJCË 4, - PAJISJET që I FURNIZOHEN BLERËSIT / MJEDISËT / SHËRBIMET DHE INFORMACIONI

(Shih bashkëlidhur) Pajisjet që i furnizohen Blerësit / Mjedisit / Shërbimet dhe Informacioni

SHTOJCË 5, ÇMIMI I KONTRATËS

Pikënisja SIVHD Shqipëri \$17.1000.000.00 Dollarë të Shteteve të Bashkuara

SHTOJCË 6, FORMULAR GARANCIE I KORPORATËS LOCKHEED MARTIN (MODEL)

[Muaj, Datë, 20__]

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë

[Adresa]

SHQIPËRI

Zotërinj:

Kjo Garanci bëhet nga Korporata Lockheed Martin Corporation, një korporatë nga Maryland ("Lockheed Martin"), për leverdi të [Entit Kontraktues, Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë] ("KLIENTI").

Lockheed Martin është shoqëria bazë mëmë e Lockheed Martin Global, Inc. ("Filiali"). Filiali dhe KLIENTI kanë lidhur Kontratën Nr. _____ datë ____ ____ 20__ për furnizimin e _____ ("Kontrata").

Si pjesë e detyrimeve të KLIENTIT në këtë Kontratë, KLIENTI do t'i bëjë pagesën Filialit në shumën e US\$ _____ para Lëvrimit plotësues të Sistemit të Vëzhgimit Bregdetar ("Pagesë Paradhënie").

Në këtë mënyrë, Lockheed Martin garanton shlyerjen e KLIENTIT nga Filiali të një pjese apo të gjithë Pagesës Paradhënie që merret sipas Kontratës, nëse kjo shlyerje do të bëhet e pagueshme sipas afateve dhe kushteve të Kontratës (shuma e tillë e shlyerjes përkatëse referohet më poshtë si "Detyrim i Shlyerjes"). Në qoftë se Filiali nuk përmbush Detyrimin e Shlyerjes, atëherë Lockheed Martin, brenda 30 ditësh pune, merr përsipër respektimin e Detyrimit të Shlyerjes sipas Kontratës, nënshtruar të gjitha kufizimeve, shfajësimeve dhe mbrojtjeve të disponueshme për Filialin, të cilat burojnë nga kontrata ose ndryshe.

Para se të veprohet kundër Lockheed Martin sipas kësaj garancie (a) KLIENTI së pari do t'i paraqesë Filialit kërkesën me shkrim për shlyerjen e Pagesës Paradhënie të pretenduar nga Klienti të jetë bërë pikërisht sipas Kontratës (me një kopje për Lockheed Martin) dhe çfarëdo periudhë ndreqje e zbatueshme për një shlyerje të tillë siç është paraqitur në Kontratë do të ketë mbaruar pa ndreqje nga Filiali, dhe (b) KLIENTI do të njoftojë me shkrim Lockheed Martin në adresën e dhënë më poshtë për mosshlyerjen e tillë nga Filiali, që kërkesa e njoftimit mund të përmbushet duke i transmetuar një kopje Lockheed Martin për njoftimin me shkrim të përmendur më sipër ose kërkesa e dhënë Filialit në mënyrën që jepet në Kontratë dhe formulimin e nënshkruar nga zyrtari i KLIENTIT që shlyerja nuk është bërë nga Filiali.

Kjo Garanci nuk do të interpretohet për t'i imponuar Lockheed Martin ndonjë detyrim më të madh sesa përveç Detyrimit të Shlyerjes, pranohet shprehimisht nga Filiali sipas Kontratës dhe Lockheed Martin nuk do të përgjigjet për dëmet, përfshirë dëmet e rëndësishme, të rastësishme, të veçanta, të tërthorta apo ndëshkimore apo dhënien e shpenzimeve gjyqësore (përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet gjyqësore) për të cilat Filiali nuk do të përgjigjet sipas Kontratës. Në asnjë rast borxhi i grumbulluar i Detyrimit të Shlyerjes të Filialit dhe Lockheed Martin nuk do të kalojë totalin, për të cilin Filiali do të jetë i detyruar sipas Kontratës për Detyrim Shlyerjeje.

Kjo garanci mund të mos përcaktohet, në tërësi apo pjesërisht, nga KLIENTI pa pëlqimin e shprehur me shkrim të Lockheed Martin (pëlqimi i të cilit mund të jepet ose refuzohet si zgjedhjen e vetme të Lockheed Martin).

Ky instrument mishëron të tërë marrëveshjen midis Lockheed Martin dhe KLIENTIT lidhur me këtë Garanci, nuk ka premtime, afate, kushte apo detyrime të tjera veç atyre që përfshihen këtu dhe kjo marrëveshje Garancie do të tejkalojë të gjitha komunikimet, përfaqësimet apo marrëveshjet e mëparshme, qofshin ato me gojë apo me shkrim lidhur me subjektin në fjalë. Asnjë dispozitë e kësaj Garancie nuk mund të ndryshohet apo përmirësohet veç dokumentit me shkrim të nënshkruar nga Lockheed Martin dhe KLIENTIT, duke ju referuar shprehimisht dispozitave të kësaj Garancie.

Në të gjitha pikëpamjet, kjo Garanci do të drejtohet apo interpretohet sipas ligjeve të Shtetit të Nju Jorkut, SHBA, duke përfshirë të gjitha çështjet e udhëzimit, vlefshmërisë dhe përmbushjes, pavarësisht nga zgjedhja e dispozitave ligjore prej saj.

Kjo Garanci do të jetë në fuqi nga data e marrjes së Pagesës Paradhënie nga Ndhimësi dhe vazhdon gjatë, dhe duke përfshirë ë30 ditë pas plotësimit të llogaritur të Fazës së 3 SAT].

LOCKHEED MARTIN CORPORATION

Nga: _____ Nga: _____

Emri: _____ Emri: _____

Funksioni: _____ Funksioni: _____

Adresa për njoftim:

Adresa për njoftim:

6801 Rockledge Drive

Bethesda, MD 20817

U.S.A.

Për dijeni: Z/V Presidenti dhe Arkëtari _____ Për dijeni: _____

Faksimile: 301-897-6929

Faksimile: _____

SHTOJCË 7, TESTI I PRANIMIT

Shih pjesën 3.3 Qëllimi i Furnizimit, bashkëlidhja 1

SHTOJCË 8, ADRESAT PËR NJOFTIM

Për Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë

Emri: _____

Adresa: _____

Nr. Tel #: _____

Nr. Faks #: _____

Për Lockheed Martin Corporation

Emri: _____

Adresa: Lockheed Martin Global Inc.

P. O. Box 4840

Syracuse NY 13221-4840 _

Bldg. EP6 Room 225 _

Tel #: _____

FAX #: _____

SHTOJCË 9, LETËR E DOKUMENTUAR E FORMAT KREDITIT DHE ÇERTIFIKATAT
E ARRITJES së VEPRIMTARIVE
MODEL Letër Krediti 1

Banka Financuese: [Emri i Bankës Dhënëse]
[Adresa e Bankës Dhënëse]
Banka Pagueuse: [Banka Pagueuse]
[Adresa e Bankës Pagueuse], ShBA
Përfituesi/Shitësi: Lockheed Martin Global, Inc.
Sisteme & Sensorë Detarë
Electronics Park
Syracuse, NY 13221
Aplikuesi: [Emri i Aplikuesit]
ëAdresa e Aplikuesit]
Data e Lëshimit: _____

Skadimi: [fut datën Tre (3) muaj mbas datës së pagesës së fundit të pritur] në sportelet e bankës paguese në SHBA
Monedha & Sasia: US\$ [Çmimi i Kontratës]

Zotërinj:

Me urdhër të klientit tonë, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare (“Aplikuesi” ose “Blerësi”), ne lëshojmë në favorin tuaj Letër Kreditin e Dokumentuar të pakthyesëm Nr. ëNr Kreditit] (“Letër Krediti”) në shumën e US\$ ëshuma e vlerës së kontratës], kjo shumë mbulon pagesën për ëPërshkrim i Shkurtër i Furnizimeve, Shërbimeve ose të Dyja që Lëvrohen) sipas Kontratës Nr. ë] (“Kontrata”).

E disponueshme nga: BANKA Pagueuse me: BISEDIME

Pagesë e Pjesshme: E LEJUAR

Fondet sipas Letër Kreditit do t’i paguhen Përfituesit përkundrejt dokumenteve faktikë të mëposhtëm:

- 1.) Originali i Letër Kreditit; dhe
- 2.) Një çek i pagueshëm i tërhequr në Bankën Pagueuse; dhe
- 3.) Pesë kopje të firmosura me dorë të faturës tregtare të Përfituesit që identifikon numrin e pagesës së mundshme dhe përshkrimin e veprimtarive të realizueshme, siç përshkruhet më poshtë në Planin e Përparimit të Pagesës; dhe

4.) Ose

a. Për pagesën e parë, Pagesë Paradhënie: kopje e garancisë të korporatës Lockheed Martin kryesisht sipas formatit bashkëlidhur në Shtojcën 6; ose

b. Për pagesën e dytë: Çertifikatë e Përmbushjes të Veprimtarive (“ÇPV”) e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi, ose ÇPV me firmën e Përfituesit dhe një letër në kreun e letrës të Përfituesit që tregon se Përfituesi ka përmbushur kriteret e pagesës dhe se, në përputhje me afatet dhe kushtet e Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e Rishqyrtimit të Projektit të Sistemit (SDR); ose

c. Për pagesën e tretë: ÇPV e nënshkruar nga blerësi dhe Përfituesi; dhe/ose ÇPV me firmën e Përfituesit dhe letër në krye të letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur kriteret e pagesës dhe se, në përputhje me afatet dhe kushtet e Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV(s) pa kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e Lëvrimit të pajisjeve të Kullës; ose

Tërheqjet mund të bëhen rastësisht pa rend të rregullt dhe ndonjë herë para skadimit të Letër Kreditit, për aq kohë sa tërheqja individuale nuk kalon vlerën e treguar më lartë për çdo pagesë të punës së bërë.

Të gjitha çeqet dhe faturat e paraqitura me Letër Kreditin duhen shënuar me këtë Nr. të Letër Kreditit të Dokumentuar ëLetër Kredit Nr.].

Dokumentet e paraqitura më shumë se sa 21 ditë pas dhënies të dokumenteve, por brenda vlefshmërisë të këtij Krediti të Dokumentuar: TE PRANUESHME.

Në qoftë se afati nuk shtyhet nga ne, kjo Letër Krediti do të mbarojë në sportelet e bankës paguese në Shtetet e Bashkuara në ëfut ditën e mbarimit] (“Data e Mbarimit”). Ne në këtë mënyrë

biem dakord që çequet e tërhequra sipas afateve dhe kushteve sa më poshtë do të respektohen aq sa duhet në se paraqiten në apo para ditës së mbarimit.

Të gjitha detyrimet e shkaktuara lidhur me lëshimin dhe mbajtjen e këtij Letër Krediti në Shqipëri janë për llogari të Aplikuesit. Të gjitha detyrimet e shkaktuara në Shtetet e Bashkuara janë për llogari të Përfituesit.

Ky letër kredit i nënshtrohet Praktikave dhe Zakoneve të Njëjtësuarra për Kreditet e Dokumentuara (UCP) (Rishikimi i vitit 1993) Publikimi Nr. 500 të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, veç Neneve 17 dhe 41 dhe na detyron në përputhje me afatet e tij. Nqs. Letër Krediti mbaron gjatë ndërprerjes së punës së bankës Dhënëse apo Pagueuse siç përshkruhet në Nenin 17 të UCP 500, Përfituesi mund të bëjë ankesë për sa më poshtë për tridhjetë (30 ditë pas rifillimit të punës së bankës Dhënëse apo Pagueuse), si të jetë e zbatueshme.

Me respekt,

Banka Dhënëse
Porosi Bankë me bankë
Rimbursimi:

Me marrjen e dokumenteve në përputhje me afatet dhe kushtet e këtij letër Krediti ëAlt: ju jeni të autorizuar të debitonit vetë llogarinë tonë nr. _____] OSE ëAlt. 2: ju lutemi paraqisni kërkesën e rimbursimit për ëemri i bankës që rimbursos në ShBA], ëdegë] nën mbulimin e informacionit me teleks të shpejtë / të testuar për ne që konfirmon se të gjitha afatet dhe kushtet janë përmbushur për tërheqjen sipas Letër Kreditit. Banka rimbursuese autorizohet të paguajë jo më vonë se sa 3:00 pasdite në New York City në ditën e dytë të punës në vijim të ditës së negociimit të kërkesës së bankës ardhur me teleks të shpejtë / të testuar, për rimbursim. Pavarësisht nga pagesa e mëparshme, e dështuar siç dëshmohet nga banka rimbursuese, ne gjithashtu ndërmarrim pa kushte të rimbursojmë bankën negociuese brenda një ditë pune të marrjes nga ne të një shënimi me teleks të shpejtë / të testuar që pohon se banka rimbursuese nuk ka bërë pagesën siç jepet këtu] banka negociuese kërkohet të dërgojë të gjithë dokumentacionin njëherazi me ndërlidhës postar për në: _____

MODEL Letër Krediti 2

Banka Financuese: [Emri i Bankës Dhënëse]

[Adresa e Bankës Dhënëse]

Banka Paguese: [Banka Paguese]

[Adresa e Bankës Paguese], ShBA

Përfituesi/Shitësi: Lockheed Martin Global, Inc.

Sisteme & Sensorë Detar

Electronics Park

Syracuse, NY 13221

Aplikuesi: [Emri i Aplikuesi]

Adresa e Aplikuesi]

Data e Leshimit: _____

Skadimi: [fut datën Tre (3) muaj pas datës së pagesës së fundit të pritur] në sportelet e bankës
paguese në ShBA

Monedha & Sasia: US\$ [Çmimi i Kontratës]

Zotërinj:

Me urdhër të klientit tonë, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare (“Aplikuesi” ose “Blerësi”), ne
lëshojmë në favorin tuaj Letër Kreditin e Dokumentuar të pakthyesëm Nr. [Nr Kreditit] (“Letër
Krediti”) në shumën e US\$ ëshuma e vlerës së kontratës], një shumë e tillë mbulon pagesën për
Sistemin të Integruar Shqiptar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare sipas Kontratës Nr. ë] (“Kontrata”).

E disponueshme nga: BANKA Konfirmuese me: NEGOCIATA

Pagesë e Pjesshme: E LEJUAR

Fondet sipas Letër Kreditit do t’i paguhen Përfituesit përkundrejt dokumenteve faktikë të
mëposhtëm:

5.) Origjinali i Letër Kreditit; dhe

6.) Një i pagueshëm i tërhequr në Bankën Paguese; dhe

7.) Pesë kopje të firmosura me dorë të faturës tregtare të Përfituesit që identifikon numrin e
pagesës së mundshme dhe përshkrimin e veprimtarive të realizueshme, siç përshkruhet më poshtë në
Progresin e Planit të Pagesës; dhe

8.) Ose

a. Për pagesën e katërt: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me
firmën e Ndihmësit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur
kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa
kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e Lëvrimit të Gjeneratorit/Strehimit; ose

b. Për pagesën e pestë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me
firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës që dëshmon se shitësi ka përmbushur kriteret e pagesës
dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa kundërfirmën e
Blerësit, për përfundimin e Lëvrimit të Radarit Faza 1; ose

c. Për pagesën e gjashtë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV
me firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka
përmbushur kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të
paraqesë ÇPV pa kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e System SAT; ose

d. Për pagesën e shtatë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me
firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur
kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa
kundërfirmën e Blerësit, për Lëvrimin e Pajisjeve Mikrovalë; ose

e. Për pagesën e tetë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me
firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur
kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa
kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e Lëvrimit të Radarit Faza 2; ose

f. Për pagesën e nëntë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me
firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur
kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa

kundërfirmën e Blerësit, për Fazën e 1 SAT; ose

Tërheqjet mund të bëhen rastësisht pa rend të rregullt dhe ndonjë herë para skadimit të Letër Kreditit, për aq kohë sa tërheqja individuale nuk kalon vlerën e treguar më lart për çdo pagesë të punës së bërë.

Të gjitha çeqet dhe faturat e paraqitura me Letër Kreditin duhen shënuar me këtë Nr. të Letër Kreditit të Dokumentuar [Letër Kredit Nr.].

Dokumentet e paraqitura më shumë se sa 21 ditë pas dhënies të dokumenteve, por brenda vlefshmërisë të këtij Krediti të Dokumentuar: E PRANUESHME.

Nqs. afati nuk shtyhet nga ne, kjo Letër Krediti do të mbarojë në sportelet e bankës paguese në Shtetet e Bashkuara në ëfut ditën e mbarimit] ("Data e Mbarimit"). Ne në këtë mënyrë biem dakord që draftet e tërhequra sipas afateve dhe kushteve sa më poshtë do të respektohen si duhet në se paraqiten në apo para ditës së skadimit.

Të gjitha detyrimet e shkaktuara lidhur me lëshimin dhe mbajtjen e kësaj Letër Krediti në Shqipëri si edhe detyrimet e konfirmimit janë për llogari të Aplikuesit. Të gjitha detyrimet e shkaktuara në Shtetet e Bashkuara duke përfshirë detyrimet e konfirmimit janë për llogari të Përfituesit.

Kjo letër krediti i nënshtrohet Praktikave dhe Zakoneve të Njëjtësuarra për Kreditet e Dokumentuara (UCP) (Rishikimi i vitit 1993) Publikimi Nr. 500 të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, veç Neneve 17 dhe 41 dhe na detyron në përputhje me afatet e tij. Nqs. Letër Krediti mbaron gjatë ndërprerjes së punës së bankës Dhënëse apo Paguese siç përshkruhet në Nenin 17 të UCP 500, Përfituesi mund të bëjë ankesë për sa më poshtë për tridhjetë (30 ditë pas rifillimit të punës së bankës Dhënëse apo Paguese, si të jetë e zbatueshme.

Me respekt,

Banka Dhënëse
Porosi Bankë me bankë
Rimbursimi:

Me marrjen e dokumenteve në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj letër Krediti ëAlt: ju jeni të autorizuar të debitori vetë llogarinë tonë nr. _____] OSE ëAlt. 2: ju lutemi paraqisni kërkesën e rimbursimit për emri i bankës që rimbursos në ShBA], ëdegë] nën mbulimin e informacionit me teleks të shpejtë / të testuar për ne që konfirmon se të gjitha afatet dhe kushtet janë përmbushur për tërheqjen sipas Letër Kreditit. Banka rimbursuese autorizohet të paguajë jo më vonë se sa 3:00 pasdite në New York City në ditën e dytë të punës në vijim të ditës së negociimit të kërkesës së bankës ardhur me teleks të shpejtë / të testuar, për rimbursim. Pavarësisht nga pagesa e mëparshme, e dështuar siç dëshmohet nga banka rimbursuese, ne gjithashtu ndërmarrim pa kushte të riimbursojmë bankën negociuese brenda një ditë pune të marrjes nga ne të një shënimi me teleks të shpejtë / të testuar që pohon se banka rimbursuese nuk ka bërë pagesën siç jepet këtu] banka negociuese kërkohet të dërgojë të gjithë dokumentacionin njëherazi me ndërlidhës postar për në: _____

MODEL Letër Krediti 3

Banka Financuese: ëEmri i Bankës Dhënëse]
[Adresa e Bankës Dhënëse]
Banka Paguese: [Banka Paguese]
[Adresa e Bankës Paguese], ShBA

Përfituesi/Shitësi: Lockheed Martin Global, Inc.

Sisteme & Sensorë Detar

Electronics Park

Syracuse, NY 13221

Aplikuesi: ëEmri i Aplikuesi]

[Adresa e Aplikuesi]

Data e Lëshimit: _____

Skadimi: ëfut datën Tre (3) muaj mbas datës së pagesës së fundit të pritur] në sportelet e bankës paguese në ShBA

Monedha & Sasia: US\$ [Çmimi i Kontratës]

Zotërinj:

Me urdhër të klientit tonë, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare ("Aplikuesi" ose "Blerësi"), ne lëshojmë në favorin tuaj Letër Kreditin e Dokumentuar të pakthyesëm Nr. ëNr Kreditit] ("Letër Krediti") në shumën e US\$ ëshuma e vlerës së kontratës], kjo shumë mbulon pagesën për Sistemin e Integruar shqiptar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare sipas Kontratës Nr. ë] ("Kontrata").

E disponueshme nga: BANKA Konfirmuese me: NEGOCIATA

Pagesë e Pjesshme: E LEJUAR

Fondet sipas Letër Kreditit do t'i paguhen Përfituesit përkundrejt dokumenteve faktikë të mëposhtëm:

9.) Originali i Letër Kreditit; dhe

10.) Një çek i pagueshëm i tërhequr në Bankën Konfirmuese; dhe

11.) Pesë kopje të firmosura me dorë të faturës tregtare të Përfituesit që identifikon numrin e pagesës së mundshme dhe përshkrimin e veprimtarive të realizueshme, siç përshkruhet më poshtë në Ecurinë e Planit të Pagesës; dhe

12.) Ose

a. Për pagesën e dhjetë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me firmën e Ndihmësit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e Lëvrimit të Radarit Faza 3; ose

b. Për pagesën e njëmbëdhjetë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa kundërfirmën e Blerësit, për përfundimin e Fazes 2 SAT; ose

c. Për pagesën e dymbëdhjetë: ÇPV e nënshkruar përkatësisht nga blerësi dhe Përfituesi; ose ÇPV me firmën e Përfituesit dhe letër në kreun e letrës së Përfituesit që dëshmon se Përfituesi ka përmbushur kriteret e pagesës dhe, sipas afateve dhe kushteve të Kontratës, Përfituesi mund të paraqesë ÇPV pa kundërfirmën e Blerësit, për përmbushjen e System SAT; ose

Tërheqjet mund të bëhen rastësisht pa rend të rregullt dhe ndonjë herë para skadimit të Letër Kreditit, për aq kohë sa tërheqja individuale nuk kalon vlerën e treguar më lartë për çdo pagesë të punës së bërë.

Të gjitha çeqet dhe faturat e paraqitura me Letër Kreditin duhen shënuar me këtë Nr. të Letër Kreditit të Dokumentuar ëLetër Kredit Nr.].

Dokumentet e paraqitura më shumë se sa 21 ditë pas dhënies të dokumenteve, por brenda vlefshmërisë të këtij Krediti të Dokumentuar: E PRANUESHME.

Në qoftë se afati nuk kalohet nga ne, kjo Letër Krediti do të mbarojë në sportelet e bankës konfirmuese në Shtetet e Bashkuara në ëfut ditën e mbarimit] ("Data e Mbarimit"). Ne në këtë mënyrë biem dakord që çeqet e tërhequra sipas afateve dhe kushteve sa më poshtë do të respektohen aq sa duhet në se paraqiten në apo para ditës së mbarimit.

Të gjitha detyrimet e shkaktuara lidhur me lëshimin dhe mbajtjen e kësaj Letër Krediti në Shqipëri si edhe detyrimet për konfirmim janë për llogari të Aplikuesit. Të gjitha detyrimet e shkaktuara në Shtetet e Bashkuara duke përjashtuar detyrimet e konfirmimit janë për llogari të Përfituesit.

Kjo letër kredit i nënshtrohet Praktikave dhe Zakoneve të Njëjtësuar për Kreditet e Dokumentuara (UCP) (Rishikimi i vitit 1993) Publikimi Nr. 500 të Dhomës Ndërkombëtare të

Tregtisë, veç Neneve 17 dhe 41 dhe na detyron në përputhje me afatet e tij. Nqs. Letër Krediti mbaron gjatë ndërprerjes së punës së bankës Dhënëse apo Pagueuse siç përshkruhet në Nenin 17 të UCP 500, Përfituesi mund të bëjë ankesë për sa më poshtë për tridhjetë (30 ditë pas rifillimit të punës së bankës Dhënëse apo Pagueuse, si të jetë e zbatueshme.

Me respekt,

Banka Dhënëse
Porosi Bankë me bankë
Rimbursimi:

Me marrjen e dokumenteve në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj letër Krediti ëAlt: ju jeni të autorizuar të debitonit vetë llogarinë tonë nr. _____] OSE ëAlt. 2: ju lutemi paraqisni kërkesën e rimbursimit për ëemri i bankës që rimbursen në ShBA], ëdegë] nën mbulimin e informacionit me teleks të shpejtë / të testuar për ne që konfirmon se të gjitha afatet dhe kushtet janë përmbushur për tërheqjen sipas Letër Kreditit. Banka rimbursuese autorizohet të paguajë jo më vonë se sa 3:00 pasdite në New York City në ditën e dytë të punës në vijim të ditës së negocimit të kërkesës së bankës ardhur me teleks të shpejtë / të testuar, për rimbursim. Pavarësisht nga pagesa e mëparshme, e dështuar siç dëshmohet nga banka rimbursuese, ne gjithashtu ndërmarrim pa kushte të rimbursojmë bankën negociuese brenda një ditë pune të marrjes nga ne të një shënimi me teleks të shpejtë / të testuar që pohon se banka rimbursuese nuk ka bërë pagesën siç jepet këtu] banka negociuese kërkohet të dërgojë të gjithë dokumentacionin njëherazi me ndërlihdës postar për në: _____

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #2, Rishikimi i Projektit të Sistemit

Kriteret e përbushjes: Kryhet Rishikimi i Projektit të Sistemit

Data e përbushjes së veprimtarisë kryesore:_____

Çertifikata e Blerësit

E çertifikuar nga_____

Titulli:_____

Data:_____

Ministria e Mbrojtjes

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga_____

Titulli_____

Data:_____

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #3, Shpërndarja e Pajisjeve të Kullës

Kriteret e përbushjes: Shpërndarja është bërë në përputhje me Nenin 15 të Kontratës me portin e përcaktuar në Shqipëri.

Data e përbushjes së veprimtarisë kryesore: _____

Çertifikata e Blerësit

E certifikuar nga _____

Titulli: _____

Data: _____

Ministria e Mbrojtjes

Çertifikata e Furnizuesit

E certifikuar nga _____

Titulli _____

Data: _____

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #4, Shpërndarja e Gjeneratorëve / Strehave

Kriteret e përbushjes: Shpërndarja është bërë në përputhje me Nenin 15 të Kontratës, nëse zbatohet, kur Gjeneratorët dhe Strehat janë shpërndarë në ose brenda Shqipërisë.

Data e përbushjes së veprimtarisë kryesore:_____

Çertifikata e Blerësit

Çertifikata e Furnizuesit

E certifikuar nga_____

E certifikuar nga_____

Titulli:_____

Titulli_____

Data:_____

Data:_____

Ministria e Mbrojtjes

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #5, Dërgimi i Radarit Faza 1

Kriteret e përmbushjes: Dërgimi në kohën e duhur është bërë në përputhje me Nenin 15 kur Radarët mbërrijnë në portin e përcaktuar në Shqipëri.

Data e përmbushjes së veprimtarisë kryesore: _____

Çertifikata e Blerësit

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga _____

E çertifikuar nga _____

Titulli: _____

Titulli _____

Data: _____

Data: _____

Ministria e Mbrojtjes

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përmbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përmbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #6, Sistemi FAT

Kriteret e përmbushjes: Përmbushja e Testit të Pranimit të Sistemit të Fabrikës (FAT).

Data e përmbushjes së veprimtarisë kryesore:_____

Çertifikata e Blerësit

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga_____

E çertifikuar nga_____

Titulli:_____

Titulli_____

Data:_____

Data:_____

Ministria e Mbrojtjes

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përmbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përmbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #7, Shpërndarja e Pajisjeve Mikrovalë

Kriteret e përmbushjes: Shpërndarja është bërë në përputhje me Nenin 15 kur Pajisjet Mikrovalë mbërrin në portin e përcaktuar në Shqipëri.

Data e përmbushjes së veprimtarisë kryesore: _____

Çertifikata e Blerësit

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga _____

E çertifikuar nga _____

Titulli: _____

Titulli _____

Data: _____

Data: _____

Ministria e Mbrojtjes

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përmbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përmbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #8, Dërgimi i Radarit, Faza 2

Kriteret e përmbushjes: Dërgimi është bërë në përputhje me Nenin 15 kur Radarët e Fazës 2 mbërrin në portin e përcaktuar në Shqipëri.

Data e përmbushjes së veprimtarisë kryesore:_____

Çertifikata e Blerësit

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga_____

E çertifikuar nga_____

Titulli:_____

Titulli_____

Data:_____

Data:_____

Ministria e Mbrojtjes

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përmbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përmbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #9, Faza 1 SAT

Kriteret e përmbushjes: Përmbushja e Fazës 1 Testi i Pranimi të Sistemit (SAT)

Data e përmbushjes së veprimtarisë kryesore:_____

Çertifikata e Blerësit

E çertifikuar nga _____

Titulli: _____

Data: _____

Ministria e Mbrojtjes

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga _____

Titulli _____

Data: _____

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përmbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #10, Dërgimi i Radarit, Faza 3

Kriteret e përbushjes: Shpërndarja është bërë në përputhje me Nenin 15 kur Radarët e Fazës 3 mbërrijnë në portin e përcaktuar në Shqipëri.

Data e përbushjes së veprimtarisë kryesore: _____

Çertifikata e Blerësit

E çertifikuar nga _____

Titulli: _____

Data: _____

Ministria e Mbrojtjes

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga _____

Titulli _____

Data: _____

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #11, Faza 2 SAT

Kriteret e përbushjes: Përbushja e Fazës 2 Testi i Pranimi të Sistemit (SAT)

Data e përbushjes së veprimtarisë kryesore: _____

Çertifikata e Blerësit

E çertifikuar nga _____

Titulli: _____

Data: _____

Ministria e Mbrojtjes

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga _____

Titulli _____

Data: _____

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRE DETARE SHQIPTARE

Çertifikatë e Përbushjes së Veprimtarive Kryesore

Veprimtaria kryesore #12, Faza 3 SAT

Kriteret e përmbushjes: Përmbushja e Fazës 3 Testi i Pranimi të Sistemit (SAT)

Data e përmbushjes së veprimtarisë kryesore:_____

Çertifikata e Blerësit

Çertifikata e Furnizuesit

E çertifikuar nga_____

E çertifikuar nga_____

Titulli:_____

Titulli_____

Data:_____

Data:_____

Ministria e Mbrojtjes

Lockheed Martin Global Inc.

Me nënshkrimin e kësaj çertifikate, Ministria e Mbrojtjes Shqiptare deklaron përmbushjen e veprimtarisë kryesore të përcaktuar më sipër dhe Lockheed Martin Global Inc. ka të drejtë të kryejë pagesën sipas Letër Kreditit të çelur nga Ministria e Mbrojtjes për këtë qëllim.

SHTOJCË 10, KUSHTET PËR VIZITORET

1 Udhëtimi për personelin e Blerësit.

1.1 Furnizuesi do të paguajë për shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës për personelin e përcaktuar nga Blerësi për në ndërtesën e Furnizuesit në Syracuse, N.Y. siç kërkohet sipas Kontratës duke u rimbursuar nga Blerësi për shpenzimet e mëposhtme:

1.1.1 Udhëtim ajror vajtje ardhje (në çmimin më të ulët të mundshëm pa ulje) nga vendndodhja e Blerësit për në Syracuse, N.Y.

1.1.2 Strehim/akomodim në dhomë për një person brenda një rreze prej njëzet miljesh nga ndërtesa e Furnizuesit në Syracuse, N.Y. duke përfshirë shpenzimet për ushqim dhe të rastit, të gjitha të kombinuara në një shumë ditore që të mos tejkalojë shkallën e dietave të përdorura për Syracuse, N.Y. siç dokumentohet nga Qeveria e ShBA (shih www.gsa.gov për dietat në momentin e tanishëm).

1.1.3 Një automjet standard të madhësisë së mesme me katër dyer për grupin e vizitorëve të Blerësit për transport vendor.

1.1.3.1 Drejtuesit e përcaktuar të automjeteve duhet të kenë një leje të vlefshme ndërkombëtare për drejtim automjeti.

1.1.3.2 Mbulimi opsional me sigurim do të pranohet në mjetet e marra me qera.

1.1.3.3 Furnizuesi ruan të drejtën që të anultojë lejen për të drejtuar automjetin ndaj drejtuesit të tij në rast të akuzave për shkelje të normave të SHBA-së, qofshin ato federale, shtetërore apo vendore që rregullojnë veprimin e mjeteve të motorizuara apo akuzave për drejtim të pasigurtë të automjetit.

1.1.3.4 Furnizuesi do të ketë të drejtën që të rimbursohet nga Blerësi për çfarëdo dëmtimi ndaj banesës apo automjetit që vjen nga veprimet e cilitdo prej vizitorëve në masën që nuk mbulohet nga sigurimi.

1.1.3.5 Vizitorët do të kenë përgjegjësi për çfarëdo gjobash apo dënimesh që rrjedhin nga veprimtaria e tyre ndërsa janë në Shtetet e Bashkuara. Nëse një vizitor nuk arrin të paguajë një gjobë apo të kryejë një dënim dhe si rrjedhim i kërkohet Furnizuesit që të paguajë, Furnizuesi do të ketë të drejtë për rimbursim sipas kësaj Kontrate.

1.1.4 Telefonatat vendore të mos tejkalojnë \$30 për person gjatë qëndrimit.

1.1.5 Faturat e marra për shpenzimet e tanishme për të gjithë zërat mbi vlerën \$25.

1.2 Furnizuesi nuk do të paguajë asnjë shpenzim tjetër të kryer nga vizitorët gjatë qëndrimit të tyre.

1.3 Furnizuesi do të çlirohet nga përmbushja e cilësdo pjesë të këtij Neni në masën që ai shkel ligjet dhe rregulloret e SHBA-së apo ato shqiptare.

Lidhja 1, QELLIMI I Furnizimit të Furnizuesit
(shih Qëllimin e Furnizimit bashkëlidhur)

Lidhja 2, propozimi teknik i Furnizuesit
(shih Propozimin Teknik bashkëlidhur)

Bashkëlidhja 1 tek Afatet dhe Kushtet

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD)
të

Republikës së Shqipërisë

Qëllimi i Furnizimit

Përmbledhje e Qëllimit të Furnizimit

Ky dokument saktëson qëllimin e punës së Lockheed Martin në mbështetje të projektit të sistemit, përpjekjeve për integrimin, testimin dhe instalimin për konfigurimin bazë të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare Shqiptare (SIVHD). Puna e përshkruar në këtë Fushë të Furnizimit (SOS) do të kryhet sipas planit të programit të përshkruar në Figurën 1 dhe propozimit teknik të datës 15 Maj 2006.

Ministria e Mbrojtjes Shqiptare (“Blerësi”) do të kryejë çdo punë përgatitore për qendrën (pikën) dhe mjedisin që nevojitet për të përgatitur për instalim dhe testim SIVHD Shqiptare siç përshkruhet në Afatet dhe Kushtet, Shtojca 4.

Lockheed Martin, Maritime Systems and Sensors in Syracuse, NY, (LM, “Furnizuesi”) do të kryejë detyrat siç përmbledhen më poshtë në kontratë.

- Furnizimin e pajisjeve, pjesëve të këmbimit dhe softuer për SIVHD Shqiptar.
- Kryen testimin e pranimin në fabrikë sipas planeve të testit të LM FAT.
- Instalon dhe verifikon funksionimin e SIVHD Shqiptar
- Kryen testimin e pranimin të sistemit sipas planeve të testimit të LM SAT
- Siguron dokumentacionin për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit
- Siguron mbështetje për trajnim dhe implementim
- Siguron mbështetje garancie.

Mundësia e Lockheed Martin për të mbështetur opsionin fakultativ të Pasqyrimin të Kontrollit të Trafikut Ajror përshkruhet në Propozimin Teknik të SIVHD Shqiptar - Shtojca II e datës 15 Maj 2006.

AUTORIZIMI I PUNËS

Blerësi do të nxjerrë një urdhër blerjeje apo kontratë, ku të saktësojë punën që kërkohet nga Lockheed Martin në lidhje me këtë SOS.




Figura 1. SIVHD Shqiptar – Pasqyra/Afatet e Programit

ADMINISTRIMI I PROGRAMIT 2

2.1 Organizimi i administrimit

Furnizuesi do të përgatisë një sistem për administrimin e programit që i përgjigjet përmbushjes së detyrave dhe veprimtarive të kërkuara, siç përcaktohen në këtë SOS. Administratori i Programit do të caktohet për të shërbyer si individ që do të ketë përgjegjësi të plotë për kontrollin dhe bashkërendimin e të gjithë punës që kryhet gjatë këtij programi. Menaxheri i Programit të Furnizuesit do të sigurojë që të gjithë artikujt e konfigurimit, të dhënat dhe shërbimet që jepen do të përmbushin kërkesat e kontraktuesit. Midis elementëve funksionalë të Furnizuesit dhe Administratorit të Programit do të ekzistojë një linjë e qartë autoriteti.




Figura 2. Organizimi i Projektit të SIVHD Shqiptar

Përgjegjësitë e strukturës së projektit paraqiten në Tabelën 1. Kjo tabelë shpjegon përgjegjësitë e projektit, duke siguruar të mbulohen të gjithë aspektet që përfshin projekti SIVHD shqiptar, me vija të qarta ndarëse të shërbimeve brenda ekipit.

Tabela 1. Përgjegjësitë e Projektit SIVHD Shqiptar (Lockheed Martin)

Titulli / Roli	Përgjegjësitë e Projektit
Administratori i Projektit Drejtton dhe kryeson të gjithë aspektet e Vëzhgimit Bregdetar dhe ato pjesë të Vëzhgimit Kufitar të programit.	Ndërveprues kryesorë midis LM / MM Mbikqyr bisedimet kontraktuale si dhe rishqyrtime teknike dhe të programit Përpilon buxhetin dhe cakton burimet për të gjithë elementët e programit Ndërton strukturën organizative, politikat dhe procedurat e funksionimit. Miraton të gjitha skemat e projektit, dokumentacionin dhe ndryshimet (nuk përfshihet dokumentacioni që ka të bëjë me ndërtimin) Shperndan pjesëmarrësve informacionin që ka të bëjë me programin. Siguron cilësi në të gjitha aspektet e programit Përmbush angazhimet që kanë të bëjnë me planin dhe buxhetin. Ploteson kërkesat teknike. Kompetenca Përfaqëson Drejtorin e kompanisë në të gjitha çështjet e programit SIVHD. Cakton personelin që punon apo mbështet programin. Miraton të gjitha programet, buxhetet dhe planet. Miraton shfuqizimin apo ndryshimin e të gjitha specifikimeve që nuk kanë të bëjnë me ndërtimin, të dhëna teknike apo dokumentat Nënshkruan kontratën/EPC dhe miraton shpenzimet e programit.
Administratori Inxhinier i Projektit (EPM) Drejtton dhe bashkërendon të gjitha veprimtaritë projektuese për projektin në Syracuse.	Përgjigjet për të gjithë projektin e sistemit dhe të çdo nënsistemi. Përpunon të dhënat e projektit të sistemit dhe dokumentat për sistemin. Vlereson kërkesat teknike të Projektit – ku përfshihen detyrat e planifikimit, ndarja e burimeve, raportimi i punës së bërë përkundrejt planeve dhe caktimit të fondeve si dhe ndërveprimi me funksionet e tjera të projektit. Përgatit të gjithë projektet e kërkuara të sistemit dhe dokumentacionin e testimit. Përpunon planet e testimit të Projektit dhe procedurat për Testin e zbatueshëm të Pranimit në Fabrikë dhe veprimtaritë e Testimit të Pranimit në Qendër (Pikë). Siguron që detyrat inxhinierike të plotësohen sipas planit, brenda buxhetit dhe sipas cilësisë dhe kërkesave të projektit. Miraton të gjitha programet inxhinierike, buxhetet dhe planet brenda kufijve të planit të përgjithshëm inxhinierik. Rishqyrton rezultatet konkrete FAT të palës shitëse për specifikim dhe verifikim. Miraton shfuqizimin ose ndryshimin e pajisjeve dhe specifikimeve të sistemit, të dhënave teknike apo dokumentave. Bën vlerësimin e rrezikut, lidhur me koston dhe detyrimet kohore. Siguron personel për realizimin e një INCO të efektshme dhe testim të suksesshëm të sistemit në Shqipëri. Siguron Drejtorin e Testimit SAT për të zbatuar të gjitha testimet SAT në Shqipëri. Përgatit dhe paraqet raportet e testeve për çdo test. Nënshkruan rezultatet e procedurave të testit.

Mbështetje programi – Prokurimi Vendos marrëdhëniet e nevojshme të nënkontraktorit me furnizuesit.	Pikë kontakti për të gjithë shërbimet e nënkontraktuara dhe materialet. Rishqyrton dhe miraton dokumentacionin, programet, skicat, specifikimet, procedurat e testeve dhe raportet lidhur me nënkontraktorin. Monitoron rregullisht ecurinë e nënkontraktorit dhe ia raporton gjëndjen dhe problemet Administratorit të Projektit.
Mbështetje Programi – Administratori i Kontratës Pika kryesore për të dhënat e kontratës dhe diskutimeve kontraktuale në vijimësi midis LM dhe klientit.	Bashkërendon ekipin e programit në finalizimin e afateve dhe kushteve. Sigurohet që të gjitha aspektet e veprimit të kontratës rishqyrtohen nga elementi i përshtatshëm funksional. Këshillon Administratorin e Projektit për implikimet në dispozitat e përgjithshme dhe specifike të kontratës. Kompetenca Me delegim, nënshkruan të gjithë korrespondencën. Me delegim, negocion dhe përfundon ndryshimet e urdhrave.
Mbështetja e Programit – Financimi Kujdeset për analizën financiare të projektit.	Drejton rishqyrtime financiare të projektit, mbështet rishqyrtime financiare të programit periodik me Administratorin e Projektit dhe bashkërendon menaxhimin. Garanton që të përdoren teknika të sakta e të përshtatshme përlllogaritje gjatë programit. I diskuton bashkarisht pikat kyçe të kontratës. Vërteton shpenzimet e programit.
Mbështetja e Programit – Master Plani Ofron mbështetjen e planëzimit dhe zbrërthimin e projektit.	Drejton vlerësimin e rrezikut lidhur me koston dhe kufizimet e programit. Përgatit programe të hollësishme/master programe për projektin. Ndihmon Administratorin e Projektit në vlerësimin e gjëndjes dhe ecurisë së projektit.
Mbështetje Programi – Administrimi i Konfigurimit (CM) Kontrollon ndryshimin e projektin	Menaxhon konfigurimet e softuere, harduere, skicave dhe dokumentave. Shpërmdan gjëndjen e konfigurimit gjatë gjithë organizimit të projektit.
Mbështetje Programi – Sigurimi i Cilësisë (QA) Kryen kontrollin/auditin e sigurisë së cilësisë për Projektin.	Siguron kalimin e kërkesave të cilësisë te nënkontraktorët dhe furnizuesit/shitësit. Auditon/Kontrollon sistemet e cilësisë sipas çertifikimeve ISO 9000 Integron sistemin e cilësisë në funksionet e tjera të programit. Rishikon të gjitha aspektet e programit për përshtatjen e cilësisë.
Mbështetje Logjistike – Trainimi Drejton dhe bashkërendon të gjitha veprimtaritë e trajnimit	Sigurohet në se plotësohet i gjithë dokumentacioni i përgatitjes dhe mbështetjes sipas planit, brenda kufizimeve të buxhetit dhe në përputhje me kërkesat. Përgatit dhe bashkërendon përgatitje për të gjithë operatorët, kontrollorët dhe mirëmbajtësit e pajisjeve dhe produkteve softuer. Miraton shfuqizimin dhe ndryshimin e dokumentave të përgatitjes. Mbështet kalimin e sistemit të përdoruesi.
Mbështetje Logjistike – Garancia Mbështet veprimtaritë e garancisë.	Rishqyrton të gjithë dokumentacionin në mbështetje të produktit përfundimtar. Mbështet kalimin e sistemit tek përdoruesi fundor. Siguron mbështetjen e garancisë pas pranimit të sistemit, përfshirë edhe pjesët rezervë. Miraton të gjithë buxhetin dhe planet e garancisë brenda kufizimeve të gjithë programit.

2.2 Ecuria / rishqyrtimet e programit

Furnizuesi do të përgatisë dhe dorëzojë raportet mbi ecurinë, siç kërkohet, për Blerësin gjatë plotësimit të testimit të pranimit të qendrës (pikës) mbi bazë mujore.

Çdo raport mbi ecurinë do të:

- a. Përcaktojë ecurinë e Furnizuesit në plotësimin e çdo veprimtarie kyçe.
- b. Përcaktojë ndonjë çështje që ka të bëjë me plotësimin e veprimtarive kyçe që mund të ndikojnë në testim, instalim apo shpërndarjen e të dhënave.

c. Propozojë veprimet e rekomanduara për çdo çështje, për të minimizuar ndikimin në program.

Furnizuesi do të zhvillojë Rishqyrtimet Tremujore të Programit (QPR) me Blerësin, në mjedisin e këtij të fundit çdo 3 muaj. Qëllimi i këtyre rishqyrtimeve bëhet për të dhënë gjendjen e detajuar të detyrave dhe veprimtarive kryesore që kanë të bëjnë me Furnizuesin, në mbledhjet e ballafaqimit me Blerësin. Furnizuesi do ta pajisë Blerësin me dokumentacionin e mëposhtëm, në mbështetje të (QPR):

- a) Axhendën e Rishqyrtimit të Programit (1 në çdo tre muaj)
- b) Paketën e Prezantimit të Rishqyrtimit të Programit (1 në çdo tre muaj)

2.3 Udhëtimi

Furnizuesi do të përgjigjet për të gjitha udhëtimet dhe koston perkatese të udhëtimit për personelin e tij të kërkuar gjatë kontratës.

2.4 Rishqyrtimi i skicave të pikave dhe mjedisit

Blerësi do të përgatisë skicat e projektimit civil (si, A&E, planet urbanistike, planet, etj) të pikës dhe mjedisit SVHBD. Furnizuesi do të japë input për këto skica, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kërkesat për instalimin e pajisjeve SIVHD të Furnizuesit. Para miratimit përfundimtar, Furnizuesi do të rishqyrtojë skicat dhe aprovoje ato aspekte të skicave që lidhen me funksionimin dhe instalimin e pajisjeve të furnizuesit.

2.5 Rishqyrtimi i projektit të sistemit

Takimin e Rishqyrtimit të Projektit të Sistemit (SDR) do ta drejtojë Furnizuesi sipas Planit të Programit në Mjedisin e tij. Takimi SDR do të konsistojë në rishqyrtimin që do t'i bëhet projektit SIVHD shqiptar. SDR jep një vështrim të përgjithshëm të nënsistemeve dhe diskutim të hollësishëm të zonave të zgjedhura me përfaqësuesin(t) e Blerësit që ftohen për ta ndjekur. Përfundimi i takimit SDR dhe dorëzimi i dokumentacionit lidhur me SDR që listohet në paragrafin 2.6.1 përbën përfundimin me sukses të SDR.

2.6 Produktet e projektit

Në mbështetje të kontratës, Furnizuesi do t'i sigurojë Blerësit artikujt e mëposhtëm.

2.6.1 Dokumentacioni

Dorëzimi i të dhënave sipas kësaj kontrate do të listohen sa më poshtë:

Sistemi SFDD shqiptar (në SDR)

Sistemi RTM Shqiptar (në SDR)

Dokumenti i Projektit të sistemit Shqiptar (në SDR)

Plani i Programit të Cilësisë MS3

Plani dhe Procedurat FAT të Sistemit Shqiptar (30 ditë para testit)

Raporti i Testit FAT të Sistemit Shqiptar (10 ditë pas testit)

Plani dhe Procedurat SAT të Sistemit Shqiptar (30 ditë para testit)

Raporti i Testit SAT të Sistemit Shqiptar (10 ditë pas testit)

Skemat e Instalimit të Sistemit Shqiptar (sipas skemave të bëra 45 ditë pas SAT)

Plani i Trajnimit për Sistemin (21 ditë para fillimit të përgatitjes)

Manualet e shitësit të sistemit (30 ditë para trajnimit)

Manuali i Funksionimit të Sistemit MTM200 (30 ditë para përgatitjes)

Manuali i Mirëmbajtjes të Sistemit MTM200 (30 ditë para trajnimit)

n) Shtojcat e manualit të mirëmbajtjes të sistemit MTM200 (30 ditë para përgatitjes)

Indeksi i Dokumentacionit të shitësit të sistemit

Sistemi i alarmit, Pika e kontrollit dhe të dhënat e gjendjes

Lista e Rekomanduar e Mjeteve të Konsumit të Prodhuesit

Lista e Pajisjeve të sistemit
Mjetet speciale dhe lista e pajisjeve të testit
List- detyra Preventive e mirëmbajtjes
Plani i rekomanduar preventive i mirëmbajtjes
Bllok skemat e diagrameve.
Të gjitha dokumentat do të jenë vetëm në gjuhën angleze.

2.6.2 Pajisjet

Furnizuesi do të sigurojë pajisjet e listuara në Shtojcën A si pjesë të sistemit (duke ruajtur të drejtën të zëvendësojë pjesët sipas Afateve dhe Kushteve të Kontratës). Pjesët rezervë të listuara sigurojnë që sasia e pjesëve rezervë në përdorim janë në dispozicion gjatë gjithë periudhës së garancisë. Pjesët rezervë që konsumohen gjatë periudhës së garancisë do të plotësohen nga Furnizuesi, si artikull për zëvendësim ose riparim.

Ashtu siç janë listuar në Shtojcën A, softuere të MTM200 do të dorëzohen si pjesë të sistemit të SIVHD të Shqipërisë. Një licencë softuee do të sigurohet nga Furnizuesi duke dhënë në hollësi të drejtat e veçanta të garantuara të Blerësit në përputhje me të drejtën e njohurisë të softuere të MTM200. Kjo licencë me kufizime të veçanta do të sigurohet për përdorimin e stacioneve të njëmbëdhjetë (11) MTM200 të dorëzohen në këtë kontratë si dhe për mundësinë e shtimit të stacioneve shtesë pa tarifë shtesë licence MTM200.

2.7 Administrimi i të dhënave

Të dhënat do të përgatiten dhe paraqiten në formatin e Furnizuesit. Dokumentacioni i sistemit do të konsistojë nga dokumentet e nxjerra më parë, me modifikimet që nevojiten për të reflektuar konfigurimin e instaluar. Kur është e mundur, dokumentet do të paraqiten si kopje elektronike sipas kërkesës së Furnizuesit. Në çdo rast paraqitja e dokumentacionit si ai elektronik dhe i printuar, cilido qofte i pari, do të jete data e paraqitjes formale të dokumentit.

2.8 Administrimi i konfigurimit

Furnizuesi do të shfrytëzojë programet harduer dhe softuer të menaxhimit të konfigurimit në mbështetje të identifikimit të konfiguracionit dhe konfigurimit bazë të SIVHD shqiptar gjatë pranimit të qendrës (pikës). Kjo do të përfshijë veprimtaritë e mëposhtme:

- a. Identifikimin dhe dokumentimin e karakteristikave funksionale dhe fizike të artikullit.
- b. Kontrollin e ndryshimeve të këtyre karakteristikave.
- c. Kontrollin e konfigurimit.

Furnizuesi do të sigurojë që karakteristikat funksionale dhe fizike të gjithë artikujve që përbëjnë SIVHD Shqipëri janë rishqyrtuar dhe se ndryshimet e nevojshme janë miratuar, raportuar, regjistruar dhe zbatuar, siç duhet, në përputhje me procedurat e brendshme të Furnizuesit dhe dispozitave të kësaj kontrate.

PËRSHKRIMI I SISTEMIT

3

SIVHD shqiptare konsiston në sensorët, pajisjet e komandim drejtimit, Rrjetin me Shtrirje të gjerë (WAN)-in bazuar në mikrovalë, plus pajisjet e strehimeve të kullave dhe gjeneratorët elektrike. Nën sistemet individuale dhe komponentët brenda SIVHD shqiptar përshkruhen në Propozimin Teknik të SIVHD Shqiptar të LM, të datës 7 nëntor 2005. Pajisjet që kanë të bëjnë me këto sisteme listohen në Shtojcën A të këtij SOS.

3.1 Projekti i sistemit

Projekti i sistemit përfshin përcaktimin e kërkesave dhe analizën e SIVHD shqiptar. Fillimisht, nëse nuk është e mundur para kontratës, kërkesat funksionale të sistemit dokumentohen në Dokumentin e Përshkrimit Funksional të Sistemit (SFDD). Në përgatitjen për prokurimin e pajisjeve, Rishqyrtimi i Projektit të Sistemit bëhet, për të shpërndarë të gjithë projektin e sistemit.

Faza e kërkesës së analizës së programit përcakton trajtimin e testimit të çdo kërkesë të caktuar të SFDD. Rezultati i kësaj analize do të jetë Matrica e Ndjekjes së Kërkesave (RTM). RTM jep referimin e pajisjeve SFDD për testin përkatës që përdoret për verifikimin e kërkesës.

3.2 Prokurimi dhe integrimi i pajisjeve

Furnizuesi do të prokurorë pajisjet dhe softuere të listuara në Shtojcën A dhe integrojë ato në mjediset e Syracuse, NY USA. Duhet patur parasysh së një përfaqësues radar i veçantë do të integrohet në Syracuse. Radarët e tanishëm CSS do të integrohen në pikën në Shqipëri. Furnizuesi do të zhvillojë dhe zbatojë procedurat e integritit të sistemit për nën sistemet kryesore (radar, AIS, foni/zë dhe kontroll), për të verifikuar funksionimin e tyre bashkërisht, para se sistemi t'i nënshtrohet Testimit të Pranimi në Fabrikë (FAT).

3.3 Testimi dhe pranimi

Programi i testimit përfshin dy metodologji të veçanta testimi formal të sistemit që zbatohen gjatë programit në kohë të ndryshme. Testimi i Pranimi në Fabrikë (FAT) do të bëhet në mjedisin e prodhuesit të komponentit kryesor (Furnizuesi FAT) dhe në Syracuse, mjedisin e New York (Sistemi FAT).

Metoda e dytë e testimit që përdoret është Testimi i Pranimi në Vend (SAT). Sapo të instalohet pajisja në pikat dhe me përfundimin e Instalimit dhe Kontrollit (INCO), testimi SAT do të kryhet me qëllim verifikimin e mundësive funksionale të sistemit, të cilat nuk janë verifikuar gjatë FAT. Për programin SIVHD shqiptar, SAT-i shumëfishuar do të kryhet një për çdo fazë instalimi. Fazat e instalimit përshkruhen në Propozimin Teknik SIVHD shqiptar.

3.3.1 Metodologjia e pranimi të testimit

Furnizuesi do të kryejë Testet e Pranimi në Fabrikë (FAT) dhe testet e Pranimi në Qendër (SAT) siç përshkruhen sa më poshtë për të verifikuar gatishmërinë e SVHD.

3.3.1.1 Metodologjia e matricës në ndjekjen e kërkesave

Furnizuesi do të bëjë Matricën e Ndjekjes të Kërkesave (RTM), që specifikon mundësitë funksionale të SVHD dhe përcakton se si do të testohet secila. RTM do të përcaktojë çdo test sipas llojit (FAT ose SAT) si dhe metodën (test, inspektim, analizë apo të dhëna të shitësit). RTM do të bëhet gjatë fazës së analizës të kërkesave, siç përshkruhet në paragrafin 3.3.2 dhe i dorëzohet Blerësit në SDR.

3.3.1.2 Metodologjia e pranimi të testimit në fabrikë

Testimi FAT do të kryhet në nivel sistemi në mjediset e Furnizuesit. Çdo testim FAT që do të kryhet në nivelin e përbërësit nga shitësit e Furnizuesit mbetet në diskrecionin e tyre. Dokumenti i Procedurës/ Planit FAT, do të përgatitet nga Furnizuesi, ku do të përshkruhet çdo sistem apo përbërës i testit FAT dhe kriteret e kalimit apo dështimit. Procedura/ Plani FAT i sistemit do t'i dorëzohet Blerësit së paku një muaj para zbatimit të Testeve FAT.

3.3.1.3 Metodologjia e pranimi të testimit në qendrën radar

Pas dorëzimit të pajisjeve të Qendrës të fundit, Instalimi dhe Kontrolli (INCO) do të bëhet në çdo pikë. Testimi SAT do të përfshijë testet që kryhen si pjesë e INCO si dhe ato që zhvillohen si pjesë e SAT formal. Furnizuesi do të përgatisë dokumentin e Procedurës/Planit SAT ku përshkruhet çdo test SAT i sistemit si dhe kriteret e kalimit apo dështimit për secilin. Procedura/Plani SAT i sistemit do t'i dorëzohet Blerësit së paku një muaj para zbatimit të Testeve SAT.

3.3.2 Analiza e kërkesave

Gjatë fazës së analizës të kërkesave, kërkesat e sistemit dokumentohen në Dokumentin e

Përshkrimi funksional të Sistemit (SFDD). Kërkesat SFDD do të rrjedhin nga dokumenti i Propozimit Teknik. Gjithashtu, faza e analizës të kërkesës të programit përcakton mënyrën e testit për çdo kërkesë SFDD. Rezultati i kësaj analize do të jetë Matrica e Ndjekjes të kërkesave (RTM). RTM jep një referencë të përgjithshme të kërkesave SFDD për testimin përkatës që përdoret për të verifikuar kërkesën.

RTM konsiston në:

1. Numri i kërkesës – numër unik i caktuar për secilën specifikim kërkesë.

2. Paragrafi specifikimi – paragraf burimi për specifikimin e kërkesës;

3. Përshkrim i kërkesës – teksti aktual i kërkesës;

4. Lloji i Testit – lloji i testit që do të kryhet për të verifikuar kërkesën. Alternativat e llojit të testit janë si më poshtë:

- Furnizuesi FAT – kërkesa do të verifikohet në mjedisin e prodhuesit të komponentit para nisjes për në destinacion apo qendrën radar;

- Sistemi FAT – kërkesa e verifikuar si pjesë e sistemit të integruar FAT bëhet në Syracuse, NY;

- INCO – kërkesa do të verifikohet si pjesë e fazës së instalimit të programit;

- SAT – kërkesa do të demonstrohet gjatë SAT.

1. Metoda e Testit – metoda e testit përcakton si do të demonstrohet përmbushja e specifikimit të kërkesës. Kategoritë e verifikimit janë si më poshtë:

- Test – kryerja e rasteve të testit në pajisjet e sistemit dhe analiza e rezultateve të testit përkundrejt kërkesave;

- Inspektim – përfshin inspektimin pamor;

- Analizë – përfshin verifikimin me anë të ekzaminimit teknik. Ky verifikim mund të jetë në formën e testeve simuluese dhe analizave të të dhënave, origjinave dhe metodave matematike, mjetet e analizës të funksionimit të radarit, siç është metodologjia CARPET dhe metodologjitë e analizës së përhapjes RF;

- Të dhënat e Shitësit – përfshijnë verifikimin, duke rishikuar specifikimet e furnizuesit dhe /ose rezultatet e testeve.

3.3.3 Testi i pranimit në fabrikë (FAT)

Faza e testimit të pranimit në fabrike të SIVHD Shqipëri përbëhet nga FAT i Shitësit dhe FAT i Sistemit.

Për FAT të Furnizuesit, radarët detar do t'u aplikohet testi FAT në mjedisin e shitësit të radarit detar. FAT i radarëve detar do të kryhet me qëllim sigurimin e përmbushjes të specifikimeve teknike të këtij përbërësi bazë në fazat më të hershme të programit. Këto teste bëhen në mjedisin e prodhuesit të përbërësit. Rezultatet e këtyre testeve dokumentohen në raportin e testit që bëhet pjesë e raportit përfundimtar FAT të LM.

Testimi FAT i sistemit që ka të bëjë me sistemin dhe softuere do të bëhet në mjedisin e LM në Syracuse, New York, sipas Planit të Testimit FAT të SIVHD shqiptar. Plani i Testimit FAT të SIVHD shqiptar bazohet në Planin e Testimit MTM200 dhe organizohet mbi bazën e nënsistem-nënsistem, duke siguruar kështu një mënyrë efektive të verifikimit hap pas hapi të të gjithë sistemit. Në këtë plan përfshihen edhe testimet që kanë të bëjnë me kontrollin në distancë të pajisjeve sensorë, funksionimin dhe rendimentin e tyre, funksionimin e bazës së të dhënave dhe hyrje/daljen e të dhënave, ndjekja e sistemit dhe funksionimi i sistemit të alarmit, diagnostikimi dhe veçoritë e mirëmbajtjes të sistemit (përfshirë sistemet alarm) si dhe dështimin e pajisjeve të tepërta.

Gjatë FAT të Sistemit, përbërësit e sistemit përfundimtar të dorëzuar do të mblidhen në mjedisin e laboratorit të LM në Syracuse. Ky sistem do të përfshijë një komplet tipik të pajisjeve, që do të mundësojë testimin e funksionimit në lidhje me integrimin e pajisjeve kur është e praktikueshme. Në nivelin e lartë, sistemi do të përmbajë një përfaqësim të pajisjeve dhe funksionimit të qendrave të komandimit dhe drejtimit dhe pajisjeve të pikave të komandimit në distancë plus një komplet pajisjesh për çdo nënsistem.

Testet FAT të Sistemit do të nisin jozyrtarisht para mbërritjes të vëzhguesve të klientit me qëllim që të sigurohet që sistemi është gati për testim. Pas plotësimit me sukses të këtij testimi, do të fillojë në vazhdim testimi i vëzhguesit të klientit. Me përmbylljen e testit zyrtar, pajisjet do t'i nënshtrohen inspektimit përfundimtar dhe më tej do të përgatiten për t'i nisur për në destinacion (pikë).

Vëzhguesit e Blerësit dhe Furnizuesit do të firmosin dokumentat e testit menjëherë pas përfundimit të testit. Përfundimi me sukses i FAT nuk do të ndikohet nga mungesa e ndonjë deshmitari të autorizuar të Blerësit gjatë testimit FAT ose nënshkrimit të dokumentacionit të testit.

Nje Raport i Testit FAT i cili dokumenton rezultatet e testit do të paraqitet Blerësit. Ky raport do të jete baza per çdo veprim korrigjues dhe zgjidhje të problemeve të identifikuar qe raportohen.

Përfundimi me sukses i FAT, që ka të bëjë me zbatimin e procedurave në Procedurat e Testimit FAT të LM dhe dorëzimi i raportit të Testimit FAT, duke përcaktuar ndonjë veprim korrigjues, do të përbëjë pranimin përfundimtar të pajisjeve dhe mbarimin e veprimtarisë kryesore të Sistemit FAT.

3.3.3 Instalimi dhe kontrolli i sistemit

Përafrimi në faza i punës për Instalimin dhe Kontrollin e Pikave (INCO) do të zbatohet duke lejuar që çdo pikë/nënsistem i ri që instalohet të integrohet në sistem. Testimi i duhur do të kryhet në çdo pikë ndërkohë që instalimi përparon, duke filluar me instalimin dhe montimin e pajisjeve. Qëllimi i këtij testimi është të sigurohet që kompleti i plotë i pajisjeve është instaluar dhe montuar si duhet.

3.3.4 Testi i Pranimin të Qendrës Radar (SAT)

Me përfundimin e instalimit dhe kontrollit për çdo fazë, do të bëhet SAT për të demonstruar funksionimin e sistemit.

SAT-et do të përshkruhen në Planin SAT të SIVHD shqiptare që veçohet në nënsistemet për t'ju nënshtruar një mënyrë të efektshme testimi të të gjithë sistemit me hapa, e ngjashme me teknikën e përdorur për FAT. Plani SAT dhe Procedurat SAT bashkëlidhur do të demonstrojnë funksionimin e sistemit në pikë, duke u përqëndruar në ato funksione që mund të ndikohen nga instalimi dhe montimin i pajisjeve. Blerësi përgjigjet për të siguruar çdo mjedis kontrolli për testimin.

Ekipi i testimit do të mbledhet në pikë për të bërë testimin. Përfaqësuesi i Blerësit pritet të jetë pjesëmarrës në ekipin e testimit. Testimet jozyrtare SAT do të kryhen para testimit zyrtar për t'u siguruar që sistemi do të jetë gati për testim.

Do të kryhen tre SAT të SVHBD, një për çdo fazë që përshkruhen në Propozimin Teknik të SIVHD shqiptar. Çdo SAT do të testojë funksionimin e pajisjeve dhe softuere që ka në këtë fazë të dorëzimit për t'u siguruar që punon në mënyrë të sigurtë dhe të integruar. Për të ndihmuar këtë fazë drejt SAT, Blerësi do të lejojë Furnizuesin të ketë akses në të gjitha pajisjet SIVHD, përfshirë edhe ato prej fazës së mëparshme të SAT, të nevojshme për përgatitjen dhe vënien në jete të secilit SAT.

Pas përmbushjes së testimit SAT, Lockheed Martin do të përgatisë për Blerësin Raportin e Testit SAT, duke dokumentuar çdo mangësi të vërejtur. Ky raport do të shërbejë si bazë për ndonjë problem të identifikuar në të ardhmen, për ta korrigjuar dhe zgjidhur. Ky raport do të ketë gjithashtu konfigurimet e para të sistemit siç konfigurohen nga ekipi i testimit. Ekipi i testimit përgjigjet për restaurimin e sistemit në gjendjen fillestare e konfigurimet bazë, fshirja e file (dokumentit) të testimit nga sistemi] për përdorimin e përdoruesit fundor që ndjek përfundimin e SAT. Në përfundim të çdo SAT, nis edhe garancia për pajisjet që dorëzohen në atë fazë.

Përfundimi me sukses i fazës SAT, që do të thotë zbatim i procedurave në Procedurat e Testimit SAT të LM dhe dorëzim i raportit të Testimit SAT që identifikon çdo veprim korrigjues, do të përbëjë pranimin përfundimtar të asaj faze të SIVHD shqiptar dhe përmbushjen e veprimtarisë kryesore SAT për atë fazë.

OPERACIONET E SISTEMIT TË GARANCISË

4

Mbulimi i sistemit të garancisë përfshin zëvendësim/riparim të artikujve që pësojnë defekt/ prishen gjatë periudhës së garancisë. Përveç kësaj, SIVHD do të dorëzohet bashkë me kompletin e pjesëve rezervë për t'i përdorur për mirëmbajtjen e sistemit gjatë periudhës të garancisë.

Çdo defekt në materialin ose tekniken, cilësinë e punimit, që konstatohet në sistemin e sjellë nga LM, gjatë periudhës së garancisë, do të riparohet.

Nëse gjatë periudhës së garancisë ndodh defekt në pajisje nga përdorimi normal i sistemit, përdoruesi duhet të vërë në dijeni për problemin qendrën përkatëse të shërbimit të LM. Në vijim të këtij njoftimi, shkaku i defektit do të diagnostikohet së pari nga teknikët e mirëmbajtjes të klientit dhe, nëse është e nevojshme nëpërmjet përdorimit të lidhjes diagnostike në distancë, me Qendrën e Shërbimit të LM. Qendra e Shërbimit të LM për lidhje në largësi do të kërkojë paraprakisht miratim nga Blerësi, duke u bazuar në procedurat e sigurisë për të cilat është rënë dakord nga të dyja palët. Në rast së defekti i sistemit ndodh në pajisje, zëvendësimi do të bëhet nga tekniku i mirëmbajtjes që përdor pjesët rezervë, i cili në rast së ka mundësi do të përshpejtojë riparimin. Pjesët rezervë të konsumuara gjatë periudhës së garancisë do të plotësohen nga Furnizuesi, ose si artikuj të ri zëvendësimi ose riparimi.

Me mbarimin e Garancisë Furnizuesi do të inspektojë shitësit për nënsistemet kryesorë të SIVHD lidhur me mbështetjen në të ardhmen dhe daljen jashtë përdorimit. Rezultatet e këtij inspektimi do t'i kalohen Blerësit.

TRAJNIMI

5

5.1 KANDIDATËT DHE KOHA

Tabela 5.1-1 tregon kurset dhe sasitë e propozuara të përgatitjes për dorëzimin SIVHD shqiptar.

Tabela 5.1-1 Sesionet e përgatitjes të SIVHD shqiptar

Kurs Përgatitor	Numri maksimal i të Trajnuarve /Seancave (Kandidatë Gjithsej)	Numri i Seancave të Trajnimit	Ditët Totale të Trajnimit
Kursi i Funkcionimit të Sistemit MTM200	7 (20)	3	15
Kursi i Mirëmbajtjes së Sistemit MTM200 specifik shqiptar	6 (6)	1	5
Trajnim për mirëmbajtjen e nënsistemit radar	6 (6)	1	8
Trajnimit për Nënsistemin e gjeneratorëve	6(6)	1	5 (28orë)
Trajnimit i mjetit të planifikimit SARIS	6(6)	1	2

5.2 VENDI I TRAJNIMIT

Operacioni MTM200 dhe Trajnimi i SARIS për Mjetin e Planifikimit do të zhvillohet në NOC. Trajnimi për mirëmbajtjen i MTM200 do të zhvillohet në NOC (QND) dhe në pikën e sensorit në distance. Instruktori do të ketë njohuritë arsimore dhe përvojën praktike për teknikën e mirëmbajtjes parandaluese/korrigjuese dhe teknikën e funksionimit të MTM200 si instruktor i aftë dhe i kualifikuar. Përgatitja për radarin dhe gjeneratorin e energjisë është përshkruar në paragrafin 5.4.3.

5.3 KURSI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT MTM200

Kursi i Funkcionimit të Sistemit MTM200 do të bëhet në NOC dhe do të familjarizojë operatorët dhe teknikët me të gjithë funksionet e sistemit që kërkohen për operimin e përditshëm të sistemit MTM200. Fillimisht, do të paraqiten qëllimet, funksionet dhe mundësitë e Sistemit MTM200 ashtu si dhe qëllimet, funksionet e mundësitë dhe kuptimi konceptual i përbërësve kryesorë të sistemit. Më tej, do të shpjegohet çdo operacion, përfshirë përshkrimin e paraqitjes (paraqitjeve) të vendit të punës dhe të gjithë kontrolleve, treguesve, menyve dhe formave që kanë të bëjnë me funksionimin. Së fundi, instruktori që drejton përgatitjen do të kujdeset për të mundësuar kandidatët të familjarizohen me të gjitha kontrollet dhe operacionet e Sistemit MTM200. Gjatë kësaj pjese të përgatitjes së detajeve funksionale, kandidatëve do t'i shpjegohet niveli i caktuar si mbikqyrës nga klienti.

Lockheed Martin do të zhvillojë 3 Kurse Funksionimi pesë ditore të Sistemit MTM200 për deri 7 kandidatë secili. Çdo grumbullim konsiston në një përgatitje pesë ditore në laborator dhe me instruktor në praktikë mbi funksionimin e sistemit MTM200, duke përdorur si sistemin MTM200 në NOC dhe, së paku, një RSS që funksionon plotësisht. Kjo do të mundësojë kandidatët të familjarizohen me sistemin në kushtet e funksionimit gjatë provës.

Përgatitja e Funksionimit të MTM200 do të konsistojë si më poshtë:

- Përshkrimi i sistemit në tërësi
- Përshkrimi fizik, funksional dhe ndërfaqësimi i Sistemit MTM200
- Përshkrimi i funksionimit normal
- Kryerja e funksionimit normal.
- Përshkrimi i hollësishëm i sistemit të përgjithshëm.
- Përshkrimi i hollësishëm fizik, funksional dhe ndërfaqësor i Sistemit MTM200

5.3.1 Kushtet Paraprake për Përgatitjen e Operacioneve të Sistemit MTM200

Kandidatët që ndjekin Kursin e Funksionimit të Sistemit MTM200 do të përmbushin kushtet e mëposhtme paraprake për t'u siguruar që të përfitojnë maksimalisht nga përgatitja.

- Aftësitë bazë Vetjake Kompjuterike.
- Aftësi gjuhësore në gjuhën angleze për terminologjinë detare ndërkombëtare.
- Procedurat e Radio Telefonisë Specifike për Rajonin e Operimit Shqiptar.
- Njohuri për radarin bazë specifik për Rajonin e Operimit Shqiptar.

5.3.2 Ekspertë të trajnuar që zhvillojnë trajnime.

Lockheed Martin do të sigurojë instruktorin për Kursin e Funksionimit të Sistemit MTM200 që ka dhënë prova si instruktor i zoti. Instruktori do të jetë me përvojë në operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të ngjashme me komponentët që përbëjnë Sistemin MTM200. Ndërkohë, instruktori do të njihet mirë me të gjithë dokumentacionin e sistemit dhe Konfigurimin e Sistemit MTM200 shqiptar.

5.4 PËRGATITJA PËR MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT

Kursi i Mirëmbajtjes të Sistemit MTM200 do të familjarizojë operatorët me të gjitha funksionet e sistemit që nevojiten për funksionim bazë të sistemit MTM200. Fillimisht, do të prezantohen qëllimet, funksionet dhe mundësitë e sistemit MTM200 ashtu si dhe qëllimet, funksionet, mundësitë dhe kuptimi konceptual i komponentëve kryesorë të tij. Pastaj, do të shpjegohet çdo operacion, duke përfshi edhe përshkrimin e paraqitjes(paraqitjeve) të vendit të punës dhe të gjitha kontrolleve, indikacioneve, menyve dhe formave që kanë të bëjnë me funksionimin.

Veç përgatitjes në sistemin bazë, Inxhinierët e Mirëmbajtjes të Sistemit do t'i nënshtrohen përgatitjes së hollësishme mbi strukturën fizike të sistemit, operimin funksional dhe ndërfaqësimet. Kjo përgatitje do të ndiqet nga një përshkrim i hollësishëm i alternativave të mundshme të rikonfigurimit. Gjithashtu, do të shpjegohet filozofia e mirëmbajtjes që përmban përshkrimin e Mirëmbajtjes Parandaluese (PM) i cili përfshin plane dhe procedura të mirëmbajtjes parandaluese të sistemit, si dhe Mirëmbajtja Korrigjuese (CM). CM përfshin zbulimin e defektit dhe lokalizimin e pajisjes së defektuar, duke përdorur programet kompjuterike për të bërë teste dhe diagnostikim rutinë në distancë. Pas nënshtimit të kësaj përgatitje Inxhinierët e Mirëmbajtjes të Sistemit do të njihen me përshkrimin e çdo të dhënash baze MTM të aplikuar dhe detyrën e administrimit të sistemit MTM200, përfshirë përshkrimin e paraqitjeve, kontrolleve, indikacioneve, menyve dhe formave me secilin.

Së fundi, instruktori që drejton përgatitjen në klasë dhe praktikë do të kujdeset për të mundësuar kandidatët të familjarizohen me kontrollet e nevojshme dhe Mirëmbajtjen e Sistemit MTM200.

Lockheed Martin do të zhvillojë një kurs pese ditor Përgatitje për Mirëmbajtjen e Sistemit MTM200 me jo më shumë se 6 persona. Kursi për Mirëmbajtjen dhe Funksionimeve e Sistemit MTM200 do të zhvillohet nën drejtimin e instruktorit në laborator dhe praktikë aktive, duke përdorur sistemin MTM200 në NOC (QND) dhe, së paku, një pikë Kontrolli në Distancë që funksionon plotësisht. Kjo do të mundësojë kandidatët të familjarizohen me sistemin në kushte normale pune.

Përgatitja për Mirëmbajtjen e Sistemit MTM200 do të konsistojë nga sa më poshtë:

- Përshkrimi i Sistemit të Përgjithshëm
- Përshkrimet fizike, funksionale dhe ndërfaqësore të Sistemit MTM200
- Përshkrimi i Funksionimit Normal
- Kryerja e Funksionimit Normal
- Përshkrimi i Administrimit të Sistemit
- Kryerja e Administrimit të Sistemit
- Përshkrimi i Administrimit të të Dhënave Bazë.
- Kryerja e Administrimit të të Dhënave Bazë.
- Përshkrimi i Hollësishëm i Sistemit të Përgjithshëm
- Përshkrimet e hollësishme fizike, funksionale dhe ndërfaqësore të Sistemit MTM200
- Përshkrimi i Funksionimit të Rikonfigurimit
- Kryerja e Operacionit të Rikonfigurimit
- Përshkrimi i Mirëmbajtjes Parandaluese
- Kryerja e Mirëmbajtjes Parandaluese
- Përshkrimi i Mirëmbajtjes Korrigjuese
- Kryerja e Mirëmbajtjes Korrigjuese

5.4.1 Kushtet Paraprake për Përgatitjen e Mirëmbajtjes MTM200

Kandidatët që ndjekin Kursin e Mirëmbajtjes të Sistemit MTM200 duhet të përmbushin kushtet paraprake të për t'u siguruar që marrin njohuritë maksimale nga përgatitja. Ato duhet të kenë

njohuri për:

- Ndërfaqësimet dhe operacionet vetjake kompjuterike
- Komandat dhe Funkcionimet e Linjës së Komandës (DOS) PC
- Procedurat Radio Telefonike specifike për rajonin e Operimit të Shqipërisë
- Njohuritë bazë dhe Njohuri për Radarin Bazë
- Bazat e Kompletit Oracle
- Microsoft Windows NT ose 2000 Administration
- Njohuritë Bazë Ethernet, Internet si dhe Administrimin e LAN/ WAN dhe përdorimin e Switching/Routing
- Përbërësin Analog dhe Numerik Elektrik/Elektronik dhe Problemet e Riparimit të Sistemit
- Ndërtimin dhe Strukturën Kabllore Numerike dhe Analoge
- Aftësi në Zbërthimin e Skemave Elektrike/Elektronike

Veç kësaj kushtet paraprake të mëposhtme rekomandohen për t'u mundësuar kandidatëve të përfitojnë maksimalisht për sa u përket përbërësve të administrimit të sistemit të Kursit të Mirëmbajtjes së Sistemit MTM200.

Oracle DBA të certifikuar

Microsoft Windows të certifikuar

Administrim i Rrjetit Cisco të certifikuar

Bazat Veritas

5.4.2 Trajnimi zhvillohet nga Ekspertë të trajnuar.

Lockheed Martin do të sigurojë një instruktor për Kursin e Mirëmbajtjes të Sistemit MTM200, i cili njihet si instruktor kompetent. Instruktori do të jetë me përvojë në operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të ngjashme me komponentët që përbëjnë Sistemin Shqipëri MTM200. Personeli me përvojë HHI/Shitësit do të japë mbështetjen e duhur për instruktorin në përgatitjen për mirëmbajtjen.

5.4.3 Trajnimi për Mirëmbajtjen e Gjeneratorit dhe Radarit

Lockheed Martin do të sigurojë përgatitjen për mirëmbajtjen e nënsistemeve radarë SIVHD dhe atyre të gjeneratorëve të energjisë. Kjo përgatitje do të drejtohet nga nënkontraktorët e Lockheed Martin me ekspertizën e nevojshme në secilën nga këto fusha.

Përgatitja për radarët do të jetë së paku një kurs 8 ditor i zhvilluar në qendrën radar të Durrësit (ose në një RSS të ngjashme). Përgatitja për gjeneratorët do të jetë një kurs 24 orë që do të zhvillohet në një periudhë pesë ditore. Përgatitja për gjeneratorët e energjisë do të zhvillohet në qendrën SIVHD të pajisur me kompletet e nevojshme të gjeneratorëve të energjisë ose në mjediset e nënkontraktorit në Tiranë.

5.5 PËRGATITJA E MJETIT TË PLANIFIKIMIT SARIS

Kursi i përgatitjes të mjetit të planifikimit SARIS do të bëhet në QND dhe do të shërbejë në familjarizimin e operatorëve me të gjithë funksionimin e sistemit që nevojitet për të vënë në punë SARIS, aplikimin e softuere të planifikimit të kërkimit dhe shpëtimit. Ky kurs do të zhvillohet nga një instruktor ekspert në aplikimin e SARIS-it. Kursi i përgatitjes të mjetit të planifikimit SARIS do të jetë dy ditor dhe instruktori do synojë në përdorimin e aplikimit të planifikimit SARIS në kërkim shpëtim. Kursi i trajnimit do të mbulojë çështjet e mëposhtme:

- Kërkesat e Sistemit Softuer Saris
- Preferencat e përdoruesit të mjetit SARIS
- Realizimi i Konfigurimin të Modelit Saris;
- Funksionimi i Modelit A Sad
- Funksionimi i Modelit A Sac
- Përpunimi i modelit të mëparshëm
- Mjeti i planifikimit të drejtimit

5.6 PËRKTHYESIT TEKNIKË

Përkthyesit teknikë që sigurohen nga klienti, të aftë në përkthimin teknik shqip-anglisht shqip do të përdoren gjatë gjithë kohës së trajnimit. Përkthyesit do të shoqërojnë instruktorin gjatë përgatitjes së instruktorit në vend. Përkthyesit do të jenë në dispozicion të instruktorit gjatë gjithë kohës së zhvillimit të trajnimit.

5.7 PROGRAMI I PËRGATITJES

Para se të fillojë përgatitja Lockheed Martin do të konsultohet me Ministrinë shqiptare të Mbrojtjes për hollësitë e planit mësimor dhe përgatitjes, metodës dhe programit, etj.

Lockheed Martin do t'i japë klientit Planin e Përgatitjes MTM200 së paku tre javë para fillimit të kursit të përgatitjes. Plani i Përgatitjes do të përmbajë:

- Qëllimin e Planit të Përgatitjes
- Fushën e Planit të Përgatitjes
- Konceptin e Përgatitjes MTM200
- Përbërjen e personelit që përgatitet
- Vendin, Përmbajtjen dhe Kohën e Trajnimit
- Pajisjet e Nevojshme
- Mbështetjen e Trajnimit të Kontraktorit
- Programet e Trajnimit

Programi Mësimor i SIVHD tregon saktësisht se kur do të zhvillohen seancat e ndryshme trajnuese.

Shtojca A

Lista e Pajisjeve të SIVHD

Kjo shtojcë përcakton pajisjet që jepen nga Lockheed Martin për Sistemin e Vëzhgimit Bregdetar Shqiptar. Tabela A-1 liston pajisjet që dorëzohen për Sistemin FAT dhe radarë; tabela A-2 liston pajisjet e infrastrukturës së qendrës (pikës) si pjesë e pajisjes të kullës dhe dorëzimin e gjeneratorit/strehimit; tabela A-3 liston pajisjet e WAN që dorëzohen për pajisjet mikrovalë.

Çmimet e treguara në Tabelën A-1 janë të vlefshme vetëm nëse e gjithë SIVHD, siç përcaktohet në Qëllimin e Furnizimit, do të blihet për Çmimin e Kontratës të përcaktuar në Afatet dhe Kushtet. Lockheed Martin ruan të drejtën të zëvendësojë pjesët sipas Afatet dhe Kushtet e kontratës.

Equipment	Make/Model	Vendor	Phase 1	Phase 2	Phase 3	TOTAL
LAN						
Switch, Unmanaged, 10/100Base-T, 24 Port, rackmount	JFS524NA	Netgear	12			12
Cable, Ethernet, 3 foot, stranded, Category 5	A3L791-03-CDW	Belkin	30			30
Cable, Ethernet, 7 foot, stranded, Category 5	A3L791-07-CDW		30			30
Cable, Ethernet, 25 foot, stranded, Category 5	A3L791-25		10			10
Router						
10/100Base-T Modular Router, Rackmount, with IOS	Cisco1760	Cisco	18			18
1 Port Serial WAN Interface Card	WIC-1T	Cisco	30			30
Router V.35 Cable	CAB-V35MT	Cisco	6			6
SmartNet Maintenance for Cisco 1760	CON-SNT-1760	Cisco	18			18
CSU/DSU, V.35 to E1	MT240A-R2	Black Box	30			30
Cable, HD26 to M/34	EHN092-V35M	Black Box	30			30
RDP and IAUs						
PC, 3 GHz, 1 GB RAM, 40 GB HDD, dualmonitor graphics card, CDRW, Win2K	PWS360	Dell	14			14
Virgo Radar Interface Card, PCI form factor, 12 month warranty extension		Primagraphics	14			14
RDP Fanout Board and Interconnect Cable	SP7152	LCOM				
8-port RS-232, w/DB25 hydra cable	70001548	Digi International	14			14
RS422/RS232 Optically isolated adapter, DB25F/terminal strip	485OTLED	B&B Electronics	14			14

Equipment	Make/Model	Vendor	Phase 1	Phase 2	Phase 3	TOTAL
Modified X-Band antenna unit, circular polarization with gearbox including tilt system of minimum +5/-15 degrees with respect to the horizon.	ASX-1901	GEM	1	1	5	7
Antenna Supply unit (ASU) for electronic torque control and variable speed regulation.		GEM	1	1	5	7
X-Band 25 Kw, dual transceiver unit, including microwave switch and dummy load	RT02-25	GEM	1	1	5	7
Installation materials for each radar system (cables, connectors, mechanical brackets, waveguides, flanges, etc.)		GEM	1	1	5	7
Technical manuals for radar material provided		GEM	1	1	5	7
Installation, mounting and power requirements specifications		GEM	1			1
Measuring devices for setting the antenna installation angle, consisting of a digital inclinometer with 0,1 degree accuracy in the range 0-90 degrees		GEM	1		1	2
Waveguide for shelter installation. Approximate Waveguide length as follows: 1 x 37 meters, 4 x 22 meters and 2 X 12 meters. (Calculated by adding 7 meters to the tower height at each site)		Andrew	1 set			1
uAIS Subsystem						
AIS Base Station, no dGPS	R40 AIS Base Station	SAAB	1	1	5	7
PCAP, with laptop		SAAB	4			4
VTC Workstation						
PC, 3 GHz, 1 GB RAM, 40 GB HDD, dualmonitor graphics card, CDRW, Win2K	PWS360	Dell	14			14
Flat-Panel, 20.0" Viewable ImageSize	320-1578	Dell	10	6	10	26
VTC Console Equipment						

Equipment	Make/Model	Vendor	Phase 1	Phase 2	Phase 3	TOTAL
Console, single operator, 78-3/4" W x 47-1/2" D x 28 3/4"		Radial	6	3	5	14
Chair, ergonomic			6	3	5	14
VTC Rec/Replay Components						
Tape drive, external, DDS IV 20/40 GB	SDT-D11000/ME	Sony	2			2
Recorder, digital, 16 channel, dual 780 hour DVD RAM drives, rack mount	Wordnet Series III	Racal	2			2
PC, 3 GHz, 1 GB RAM, 40 GB HDD, dualmonitor graphics card, CDRW, Win2K	PWS360	Dell	2			2
DVD Media, 4x, 50 Pack	94613	Verbatim	2			2
DDS IV Tape, 10 Pack	DC4-150RBX10	TDK	10			10
SCSI card U320	29320	Adaptec	2			2
DLT media, 5 pack		Dell	11			11
VTC DataBase /Correlator Processor						
Database Server PC -- 2.8 GHz, 1 GB, dual PS, UltraSCSI, 2 x 36 GB HDD, Dual NIC, Windows Advanced Server w/25 user licensing	PowerEdge 1750	Dell	2			2
RAID, dual power supply, 7x36 GB disks,	PowerVault 220S	Dell	1			1
Tape library, system backup	PowerVault122T	Dell	1			1
Domain Controller/Correlator PC -- 2.8 GHz, 1 GB, dual PS, UltraSCSI, 2 x 36 GB HDD, Dual NIC, Windows Server w/5 user licensing	PowerEdge 1750	Dell	2			2
Equipment Racks						
HUBBELL FULL SIZE CABINET 85"H x 19"W x 31.75"D	HPW78C19X30	Hubbell	5	5	13	23
Telescoping shelf	MCCTELSHLF	Hubbell	10	10	26	46
Fixed shelf	MCCPSHLF	Hubbell	5	5	13	23
Power Strip, remote controlled, 8 port, international 16 amp	AP7921	APC	18			18

Equipment	Make/Model	Vendor	Phase 1	Phase 2	Phase 3	TOTAL
Kbd/trackball, 15" 1024x768 LCD, Black, 1U, 32.2 lb	AR8215BLK	APC	2			2
APC Smart-UPS XL 2200VA RM 5U 230V	SU2200RMXLINET	APC		3	13	16
Spare Battery Pack, 136 lb, 4U	SU48RMXLBP	APC	5			5
APC Smart-UPS 2200XLINET , Tower	SU2200RMXLINET	APC	3	3	6	12
Misc Equipment						
GPS NTP Time Server, w/100' cable	Acutime 2000	Trimble	1			1
Plasma Display, 61"	61XM2	NEC	3			3
Color Laser Printer, 17 pages per minute	4600DN	HP	2	1		3
Monochrome laser printer, 19 ppm	2200D	HP	2	1		3
VOIP Intercom Adapter	VIP-810	Valcom	19			19
Binoculars, 4x, nighttime, Gen 2+ SUBJECT TO US STATE DEPT EXPORT APPROVAL	Newcon Night Vision 4X60 NVS7-2/4X	Newcon	4			4
Binoculars, 12x, day/night, stabilized, Gen 2.5 SUBJECT TO US STATE DEPT EXPORT APPROVAL	Fujinon 12x40D/N Stabiscope	Fujinon	6			6
Software						
LM MTM200 Site License		LM	1			1
Oracle Database Standard Edition One, with first year maintenance, per-CPU, Full Use		Oracle	2			2
Oracle Media (CD ROM)		Oracle	1			1
BACKUP EXEC 9.0 WIN SVR CMBO	A0083276 (Dell)	Veritas	1			1
BACKUP EXEC 9.0 WIN IDR OPTION	A0083453 (Dell)	Veritas	1			1
BACKUP EXEC 9.0 WIN IDR OPT ADD	A0083664 (Dell)	Veritas	2			2
BACKUP EXEC 9.0 WIN MEDIA KIT	A0083916 (Dell)	Veritas	1			1
BACKUP EXEC 9.0 WIN ADV OPEN	A0083675 (Dell)	Veritas	1			1
BACKUP EXEC 9.0 ORACLE SVR AGT	A0083529 (Dell)	Veritas	2			2
Charts, 1 set			1			1
Lloyds data, 1 set		Lloyds	1			1
SAR coordination software		BMT	1			1

Tabela A-2 Pajisjet e Infrastrukturës së Qendrës të VHD
(Kullat, Gjeneratorët e Ushqimit dhe Strehimet për Pajisjet)

Emri i Qendrës	Vend-ndodhja	Kulla 1 (lartësia)	Gjenerator 12 kw		Pajisjet e Kabinës elektrike 2 (madhësia nominale)
			Numri i gjeneratorëve	Depozitë karburanti në ditë	
Komanda e Flotës	N 41 17.535 E 19 30.688	Nuk ka	1	7.5	asnjë
SH Distriktit Detar Verior	N 41 24.514 E 19 23.808	Zinxhir Comms (40m)	1	7.5	asnjë
SH Distriktit Detar Jugor	N 40 19.614 E 19 25.082	asnjë	1	7.5	asnjë
Sarandë	N 39 52.468 E 19 59.179	Zinxhir Comms (30m)	2	7.5	asnjë
Shëngjin	N 41 48.632 E 19 34.988	Radar vetmbështetës (30m)	2	7.5	asnjë
Durrës	N 41 19.945 E 19 25.440	Radar vetmbështetës (5m)	2	7.5	asnjë
Hidrovor	N 40 52.819 E 19 25.440	Radar vetmbështetës (30m)	1	7.5	Po (4m x 2.5m)
Sazan	N 40 30.165 E 19 16.340	Radar vetmbështetës (15m)	3	30	Po (4m x 2.5m)
Llogara	N 40 12.065 E 19 33.903	Radar vetmbështetës (15m)	3	30	Po (4m x 2.5m)
Porto Palermo	N 40 03.003 E 19 47.635	Radar vetmbështetës (15m)	2	7.5	Po (4m x 2.5m)
Ksamil	N 39 45.192 E 19 58.700	Radar vetmbështetës (15m)	2	7.5	Po (4m x 2.5m)
Zvërnec	(TBS)	Zinxhir Comms (25m)	23	7.5	Po (1m x 1m)

Shënime:

1. Kullat e projektuara dhe të prodhuara sipas standardit ANSI /TIA /EIA – 222 F
2. Përfshihen bazamentet për pajisjet e kabinave elektrike dhe gjeneratorëve.
3. Gjeneratori i Zvërnecit është më pak së 12kw.

Përshkrimi i pajisjeve të Kullës

Lista e mëposhtme përcakton artikujt dhe materialet që do të furnizohen me instalimet e kullës të listuara në Tabelën A-2:

-Materialet e çelikut të kullës të projektuara & prodhuara sipas standardit ANSI /TIA /EIA– 222–F

- Shkallë të brendshme të montuara për ngjitje (vetëm për kullat vetëmbështetëse)
- Alet sigurimi për t'u ngjitur.
- Platforma e Punës me shtrirjen e shërbimit (vetëm për kullat vetëmbështetëse)
- Shkallë mbështetëse për drejtimin e valëve (vetëm për kullat vetëmbështetëse)
- Mbajtëse mbërthyesë e drejtimit të valëve (vetëm kulla vetëmbështetëse)
- Bazament radari (vetëm për kullat vetëmbështetëse)
- Kapse(t) e Montimit të VHF (vetëm për kullat vetëmbështetëse)
- Mbajtëse(t) e Antenës Microvalë(s)
- Sistemi i Tokëzimit
- Pajisje ndriçimi lajmërimi për avionët (ku kërkohet nga rregullat vendore).

Përshkrimi i Pajisjeve të Gjeneratorëve

Tabela A-2.1 përcakton pajisjet e furnizuara me instalimet e gjeneratorëve elektrikë, të listuara në Tabela A-2.

Tabela A-2.1 Pajisjet e gjeneratorit të ushqimit për qendrën e VHD

Artikulli	Komente
Gjenerator (përveç Zvërnecit)	Fuqia e matur: 12.1 kVA - 12 kW Voltazhi: 240 V faza e vetme Frekuenca: 50 Hz Rregullimi i Voltazh-it : +/- 1 % Ndezja elektrike Kontrolli/statusi i panelit Kontrolli në distancë/ statusi i modulit ndërfaqësor
Gjenerator (vetëm Zvërnec)	Fuqia e matur: 2.25 KVA – 1.8 kW (minimum) Voltazhi: 240 V faza e vetme Frekuenca: 50 Hz
Çelës(at) e ndërrimit automatik	1 deri 3 çelsa ndërrimi në varësi të konfigurimit gen-set 72A çelësa në 12kw sites 50A çelësa në Zvërnec
Depozitë e jashtme karburanti	650L në 1 gen-set 12kW për pikë 1000L në 2 gen-set 12kW për pikë 5500L at 3 gen-set 12kW për pikë 400L në Zvërnec
Sistemi i Tokëzimit Depozitë e jashtme vaji lubrifikant	Depozita ndihmëse e vajit lubrifikant të sistemit vendoset në 3 pikat ku janë gjeneratorët (Llogara dhe Sazan). Sistemi siguron vaj lubrifikant plus për të rritur kohën e punës të gjeneratorit në pikat me komandim në largësi pa ushqim energjie parësore.
Sistemi i administrimit në distancë	Sistemi i monitorimit (softuer dhe harduer) i instaluar në QND mundëson komandimin në distancë dhe monitorimin e gjendjes së gjeneratorëve të ushqimit të pajisur me module ndërfaqësimi.

Pjesët rezervë të gjeneratorit

Tabela A-2.2 përcakton pjesët rezervë të gjeneratorit.

Tabela A-2.2 Pjesët rezervë të gjeneratorit të Qendrës VHD

Përshkrimi		Sasia
1	RripbFan	40
2	Mbulese Rocker gasket	20
3	Kompleti i plotë tapash (gasket)	20
4	Rregullatori i voltazhit standard	20
5	Drejtues NDE	20
6	Urë Diode	20
7	Ulës për rritje voltazhi	20
8	Çelës për presionin e vajit	20
9	Çelës matës temperature uji	20
10	Valvul mbledhëse	320
11	Valvul për hedhje uji	160
12	Zorrë për Radiatorin e poshtëm	20
13	Zorrë për Radiatorin e sipërm	20
14	Stopues Solenoidi	20
15	Guide valvule inlet	80
16	Guide valvule outlet	80
17	Injektor karburanti i plote	80
18	Rod Bearing std lidhes	80
19	Komplet kryesor Bearing	20
20	Komplet Unazash Pistoni std	80
21	Vule valvule	160
22	Vule injeksioni	160
23	Gasket i kthimit të karburantit	160
24	Injektim karburanti Nozzle	80
25	Pompe uji e plote	20
26	Pompe karburant hedhëse	40
27	Valvul Spring	160
28	Rele filluese (solenoid)	20
29	Valvul Inlet	80

	Përshkrimi	Sasia
30	Valvul Outlet	80
31	Termostat	40
32	Vulë Termostati	40
33	CB i Bordit Elektronik	20
34	Assorted Fuses	100

Tabela A-3 Pajisjet e WAN të SVHD

Pajisjet	Shitësi/Modeli	Sasia
Montimet e Radios1		
Proteus AMT 7GHz Radio Terminal, HSB, 7MHz, 4E1 - 3 RU	MNI / Proteus 7	10
Proteus AMT 7GHz Radio Terminal, MHS, 14MHz, 8E1 - 3 RU	MNI / Proteus 7	10
Proteus AMT 7GHz Radio Terminal, HSB, 28MHz, 16E1 - 3 RU	MNI / Proteus 7	8
7.5ft x 19in Rack and Mount Radio		11
TRIMM,757001921, FUSE PANEL,+/-48/24V		11
Kabinet2 i jashtëm (62"H X 25"Ë X 34"D) 60 Amp Load Center 1/2" Insulation 600 Watt Heater Strip Fan Kit / Termostat		4
EOW Handset		15
Enterprise Edition plus Shtrirje e Hyrjes në largësi		1
EMS Desktop Workstation		1
Sistemi i Antenave		
LMR-400 Kabllo koaksiale (për meter)		783
N-type connector for LMR-400 - 2 required per IDU/ODU cable		224
In Line N-Connector Surge Supressor		56
ANT,ANDREW,VHP2-71W-MN3,7/8G,0.6M,MN3		14
ANT,ANDREW,VHP4-71W-MN3,7/8G,1.2M,MN3		6
ANT,ANDREW,VHP6-71W-MN3,7/8G,1.8M,MN3		4
ANT,ANDREW,PL8-71W,7/8G,2.4M		4
Andrew Molded Radome, 8 ', 2.4 m (R8F)		4
Andrew, 520570-3 Outboard Strut Kit		8
Microflect 4 Holes Hanger for LMR400 (kit of 5)		140
Microflect 2 Holes Hanger for LMR400 (kit of 5)		36

Pajisjet	Shitësi/Modeli	Sasia
Angle Adapter with 3/8" Threaded Hardware (kit of 10)		176
Standard Ground Kit for LMR-400, 1/4 Crimp Lug (2 hole)		168
Hoisting Grip for LMR-400		56
Microflex 2 Hole, 4", Entry Plate		15
Microflex 4 Holes, 4", Boot for LMR400		11
Microflex 2 Holes, 4", Boot for LMR400		6
ODU Stand-alone Mount		4
24" Twist - Flex, CPR112G, F112PA0240C		4
Sistemet e Ushqimit të Energjisë		
Valere 40 Amp, Redundant, 24VDC, SNMP, Power System, No Rack		2
Valere 80 Amp, Redundant, 24VDC, SNMP, Power System, No Rack		2
130 AH Bateri		2
260 AH Bateri		2
Bateri Tray SVF19 (19W X 21D X 7.5RU H)		6

Shënime:

1. Alternativë e radios 12GHz, e mundshme nëse plotësohen kërkesat e sistemit për lidhjen në largësi.
2. Maksimumi 4 kabina pajisjesh në qendrat rele mikrovalë. Dhomat ekzistuese të pajisjeve mund të përdoren nëse janë të disponueshme.

Tabela A-3.1 përcakton pjesët rezervë të pajisjeve WAN.

Tabela A-3.1 Pjesët Rezervë të WAN-it të SIVHD

	Përshkrimi	Sasia
1	7 GHz ODU	2
2	IDU (w/o Plug-ins, I/F card or power supply)	1
3	IDU Power Supply, +24VDC	1
4	I/F Card – 7 MHz Bandwidth	1
5	I/F Card – 14 MHz Bandwidth	1
6	I/F Card – 28 MHz Bandwidth	1
7	4E1 LIM Plug-in	1
8	8E1 LIM Plug-in	1
9	HSB/16E1 LIM Plug-in	1
10	HSB Switching Shelf 2 – 16E1 (16E1 Left)	1
11	Blank Plug-in cover	1
12	Valere, V100B, 40 Amp, 24 Volt modules	1

Site Name	Estimated Location	Tower (height)	8-12kW Generator		Equipment Shelter (nominal size)
			Number of Generators	Days Fuel Storage	
Navy Command	N 41 17.535 E 19 30.688	None	1	7.5	None
North Naval District HQ	N 41 24.514 E 19 23.808	Guyed Comms. (40m)	1	7.5	None
South Naval District HQ	N 40 19.614 E 19 25.082	None	1	7.5	None
Sarande	N 39 52.468 E 19 59.179	Guyed Comms. (30m)	2	7.5	None
Shengjin	N 41 48.632 E 19 34.988	Self Supported Radar (30m)	2	7.5	None
Durres	N 41 19.945 E 19 25.440	Self Supported Radar (5m)	2	7.5	None
Hidrovor	N 40 52.819 E 19 25.440	Self Supported Radar (30m)	1	7.5	Yes (4m x 2.5m)
Sizan*	N 40 30.165 E 19 16.340	Self Supported Radar (15m)	3	30	Yes (4m x 2.5m)
Llogora	N 40 12.065 E 19 33.903	Self Supported Radar (15m)	3	30	Yes (4m x 2.5m)
Porto Palermo	N 40 03.003 E 19 47.635	Self Supported Radar (15m)	2	7.5	Yes (4m x 2.5m)
Ksamil	N 39 45.192 E 19 58.700	Self Supported Radar (15m)	2	7.5	Yes (4m x 2.5m)

Shtojca B

Detajimi/ Zbërthimi i Çmimit dhe Vlerat e Veprimtarive kryesore të SIVHD

Tabela B-1 e kësaj shtojce zbërthen çmimin e SIVHD në artikuj të shërbimeve, materialeve dhe infrastrukturës. Gjithashtu, kjo tabelë përcakton se cili nga ata artikuj përfshihet në programin e veprimtarive kryesore të projektit. Çmimet e ndara në artikuj janë të vlefshme vetëm nëse e gjithë SIVHD, siç përcaktohet në këtë Qëllim Furnizimi, blihet përkundrejt Çmimit të Kontratës të

përcaktuar në Afatet dhe Kushtet. Tabela B-1 e mëposhtme jep përcaktimin e termave të përdorura në përcaktimin me hollësi të çmimit.

Përcaktimi i Termave në Tabelën B-1

Administrimi i Programit: Çmimi për administrimin e plote të programit si në ShBA ashtu dhe në Shqipëri. Kjo përfshin punën që lidhet me Administratorin e Programit, mbështetjen e tij për Administrimin e Programit brenda vendit, dhe mbështetjen funksionale të programit nga Administratori i Financës, Administratori i Kontratave, Master Planifikimi, Administrimi i Kontratës dhe organizatave të tjera jo inxhinierike.

Projekti i Sistemit: Çmimi për zhvillimin dhe dokumentimin e Projektit të Sistemit që përfshin projektin e detajuar të gjithë Nën sistemeve. Gjithashtu, përfshin përgatitjen SDR dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me të si dhe punën që lidhet me Inxhinierin Drejtues të Projektit, Administrimin e Konfigurimit dhe Organizatat për Sigurimin e Cilësisë.

Integrimi i Sistemit: Çmimi për përpjekjen për të integruar të gjithë softuere dhe harduere e nën sistemit në një sistem përfundimtar të gatshëm për System FAT (testi pranimit në fabrike). Kjo përfshin gjithë kohen laboratorike për të konfiguruar dhe testuar të gjitha pajisjet, kohen për proceset inxhinierike për të përfunduar integrimin e sensorëve të rinj dhe përpjekjet inxhinierike për të përgatitur sistemin për FAT.

Instalimi dhe Kontrolli: Çmimi për instalimin e të gjitha pajisjeve të sistemit në të gjitha pikat në Shqipëri. Kjo përfshin punën (të LM si dhe të nënkontraktorë lokalë) që lidhet me instalimin, shtrirjen e kablove, lidhjet dhe ushqimin elektrik të të gjitha pajisjeve elektronike të sistemit. Këtu është i përfshirë edhe çmimi për shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin.

Testi i Sistemit: Çmimi për kryerjen e FAT-it dhe SAT-it Zyrtar. Kjo përfshin punën e LM si dhe punën e nënkontraktorëve lokalë. Këtu është i përfshirë edhe çmimi për shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin.

Trajnimi: Çmimi për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e të gjitha kurseve operacionale, të mirëmbajtjes dhe të administrimit të sistemit për VTMS, Radarin dhe sistemin e ushqimit të energjisë. Gjithashtu është i përfshirë çmimi për udhëtimin dhe qëndrimin në lidhje me punën gjatë kohës së Trajnimit të Shqiptareve në Sirakuze para FAT-it.

Garancia: Çmimi për garantimin e të gjitha materialeve të sistemit dhe vete sistemin nga koha e çdo SAT-i individual deri në 12 muaj pas SAT-it 3. Gjithashtu, janë të përfshira gjithë puna dhe materialet që lidhen me periudhën e garancisë.

Studimi i Pikës dhe Mbështetja Inxhinierike Civile: Çmimi për kryerjen e një studimi të gjithanshëm dhe të kujdesshëm të Pikave nëpër Shqipëri (duke përfshirë udhëtimet dhe qëndrimet) me qëllim finalizimin e të gjitha detajeve të projektit dhe të instalimit. Gjithashtu përfshin mbështetjen për të rishikuar të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetet Inxhinierike Civile të Klientit.

Mbështetja për Prokurimet: Çmimi për prokurimin dhe dorëzimin i pajisjeve SIVHD. Përfshin gjithashtu Sigurimin e Cilësisë, inspektimin, transportin/marrjen në dorëzim, sigurimin, punën që lidhet me prokurimin e pajisjeve si dhe aktivitetet për paketimin, ambalazhimin dhe transportin.

Të ndryshme: Udhëtime dhe qëndrime për Administrimin e Programit: Çmimi për të gjitha shpenzimet e udhëtimeve dhe qëndrimeve për ekipin administrues të programit dhe ekipin trajnues. Përfshin të gjitha udhëtimet për në Shqipëri dhe në ambientet e nënkontraktorëve.

Të ndryshme: Tarifa Financimi dhe Llogarie: Tarifat në lidhje me sigurimin, tarifat bankare në ShBA, bono dhe çdo instrument tjetër financiar, etj.

Materialet: Çmimi për pajisje individuale duke përfshirë transportin, sigurimin dhe punën që lidhet me mbështetjen për prokurimin e pajisjes, dhe aktivitetet të paketimit, ambalazhimit dhe transportit.

Infrastruktura: Çmimi për materialet e infrastrukturës së sistemit (kullat, sistemet e ushqimit të energjisë, kabinat e pajisjeve dhe bazamentet si dhe rrjeti mikrovalë). Përfshin transportin, sigurimin dhe punën që lidhet me mbështetjen për prokurimin dhe aktivitetet e paketimit, ambalazhimit dhe transportit. Gjithashtu përfshin punën që lidhet me administrimin nënkontraktor të

Lockheed Martin.

SISTEMI I INTEGRUAR I VEZHGIMIT TE HAPESIRES DETARE
PAJISJET, MJEDISJET, SHËRBIMET DHE INFORMACIONI I SIGURUAR NGA
BLERËSI

Afatet dhe Kushtet – Shtojca 4

Paisjet, Mjediset, Shërbimet dhe Informacioni që sigurohen nga Blerësi

Kjo Shtojcë përcakton kërkesat për pajisje, mjedise, shërbime dhe informacion që sigurohen nga MM shqiptare (MM ose “Blerësi”) për Lockheed Martin (LM ose (Furnizuesi”) në mbështetje të projektit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare.

Pajisjet, mjediset, shërbimet dhe informacioni që sigurohet nga MM shqiptare për mbështetjen e Paraqitjes së të Dhënave të Kontrollit të Trafikut Ajror në QBO përshkruhet në Propozimin Teknik të SIVHD shqiptare – Shtojca II e datës 15 maj 2006.

Në këtë shtojcë përdoren terma dhe shkurtime të ndryshme. Këto terma dhe kuptimi i tyre listohen më poshtë:

1. BFE - Pajisje, Mjedise, Shërbime dhe Informacion të cilat sigurohen nga Blerësi;
2. MACE - Muajt pas datës efektive të fillimit të Kontratës (dmth nënshkrimi i Kontratës dhe marrja e Pagesës Paradhënie)
3. WBS - Struktura e Shkeljes së Veprimtarisë referencë nga programimi i punës në Qëllimin e Furnizimit/Pajisjes
- 4.x.x S - Fillimi i Programuar i detyrës WBS “x.x” sipas planifikimit në program
a.x.x F - Përfundimi Programuar i detyrës WBS “x.x” sipas planifikimit në program

6. m - (mk) muaj kalendarik

7. wk - (jk) javë kalendarike

Kërkesa të Përgjithshme

Tabela 1.1-1 përshkruan kërkesa të përgjithshme për paisjet, mjediset, shërbimet dhe informacionin e siguruar nga Blerësi. Në tabelë, gjithashtu, listohet edhe data e kërkuar për plotësimin e çdo artikulli.

Tabela 1.1-1 Kërkesa të përgjithshme për BFE

Përshkrimi	Data e caktuar
a. Blerësi do të jetë Importuesi i të Dhënave të pajisjeve të SIVHD. Për çdo taksë dhe tatim importi përgjigjet Blerësi. Blerësi do të miratojë për import për në Shqipëri të gjithë sistemin e aparaturave dhe pajisjeve që kërkohen për instalim.	2m përpara 7.3F
b. Blerësi do të zhdoganojë aparaturat e SIVHD në doganë dhe do t'i dorëzojë këto në magazinën në Portin e Durrësit (shih artikullin tjetër). Furnizuesi do të ofrojë mbështetje gjatë inspektimeve doganore të dërgesave të para të pajisjeve, me kusht që Blerësi të njoftojë të paktën 48 orë më përpara mbi nevojën e tij për mbështetje.	VTMIS- 3.9S Radar: F1-5.3F F2-5.4F F3-5.5F WAN-6.5F Kullë/Streha/Gen-7.4F
c. Blerësi do të sigurojë hapësirë magazinimi të kontraktuar dhe të mbrojtur në Portin e Durrësit për marrjen dhe mbajtjen e pajisjeve të SIVHD të sjella para instalimit sipas kësaj kontrate. Personelit të LM të përcaktuar më parë do t'i sigurohet mundësi hyrje e papenguar në këtë mjedis gjatë instalimit, për të përgatitur pajisjet për instalim.	1 m para 7.3S
d. Blerësi do të sigurojë frekuenca të miratuara në mikrovalë për	

vënien në punë të boshtit mikrovalë në kohën e kërkuar.	1m para 1.2F
e. Blerësi do të miratojë përdorimin e emetimeve në radio VHF FM, AIS VHF FM, emetimeve të sistemit mikrovalë dhe emetimeve radare për daljet e aparaturave, siç janë specifikuar nga prodhuesit.	1m para 1.2F
f. Blerësi do të garantojë komunikimin në gjuhën angleze, për të ndihmuar gjatë të gjitha proceseve të instalimit të aparaturave, testimit të SAT dhe trajnimit.	1m para fillimit të veprimtarive mbështetëse
g. Teknikët e Blerësit të caktuar për të punuar në sistem duhet të jenë të pranishëm gjatë instalimit dhe testimit të pajisjeve, për të ndihmuar në instalim dhe për të fituar përvojë gjatë punës.	6.6S
h. Blerësi do të caktojë tre vetë të cilët do të përgatiten si Administratorë Sistemi. Ky personel mirëmbajtjeje me kualifikim të lartë do të trajnohet gjatë kryerjes të punës në godinën e LM në Sirakuzë, Nju Jork, përgjatë një jave përpara Testit të Pranimi nga Fabrika të sistemit (FAT) dhe mund të marrë pjesë në FAT. Të paktën një nga këta tre persona duhet të flasë anglisht rrjedhshëm. Pagesa për trajnimin e lartpërmendur është përgjegjësi e Blerësit. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet për jetesë të personave që do të trajnohen gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Sirakuzë, do të mbulohen nga Furnizuesi.	2jk përpara 3.6F
i. Blerësi përgjigjet për projektin e të gjithë punimeve civile dhe do të sigurojë projektet e stacionit për punimet civile dhe projektet e mjedisit që kërkohen për përgatitjen e tij dhe instalimin e pajisjeve të SIVHD. Këto mund të përfshijnë projektet e A&E, projektet e planit urbanistik, strukturor, elektrik, hidraulik, të rrjetit, telefonik dhe ngrohjes /ventilimit/ajrit të kondicionuar. Furnizuesi do të sigurojë kërkesat për pajisjet e SIVHD për të ndihmuar në përgatitjen e projekteve brenda një muaji nga koha e përfundimit të studimit të stacionit nga Furnizuesi. Blerësi do t'i japë LM projektet për t'i shqyrtuar ato përfundimisht dhe për të miratuar artikujt që kanë të bëjnë me instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve të furnizuara nga LM.	Shqyrtimi përfundimtar i skicave – 2 jk përpara 2.2F
j. Blerësi do të përgatisë dhe ndërtojë stacionet/mjediset për projektet e miratuara me përjashtim të artikujve të mëposhtëm siç përcaktohet në Qëllimin e Furnizimit të SIVHD shqiptare. Kullat dhe bazamentet e kullave STREHAT e pajisjeve dhe bazamentet Gjeneratorët dhe bazamentet	F.1 Stacionet –7.5S F.2 Stacionet - 7.6S F.3 Stacionet –7.7S
l. Blerësi do të kryejë të gjitha përgatitjet që kërkohen në stacion për instalimin e kullës dhe strehave. Këtu përfshihen pastrimi i vendit, nivelimi dhe lëvizja e pengesave (tuba, shkëmbinj të mëdhenj etj). Blerësi do të sigurojë një zonë të përshtatshme pune në vendin e montimit të kullës si dhe do të kryejë përgatitje të tjera të vendit.	F.1 Stacionet – 7.5S F.2 Stacionet - 7.6S F.3 Stacionet – 7.7S
m. Nëse vendi ku kërkohet të germohet infektohet, vetëm Blerësi përgjigjet për pastrimin e vendit përpara fillimit të instalimit.	F.1 Stacionet – 7.5S F.2 Stacionet - 7.6S F.3 Stacionet – 7.7S

n. Blerësi do të sigurojë leje hyrje, si të jetë e nevojshme, për në të gjitha stacionet e instalimit për personelin e paracaktuar të LM dhe personelin nënkontraktor që të mos pengohet plani i instalimit të sistemit. Furnizuesi do të bëjë njoftimin 48 orë para për kohën që kërkohet të hyhet në atë stacion.	F.1 Stacionet – 1 jk para 7.5S F.2 Stacionet - 1 jk para 7.6S F.3 Stacionet – 1 jk para 7.7S
o. Blerësi do të pajisë me lejet e nevojshme Furnizuesin e nënkontraktorët e tij për transportin, ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve të SIVHD .	F.1 Stacionet – 1 jk para 7.5S F.2 Stacionet - 1 jk para 7.6S F.3 Stacionet – 1 jk para 7.7S
p. Për çdo kosto që ka të bëjë me përdorimin e infrastrukturës ekzistuese në stacionet rele mikrovalë në Malin e Dajtit, Berat dhe Glavë përgjigjet Blerësi. Këtu përfshihet blerja apo marrja me qera e hapësirës së kullës, hapësirës së bazës së kullës dhe përdorimi i rrjetit elektrik.	F.1 Stacionet – 1 jk para 7.5S F.2 Stacionet - 1 jk para 7.6S F.3 Stacionet – 1 jk para 7.7S
q. Blerësi do të shpërndajë pajisjet e SIVHD nga depo e ruajtjes (shih artikullin c) për në stacionin e caktuar të SIVHD. Furnizuesi do të shkarkojë pajisjet e SIVHD në destinacion sipas programit të rënë dakort reciprokisht për shpërndarjen. Furnizuesi do të japë me hollësi llojet e pajisjeve të caktuara për t'i shpërndarë nëpër stacione. Kjo listë do të jepet jo më vonë se një javë para datës të caktuar për shpërndarjen.	F.1 Stacionet – 1 jk pas 7.5S F.2 Stacionet - 1 jk pas 7.6S F.3 Stacionet – 1 jk pas 7.7S
r. Blerësi do të japë informacion për stacionin në lidhje me utilitetet ekzistuese, kabllot komerciale (elektrik, gaz, uji, komunikim, etj), të nevojshme për instalimin e pajisjeve të Furnizuesit.	2 jk para 2.2F
s. Blerësi do të përgjigjet për sigurimin e kushteve të sigurta në të gjitha stacionet e instalimit sipas standarteve të sigurisë së Bashkimit Evropian (BE) apo Shqipërisë, cilado qoftë më e rreptë. Në rast mosmarrëveshjeje, të dyja palët do të bien dakort për standartin specifik të sigurisë të kërkuar. t. Blerësi do të sigurojë 4 linja të dhënash me kapacitet të plotë e të cilësisë së lartë E1 ndërmjet Stacionit të Largët Sensor të Durrësit dhe atij të Shëngjinit. Blerësi do të sigurojë një zonë ndërveprimi koaksiale 6.703 75 – ohm për secilin qark E1 (lidhje të veçanta 75 ohm për të dhënat Tx dhe Rx) në strehimin e pajisjeve në çdo stacion.	1 mk para fillimit të veprimtarive mbështetëse. 2 jk para 5.8 S

1.1.1 Kërkesat e Veçanta të Stacionit

1.2.1. Komanda e Flotës

Kërkesat BFE për Komandën e Flotës jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i UBS detyra 7.5.

a) Burim parësor energjie të sigurtë.

b) Blerësi do të sigurojë një gjenerator në Komandën e Flotës i cili do të përdoret si mbështetësi kryesor për pajisjet e furnizuara nga LM brenda qendrës së operacioneve të Komandës së Flotës.

c) Blerësi do të sigurojë linja elektrike të instaluar ndërmjet Qendrës së Operacioneve dhe

ndërtesës së Shtabit. Këto linja duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të mbajtur mesatarisht një ngarkesë jo më pak se 20 kW të energjisë së kërkuar për qendrën e operacioneve të Komandës së Flotës përveç ngarkesave ekzistuese.

d) Blerësi do të sigurojë burim të mbrojtur energjie elektrike nga UPS (Bateria) e ndërtesës së re të Shtabit deri te çelësi i transformimit të energjisë (transformatori) për qendrën operacionale të Komandës së Flotës. Ky burim duhet të mbajë një ngarkesë jo më pak se 20 kW.

e) Aksesi i mjaftueshëm për transportimin e pajisjeve dhe personelit (rrugë, hyrje kryesore, leje etj).

f) Blerësi do të rimodelojë Sallën Operacionale sipas specifikimeve që do të paraqiten nga LM. Ky rimodelim minimalisht duhet të përfshijë:

a. Ngritjen e nivelit të dyshemesë për kalimin nën të të kablllove ose mbulimi i tyre në lartësi.

b. Priza të mbrojtura për ushqimin, rrjetin kompjuterik dhe telefonik që instalohen në dyshemenë e ngritur në vendet e caktuara.

c. Grila për dritaret ose perde për uljen e nivelit të dritës së mjedisit brenda dhomës.

d. Ndriçim me mundësi zbehje.

e. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar me kapacitet të mjaftueshëm për të mirëmbajtur pajisjet brenda mjedisit të duhur të parametrave operues kur hapësira është e mbushur plotësisht me personel.

f. Hapësirë të mjaftueshme për të gjitha pajisjet e LM në qendrën operacionale të Komandës së Flotës.

g. Pajisje uji dhe mjedise sanitare në ndërtesën e Komandës së Flotës.

h. Rrjet shpërndarës energjie dhe lidhje e telefonisë publike.

1.2.2. Distrikti Detar Verior

Kërkesat BFE për Komandën e Distriktit Detar Verior jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i WBS detyra 7.7.

a) Blerësi do të sigurojë hapësirë për bazamentin prej betoni të kullës së komunikimit me tiranta sa më afër ndërtesës së re dhe ngjitur me hapësirën e pajisjeve që do të mbështesin sallën operacionale.

b) Blerësi do të mbajë të hapur kalimin për në zonën rreth bazamentit të kullës në mënyrë që të mos pengojë gjatë instalimit.

c) Blerësi do të sigurojë hapësirën Operacionale brenda ndërtesës së re që do të mbështesë të paktën tri vendndodhje pune (2 të instaluar për LM dhe një rezervë për ndonjë zgjerim të mëvonshëm) dhe pajisjet ndihmëse siç janë printerat. Mbështetësja që montohet për pajisjet elektronike sigurohet nga LM dhe mund të montohet brenda kësaj salle ose në një hapësirë të afërt, por pavarësisht nga vendi, kërkohet përmbushja e kushteve të mëposhtme:

1.Ngritja e nivelit të dyshemesë për kalimin nën të të kablllove ose mbulimi i tyre në lartësi.

2.Priza të mbrojtura për ushqimin me energji, rrjetin kompjuterik dhe telefonik që instalohen në dyshemenë e ngritur në vendet e caktuara.

3.Grila për dritaret ose perde për uljen e nivelit të dritës së mjedisit brenda dhomës.

4.Ndriçim me mundësi zbehje.

5.Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve brenda mjedisit të duhur të parametrave operues, kur hapësira është e mbushur plotësisht me personel.

6.Pajisje uji dhe mjedise sanitare në ndërtesën e Komandës së Distriktit Detar Verior.

7.Rrjet shpërndarës energjie dhe lidhje e telefonisë publike.

d) Salla Operacionale dhe hapësira e pajisjeve elektronike do të sigurohet me energjinë e mbrojtur të ndërtesës dhe do të ketë mbështetje parësore të gjeneratorit. Të dyja hapësirat do ta marrin ushqimin nga një panel të vetëm elektrik të mbrojtur. LM do të sigurojë një gjenerator dhe çelës për ndryshimin e ushqimit për të mbështetur këtë ngarkesë, në rast të mungesës të ushqimit dhe gjeneratorit parësor.

e) Blerësi do të sigurojë hapësirë të jashtme për një strehë të energjisë në afërsi të panelit të energjisë së siguruar që furnizon me energji sallën operacionale dhe hapësirën e pajisjeve elektronike.

Blerësi do të sigurojë shesh ndertimi për gjurmim të gjerë në këtë vend për vendosjen e strehës se furnizimit me energji.

f) Blerësi do të sigurojë një hapësirë mirëmbajtje 50 m2 brenda mjedisit të ri. Hapësira e mirëmbajtjes do të ketë:

1. Priza të sigurta të energjisë elektrike, rrjeti dhe telefoni;

2. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve brenda parametave të duhur në mjedisin e punës, kur hapësira është tërësisht me personel.

3.2 tavolina pune me energji elektrike të sigurt dhe lidhje LAN.

4.1 vend pune Electronics ESD me energji elektrike të mbrojtur dhe lidhje LAN.

2 tavolina mirëmbajtjeje/administratori me prizat e ushqimit të mbrojtur dhe rrjetin kompjuterik e telefonik.

g) Blerësi do të sigurojë një hapësirë prej 25 m2 për mbajtjen e pjesëve rezervë brenda mjedisit të ri. Kjo depo do të ketë:

1. Derë me çelës që siguron hyrje nga brenda sallës.

2. Priza të mbrojtura ushqimi, rrjeti dhe telefoni.

3. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve brenda parametave të duhur në mjedisin e punës, kur hapësira është tërësisht me personel.

1.2.3 Distrikti Detar Jugor

Kërkesat BFE për Komandën e Distriktit Detar Jugor jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.6 WBS.

a) Blerësi do të sigurojë OSHA e duhur ose kalimin ekuivalent për në tarracën e ndërtesës së funksionimeve për instalimin e antenës me mikrovalë.

b) Blerësi do të sigurojë hapësirën Operacionale brenda ndërtesës së re që do të mbështesë tre stacione pune (2 të instaluar nga LM dhe një rezervë për ndonjë zgjerim të mëvonshëm) dhe pajisjet ndihmëse siç janë printerat. Trina që montohet në mbështetje të pajisjeve elektronike e që sigurohet nga LM mund të montohet brenda kësaj hapësire ose në një hapësirë të afërt, por pavarësisht nga vendi, kërkohet përmeshja e kushteve të mëposhtme:

a. Ngritja e nivelit të dyshemesë për nënkallimin e kablllove, ose kalimin e rrjetit kabllor nga sipër.

b. Priza të sigurta të energjisë elektrike, rrjetit kompjuterik dhe telefonik që instalohen në dyshemenë e ngritur në vendet e caktuara.

c. Grila për dritaret ose perde për uljen e nivelit të dritës së mjedisit brenda dhomës.

d. Ndriçim me mundësi zbehje.

e. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve brenda parametave të duhur në mjedisin e punës, kur hapësira është tërësisht e shfrytëzuar.

f. Ujë /Mjedise për përdorim sanitar në ndërtesën e Komandës së Distriktit Detar Jugor

g. Rrymë elektrike dhe rrjet të telefonisë publike

c) Zyra Operative dhe hapësira e pajisjeve elektronike do të furnizohet me energji ndërtese të mbrojtur dhe të siguruar nëpërmjet një gjeneratori rezervë. Të dyja hapësirat do të marrin rrymën elektrike nga një panel i vetëm elektrik i siguruar. LM do të sigurojë një gjenerator dhe çelës të ndryshimit të elektricitetit për të mbështetur këtë ngarkesë në rast të mungesës së furnizimit me rrymë nga linja parësore e energjisë apo të shuarjes së gjeneratorit.

d) Blerësi do të sigurojë hapësirë të jashtme për një strehë të energjisë në afërsi të panelit me energji që furnizon me rrymë zyrën operative dhe hapësirën e pajisjeve elektronike. Blerësi do të sigurojë shesh ndertimi dhe do të gjurmë në thellësi të tij për vendosjen e kabinës elektrike.

e) Blerësi do të sigurojë për mirëmbajtje, një hapësirë 50 m2 brenda mjedisit të ri. Hapësira e mirëmbajtjes do të ketë:

1. Priza të mbrojtura të energjisë elektrike, rrjetit dhe linjës telefonike;

2. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve brenda parametave të duhur në mjedisin e punës, kur hapësira është tërësisht e shfrytëzuar.

3.2 tavolina pune elektronike me energji elektrike të sigurt dhe lidhje në rrjet LAN

4.1 hapësirë Electronics ESD me energji elektrike të sigurt dhe lidhje në rrjet LAN

5.2 tavolina të mirëmbajtjes/administratorit me priza të energjisë elektrike dhe rrjetit kompjuterik e telefonik.

h) Blerësi do të sigurojë një hapësirë prej 25 m² si hapësirë magazinimi për mbajtjen e pjesëve rezervë brenda mjedisit të ri. Kjo magazinë do të ketë:

1. Derë me bravë të siguruar që të mund të hapet nga brenda sallës.

2. Priza të sigurta të energjisë elektrike, rrjetit dhe linjës telefonike.

3. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve brenda parametrave të duhur në vendin e punës, kur hapësira është tërësisht e shfrytëzuar.

1.2.4 Qendra e Bashkuar Operacionale në Tiranë

Kërkesat BFE për Qendrën e Bashkuar Operacionale jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i WBS 7.5.

a) Blerësi do të sigurojë energjinë e duhur të filtruar, kushtëzuar dhe mbështetur për të gjitha pajisjet e instaluar të QBO.

b) Blerësi do të sigurojë sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve të instaluar, brenda parametrave të duhur për mjedisin e punës kur hapësira e QBO është tërësisht e shfrytëzuar.

c) Blerësi do të sigurojë hapësirë brenda QBO për tre vende të vëzhguesve të hapësirës bregdetare. Në afërsinë praktike të vëzhguesit do të jenë Ethernet Jacks, priza energjie elektrike të siguruar dhe telefon. Hapësira për njërin nga vëzhguesit do të jetë në të njëjtën sallë ku do të vendosen ekranet e mëdhenj.

d) Blerësi do të sigurojë hapësirë brenda QBO për një Vëzhgues Taktik të Trafikut Ajror. Në afërsinë praktike të vëzhguesit do të jenë Ethernet Jacks, priza energjie elektrike të siguruar dhe telefon.

e) Blerësi do të sigurojë kapëse fiksuese muri ose bazament të përshtatshëm për montimin në mure të ekraneve të mëdha apo paneleve të mëdha LCD. Hollësitë e montimit do të jepen nga LM.

f) Blerësi do të sigurojë një hapësirë prej 50m brenda QBO së paku për hapësirën e trinës së pajisjeve 4U pranë hyrjes për në çati të shtyllës ekzistuese të drejtuar drejt relese mikrovalë të malit të Dajtit. Blerësi do të sigurojë hapësirë në shtyllën ekzistuese të QBO për antenën mikrovalë të Furnizuesit dhe duhet të sigurojë që antena të montohet e sigurt dhe me largësinë e nevojshme nga antenat ekzistuese.

1.2.5 Sarandë

Kërkesat BFE për Sarandën jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës së WBS 7.7

Blerësi do të sigurojë hapësirë të brendshme rezervë në fund të pjesës jugore të ndërtesës, e përshtatshme për vendosjen e dy stacioneve pune (njëri do instalohet nga LM, tjetri për ndonjë zgjerim në të ardhmen), tavolinën e mbikqyrësit, një tavolinë për printerin dhe rafti për pajisjet. Kjo hapësirë mund të ri-përshtatet dhe së paku të pajiset me kriteret e mëposhtme:

a. Ngritjen e nivelit të dyshemesë për nën kalimin e kablllove ose kalimin nga sipër të rrjetit kabllor

b. Priza të energjisë elektrike të siguruar, rrjetin kompjuterik dhe telefonik që instalohen në vendet e caktuara të dyshemesë së ngritur. Prizat telefonike dhe ato të rrjetit do të lidhen përsëri në sistemin e pajisjeve të instaluar të LM.

c. Një panel të energjisë elektrike të siguruar në këtë sallë. Ky panel do të furnizojë me energji sistemin e ajrit të kondicionuar, ndriçimin, ngrohjen dhe të gjitha pajisjet brenda hapësirës së rimodeluar. Ky panel do të furnizohet me rrymë nga çelësi i ndryshimit të energjisë së LM i vendosur në kabinën elektrike.

d. Priza të rrjetit kompjuterik dhe telefonik. Prizat telefonike dhe ato të rrjetit kompjuterik do të lidhen përsëri në sistemin e pajisjeve të instaluar të LM.

e. Sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve

brenda parametrave të duhur të mjedisit të punës, kur hapësira është terësisht e shfrytëzuar.

f. Mbulesa për dritaret ose grilat për uljen e nivelit të dritës së mjedisit brenda dhomës.

g. Ndriçimi në tavan të ketë çelës për zbehjen e dritës për të kontrolluar nivelin e dritës brenda hapësirës.

b) Blerësi do të sigurojë ujë/kushte sanitare.

c) Blerësi do të sigurojë shpërndarjen e energjisë dhe rrjetit të telefonisë publike.

d) Blerësi do të sigurojë hapësirë të brendshme rezervë jashtë ndërtesës ngjitur për hapësirën e pajisjeve për kullën 30m me tiranta. Hapësira rezervë e kullës duhet të jetë midis pemëve ekzistuese në mënyrë që degët e pemëve të mos prekin kullën në rast të erërave të forta; hapësira duhet të jetë e mjaftueshme për përdorimin e telave dhe tirantave për fiksimin e shtyllës.

e) Blerësi do të përmirësojë dhe standardizojë energjinë e përdorur që hyn në ndërtesë.

f) Blerësi do të sigurojë lidhjen e telefonisë publike.

g) Blerësi do të sigurojë një bazament betoni në afërsi të kullës që do të vendoset streha e LM për sistemin e ushqimit me energji. Furnizimi parësor për ndërtesën duhet të kalojë në këtë panel kryesor burimi. Pajisjet që do të sigurojnë këtë shërbim për strehimin e sistemit të energjisë duhet të përballojnë një kapacitet jo më pak se 60 Amps, një fazor dhe 230V.

1.2.6 RSS Shëngjin

Kërkesat BFE për Shëngjinin jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës se WBS 7.7

a. Blerësi do të sigurojë hapësirë të brendshme rezervë pranë skajit verilindor të ndërtesës së re të rikonstruktuar për një kullë vetëmbështetëse 30m. Kjo kullë do të jetë në afërsi të sallës ku do të instalohen pajisjet elektronike dhe vendi i punës.

b. Blerësi do të sigurojë një sallë në skajin verilindor të ndërtesës. Kjo sallë do të ketë përmasa të mjaftueshme për të mbajtur pajisjet mikrovalë, rrjetin dhe radarët elektronikë. Radari i dyfishtë marrës-dhënës duhet montuar në mur dhe ka përmasa 86"/17"/60" dhe peshon afërsisht 80kg. Njësia marrës-dhënës duhet montuar për të minimizuar thyerjet (përkuljet) e pajisjes përcjellëse që kërkohen për të arritur tek marrës-dhënësi nga kulla. Pjesët e tjera elektronike do të përshtaten në dy raftet e pajisjeve, secila me përmasa 24"/38"/72".

c. Blerësi do të sigurojë një dhomë në afërsi të sallës së përshkruar në 1.2.6.b ku do të vendosen dy stacione pune (një do të instalohet në sistem dhe tjetri do të jetë rezervë për një zgjerim në të ardhmen). Veç kësaj, në këtë dhomë do të vendoset një tavolinë pune për administratorin dhe një tryezë për printerin.

d. Blerësi do të sigurojë sistem ngrohjeje dhe ajër të kondicionuar për dy dhomat e listuara në 1.2.6. b&c me kapacitetin e mjaftueshëm për montimin e të gjitha pajisjeve në parametrat normalë veprues, kur hapësira është në shfrytëzim të plotë. Sistemi i ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar duhet të funksionojë me qarqe të sigurta dhe të mbështetura me gjeneratorë.

e. Blerësi do të sigurojë panelin e mbrojtur të furnizimit me rrymë në afërsi të dhomave të përshkruara në 1.2.6.b &c që do të sigurojë ushqimin me energji për të gjitha pajisjet brenda këtyre dy hapësirave. Ky panel furnizimi do të ushqehet me rrymë nga çelësi i transformimit të energjisë të vendosur nga LM.

f. Blerësi do të sigurojë hapësirë në afërsi të kullës të përshkruar në 1.2.6.a për strehimin e sistemit të ushqimit të siguar nga LM.

g. Blerësi do të sigurojë ujë / kushte sanitare.

h. Blerësi do të sigurojë shpërndarjen e energjisë dhe rrjetit të telefonisë publike.

1.2.7. RSS Durrës

Kërkesat BFE për Durrësin jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.5 WBS

a) Blerësi do të heqë dy kullat ekzistuese (të mbështetura më parë nga radarët rusë dhe kinezë)

b) Blerësi do të instalojë rrjetin e ushqimit me energji në ndërtesë.

c) Inxhinieri projektues i caktuar nga Blerësi do të inspektojë me imtësi dhe garantojë

bazamentin e kullës kineze për mbështetjen e shtyllave 5m me antena të qëndrueshme dhe ngarkesë dinamike që jepen nga LM.

d) Blerësi do të sigurojë një sallë në skajin juperëndimor të ndërtesës. Kjo sallë do të ketë përmasa të mjaftueshme për të mbajtur pajisjet mikrovalë, rrjetin dhe radarët elektronikë. Radari i dyfishtë marrës-dhënës duhet montuar në mur dhe ka përmasa 86"/17"/60" dhe peshon afërsisht 80 kg. Njësia marrës-dhënës duhet montuar për të minimizuar thyerjet (përkuljet) e pajisjes përcjellëse që kërkohen për të arritur tek marrës-dhënësi nga kulla 5 m e montuar në tarracë. Pjesët e tjera elektronike do të përshtaten në dy raftet e pajisjeve, secila me përmasa 24"/38"/72".

e) Blerësi do të sigurojë një hapësirë dhe bazament në skajin juglindor të ndërtesës për strehimin e sistemit të ushqimit të dhënë nga LM.

f) Blerësi do të sigurojë energjinë primare për strehimin juglindor. Ky ushqim me energji do të sigurohet nga një çelës elektrik dhe një degëzim i përshtatshëm, i sigurt që mban një kapacitet prej jo më pak se 60 Amps, 230 V, një fazor.

1.2.8. RSS Hidrovor

Kërkesat BFE për Hidrovorin jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve është fillimi i detyrës WBS 7.7

a) Blerësi, me mbështetjen e LM, do të ketë të drejtën e hyrjes dhe lejen të përmirësojë lehtësirat pompuese në Hidrovor. Kjo e drejtë do të përfshijë sigurimin e ushqimit me energji nga burimet e dyfishta brenda mjediseve të Hidrovorit për strehimin e sistemit të ushqimit që jep LM.

b) Blerësi do të sigurojë hapësirën në bazën e ndërtesës sa më afër strehimit të pajisjes, për strehimin e sistemit të ushqimit dhe kullën e radarit 30m.

c) Blerësi do të sigurojë hapësirë në bazën e kullës për një strehë pajisjesh.

d) Blerësi do të rrethojë me gardh strehën e sistemit të ushqimit, strehën e pajisjeve dhe sheshin e kullës do t'a sigurojë me një portë me çelës.

e) Blerësi do të sigurojë furnizimin e mbrojtur me energji të kabinës elektrike. Ky furnizim me energji do të sigurohet nga një çelës degëzimi dhe përcimi i sigurt, me një kapacitet jo më pak se 60 Amps, 230 V, një fazor.

f) Nëse lind nevoja, Blerësi do të lëvizë farin ekzistues për t'u siguruar që ai të jetë i dukshëm nga deti dhe të mos ndërhyjë në funksionimin e sistemit radar.

1.2.9. RSS Sazan

Kërkesat BFE për Sazanin jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.6 WBS

a) MM do të sigurojë transportin për në/nga ishulli i Sazanit siç kërkohet për mbikqyrjen, instalimin dhe testimin në terren. Veç rasteve të emergjencës, kërkesa për transport do të bëhet jo më pak se 48 orë më parë.

b) Blerësi do të ketë një plan të plotë e të përgatitur për mbështetjen logjistike para fillimit të instalimit të pajisjeve. Plan i mbështetës duhet të përfshijë furnizimin e gjeneratorit, makinave, transportin e rëndë për në/nga ishulli dhe të paktën transportin rutinë për në/nga ishulli.

c) Blerësi do të sigurojë një makinë që do të qëndrojë çdo kohë në ishull për veprimet e instalimit dhe mirëmbajtjes. Kjo makinë duhet të jetë në vendin e duhur me sasinë e nevojshme të karburantit, para se të fillojë instalimi i pajisjeve. Makina duhet të jetë me katër rrota aktive dhe e përshtatshme për të transportuar jo më pak se 4 vetë si dhe pajisje e mjete. Makina duhet të jetë në kushte të mira funksionimi dhe të mirëmbahet në mënyrë që të jetë e gatshme në çdo kohë. MM do të sigurojë shoferin për këtë makinë kur të planifikohet puna në Sazan.

d) Blerësi do të përmirësojë të gjitha rrugët që duhen midis molit dhe pikës në mënyrë që të kalohet pa probleme me makinat e rënda që mbajnë pajisje parafabrikate. Këto rrugë duhet gjithashtu të jenë të sigurta për kalimin e mjeteve të rënda për instalimin e sistemit dhe të punëve civile. Veçanërisht kthesa pranë vendndodhjes së radarit të instaluar italian është shumë e ngushtë për kalimin e makinave të mëdha. Kjo rrugë duhet zgjeruar dhe të rritet harku i kthesës.

e) Blerësi do të vendosë një gardh rreth pikës dhe do ta sigurojë me portë me çelës. Porta duhet të jetë e madhe, të lejojë edhe kalimin e makinave të rënda. Rruga do të shtrihet në drejtim të

portës deri në strehen e pajisjeve.

1.2.10. RSS Llogara

Kërkesat BFE për Llogara jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.7 WBS

a) Blerësi do të përmirësojë të gjitha rrugët hyrëse për kalim të sigurt të një kamioni me karroceri që mban një strehë parafabrikate. Këto rrugë duhet të mundësojnë edhe kalimin e sigurt të pajisjeve të rënda për instalimin e sistemit dhe punëve civile.

b) Blerësi duhet të shtrijë rrugën hyrëse deri në vendin e përzgjedhur.

c) Blerësi do të sigurojë rrethimin përreth vendit të caktuar me derë me çelës. Porta të jetë e madhe sa për kalimin edhe të makinave të rënda. Rruga do të shtrihet në drejtim të portës deri në strehën e pajisjeve.

1.2.11. RSS Porto Palermo

Kërkesat BFE për Porto Palermo jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës së WBS 7.7.

a) Blerësi do të përmirësojë të gjitha rrugët hyrëse për kalim të sigurt të një kamioni me karroceri që mban një strehë parafabrikate . Këto rrugë duhet të mundësojnë kalim të sigurt të pajisjeve të rënda për instalimin e sistemit dhe punëve civile.

b) Blerësi duhet të shtrijë rrugën hyrëse për në vendndodhjen e strehave të pajisjeve.

c) Blerësi do të lidh pikën me rrjetin e energjisë së duhur.

d) Blerësi do të sigurojë energjinë e duhur për strehën e sistemit të energjisë. Ky furnizim do të sigurohet nga një çelës dhe një degëzim me përcim të sigurt me një kapacitet jo më pak se 60 Amps, 230 V, një fazor.

1.2.12. RSS Ksamil

Kërkesat BFE për Ksamil jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.7 WBS

a) Blerësi do të përmirësojë të gjitha rrugët hyrëse për kalim të sigurt të një kamioni me karroceri që mban një strehë parafabrikate. Këto rrugë duhet të mundësojnë kalim të sigurt të pajisjeve të rënda për instalimin e sistemit dhe punëve civile.

b) Blerësi duhet të shtrijë rrugën hyrëse për në vendndodhjen e depove të pajisjeve.

c) Blerësi do të sigurojë energjinë e duhur për strehen e sistemit të energjisë.

Ky furnizim do të sigurohet nga një çelës dhe një degëzim me përcim të sigurt me një kapacitet jo më pak se 60 Amps, 230 V, një fazor.

1.2.13. MRS Mali i Dajtit

Kërkesat BFE për Malin e Dajtit jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës WBS 7.5.

a) Blerësi do të sigurojë tek pala shitëse e mikrovalës hapësirën e kullës me lartësinë e kërkuar për montimin e një përzierje antenash parabolike mikrovale me përmasa 1.8m me 2.4m.

b) Blerësi do të sigurojë rrugë hyrëse të përmirësuara për në pikë, të përshtatshme për instalimin e të gjitha pajisjeve të kërkuara.

c) Blerësi do të sigurojë certifikatën nga inxhinieri i pronarit të kullës që ajo të jetë e sigurt për instalimin e antenave të kërkuara në lartësinë e caktuar nga nënkontraktorët mikrovalë të Lockheed Martin.

d) Me zgjedhjen e Furnizuesit, Blerësi do të sigurojë hapësirë të mjaftueshme në bazën e kullës për instalimin e një mbajtëseje për pajisje mjedisi ose për përdorim si dhomë magazinimi pajisjesh të sjella nga blerësi, e cila plotëson kushtet e caktuara të mjedisit.

1.2.14. MRS Berat

Kërkesat BFE për Berat jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.6 WBS

a) Blerësi do të sigurojë tek pala shitëse e mikrovalës hapësirën e kullës me lartësinë e kërkuar për montimin e një përzierje antenash parabolike mikrovale me përmasa 1.8m me 2.4m.

b) Blerësi do të sigurojë rrugë hyrëse të përmirësuara për në pikë, të përshtatshme për

instalimin e të gjitha pajisjeve të kërkuara.

c) Blerësi do të sigurojë certifikatën nga inxhinieri i pronarit të kullës që ajo është e sigurt për instalimin e antenave të kërkuara në lartësinë e caktuar nga nënkontraktorët mikrovalë të Lockheed Martin.

d) Me zgjedhjen e Furnizuesit, Blerësi do të sigurojë hapësirë të mjaftueshme në bazën e kullës për instalimin e një mbajtëseje për pajisje mjedisi ose për përdorim si dhomë magazinimi pajisjesh të sjella nga blerësi, e cila plotëson kushtet e caktuara të mjedisit.

1.2.15. MRS Gllavë

Kërkesat BFE për Gllavë jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës WBS 7.6.

a) Blerësi do të sigurojë tek pala shitëse e mikrovalës, hapësirën e kullës me lartësinë e kërkuar për montimin e një përzierje antenash parabolike mikrovale me përmasa 1.8m me 2.4m.

b) Blerësi do të sigurojë rrugë hyrëse të përmirësuara për në pikë, të përshtatshme për instalimin e të gjitha pajisjeve të kërkuara.

c) Blerësi do të sigurojë certifikatën nga inxhinieri i pronarit të kullës që ajo të jetë e sigurt për instalimin e antenave të kërkuara në lartësinë e caktuar nga nënkontraktorët mikrovalë të Lockheed Martin.

d) Me zgjedhjen e Furnizuesit, Blerësi do të sigurojë hapësirë të mjaftueshme në bazën e kullës për instalimin e një mbajtëseje për pajisje mjedisi ose për përdorim si dhomë magazinimi pajisjesh të sjella nga blerësi, e cila plotëson kushtet e caktuara të mjedisit.

1.2.16. MRS Zvërnec

Kërkesat BFE për Zvërnec jepen në listën e mëposhtme. Data e kërkuar për plotësimin e të gjithë artikujve BFE është fillimi i detyrës 7.6 WBS.

a) Blerësi do të përmirësojë të gjitha rrugët hyrëse për në pikë për të mundësuar kalim të sigurt të kamionëve që mbajnë pajisje të rënda për instalimin e sistemit dhe punëve civile.

b) Blerësi do të shtrijë rrugën hyrëse deri në vendin e specifikuar të kullës së komunikimit dhe strehës së pajisjeve.

c) Blerësi do të sigurojë hapësirë për platformën dhe instalimin e kullës së komunikimit. Hapësira duhet të jetë e mjaftueshme për kapëset e kullës dhe tirantave siguruese.

d) Blerësi do të lidhë pikën me rrjetin e ushqimit me rrymë.

e) Blerësi do të sigurojë energjinë e duhur për kabinën elektrike. Ky furnizim do të sigurohet nga degëzimi dhe përçimi i sigurt me një kapacitet jo më pak se 60 Amps, 230 V, një fazor.

1.3. Rishqyrtim i Planit BFE

Duke filluar jo më vonë se dy muaj para datës së dorëzimit, sipas planit të çdo artikulli BFE, Palët do të shqyrtojnë gatishmërinë e artikujve në ardhje BFE. Nga Blerësi do të bëhet vlerësimi i fundit i datës aktuale të dorëzimit të çdo artikulli brenda periudhës dy mujore vijuese. Qëllimi i këtyre rishqyrtimeve është që të lejojnë, aty ku është e mundur, rregullimin/përshtatjen e zbatimit të programit nga Palët, për të minimizuar ndikimin në program.

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare të Republikës së Shqipërisë

Afatet dhe Kushtet - SHTOJCË 1

Supozime dhe Kushte

Ky dokument përmban të dhëna të cilat nuk lejohen të bëhen të njohura jashtë institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, sikurse dhe të shumëfishohen, përdoren apo përhapen si një e tërë apo pjesërisht, për ndonjë qëllim tjetër, veç atij vlerësues. Për të dhënat që janë objekt i këtij kufizimi, në faqet përkatëse është shënuar “Informacion në Pronësi të Lockheed Martin”.

SUPOZIME dhe KUSHTE

Çmimi i ofruar për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), i propozuar nga Lockheed Martin (LM, “Furnizuesi”) për Ministrinë e Mbrojtjes Shqiptare (MM, “Blerësi”), mbështetet në supozimet dhe kushtet e mëposhtme.

Shënim: Supozimet dhe kushtet e tjera që kanë të bëjnë me Paraqitjen e propozuar të të

Dhënave të Kontrollit të Trafikut Ajror përshkruhen në Propozimin Teknik të SMHB – Shtojca II, datë 15 maj 2006.

Supozime të Përgjithshme

a) Të gjitha hapësirat bregdetare dhe në det të hapur që mbulohen me radar, sikurse dhe vendet që janë të lidhura me këto zona mbulimi, mbështeten në analizën e bërë duke përdorur Pajisjen e Ndihmuar nga Kompjuteri për Vlerësimin e Efektshmërisë së Radarit (PNKVER) (anglisht CARPET). CARPET është një program i mirëfilltë modelimi dhe vlerat e siguruara nga ky model tejkalojnë në të gjitha instalimet e radarëve. Parametrat e përdorura në këtë modelim të efikasitetit janë vetëm për zonën dhe NUK përfshijnë anomali në përhapje si në rastin e tuneleve. Mbulimi përfundimtar i radarit, duke marrë parasysh edhe bllokimin e radarit nga objektet rreth tij dhe hijëzimet në bregdet, do të përcaktohet gjatë ekspertimit dhe studimit të vendndodhjes pas nënshkrimit të kontratës.

b) Vlerësimi i efektshmërisë së RF së Radios dhe AIS mbështetet në analizën e bërë duke përdorur Kodin Amerikan të Rregullave Federale, Kapitulli 47, Pjesa 80 (47CFR80), Nën pjesa P (“Standardet për Llogaritjen e Mbulimit VHF të Stacionit Bregdetar Publik”). Këto vlerësime mbështeten në lartësitë e supozuara të instalimit, llojit të antenës dhe mospengimit të pamjes së drejtpërdrejtë.

c) Vlerësimi ynë bazohet në parakushtin që të gjitha liçencat e nevojshme për eksportimin e pajisjeve/programeve kompjuterike të ofruara, do të jepen nga agjencia amerikane të cilës do t’i kërkojnë.

d) Stacionet Rele Mikrovalë (MRS) të Malit të Dajtit, Beratit (Lis i Becit) dhe Gllavës të kenë energji elektrike, të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e SMHB dhe me kapacitet të mjaftueshëm rezervë (330W në çdo stacion) për funksionimin e pajisjeve rele mikrovalë të instaluar në çdo pikë për SIVHD.

e) Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe fjetjes të bëra nga klienti (përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me Rishqyrtimin e Projektit të Sistemit, Testet e Pranimi në Fabrikë dhe trajnimin) janë përgjegjësi e Blerësit, me përjashtim të shpenzimeve të udhëtimit dhe jetesës për trajnimin në Sirakuzë, Nju Jork, të cilat mbulohen nga Furnizuesi.

f) Vendndodhjet dhe lartësitë e antenave mikrovalë të përshkruara në Propozimin Teknik të realizojnë lidhjen e përshtatshme për të siguruar tërësinë e lidhjes së nevojshme për SIVHD shqiptare. Nëse nevojitet ndonjë stacion rele mikrovalë shtesë me qëllim që të realizohet komunikimi midis çdonjërit nga nyjet e përcaktuara në Propozimin Teknik, Furnizuesi do të sigurojë lidhjen shtesë (siç përshkruhet më poshtë) pa i kërkuar ndonjë kosto shtesë Blerësit. Çdo rele mikrovalë pas këtij stacioni të parë shtesë është përgjegjësi e Blerësit.

Nëse kërkohet lidhje shtesë, Furnizuesi do të sigurojë sa më poshtë vijon:

a. Dërgimin dhe instalimin e kullës së komunikimit në një lartësi maksimale prej 40 m.

b. Dërgimin dhe instalimin e të gjitha pajisjeve elektronike mikrovalë, përfshirë edhe strehat që nevojiten për të lidhur nyjet e propozuara.

c. Dërgimin dhe instalimin e një kompleti 1 kW të gjeneratorit dubël me furnizim 7.5 ditë lëndë djegëse (i njëjtë me atë të Zvërnecit).

Të gjithat hyrjet për në stacione dhe përmirësimet për stacionin rele shtesë do të jenë përgjegjësi e Blerësit. Këto përmirësime përfshijnë të gjithë artikujt e listuar në Shtojcën 4, Kërkesa të Përgjithshme (1.1) dhe Kërkesat për Zvërnecin (1.2.16).

Supozime të veçanta për Stacionin

Distrikti Detar Jugor

Stacioni ndodhet në godinën ekzistuese të Distriktit Detar Jugor.

RSS në Durrës

LM merr si të vërtetë se bazamenti i propozuar i kullës në çatinë e ndërtesës do të mbajë kullën 5 m dhe ngarkesat e antenës (pesha totale maksimale 3200 kg).

MRS në Malin e Dajtit

LM nuk pati mundësi të vizitojë këtë vendndodhje ndaj dhe supozon se stacioni, me kullën e

re të ngritur nga MM, do të sigurojë lartësinë e duhur për të arritur sinjale lidhëse mikrovalë të cilësisë së lartë për të gjitha stacionet e kërkuara.

MRS në Berat

LM nuk pati mundësi të vizitojë këtë vendndodhje ndaj dhe supozon se stacioni, me hapësirën ekzistuese të mjaftueshme të kullës, do të sigurojë lartësinë e duhur për të arritur sinjale lidhëse mikrovalë të cilësisë së lartë për të gjitha stacionet e kërkuara.

MRS në Glavë

LM nuk pati mundësi të vizitojë këtë vendndodhje ndaj dhe supozon se stacioni, me hapësirën ekzistuese të mjaftueshme të kullës, do të sigurojë lartësinë e duhur për të arritur sinjale lidhëse mikrovalë të cilësisë së lartë për të gjitha stacionet e kërkuara.

MRS në Zvërnec

LM nuk pati mundësi të vizitojë këtë vendndodhje. Mbështetur në informacionin e raportit të MM, LM supozon se një kullë 25m e lartë e montuar në vendin e specifikuar nga MM do të sigurojë ndarje të përshtatshme për antenën dhe realizimin e lidhjes mikrovalë ndërmjet Zvërnecit dhe të gjitha stacioneve ndërlidhëse mikrovalë të përshkruara në Propozimin Teknik.